



DCAF

Qendra e Gjenezës
për Qeverisjen e
Sektorit të Sigurisë



Kuvendi i
Republikës së Maqedonisë së Veriut

UDHËZIME PËR MBIKQYRJEN MBI ZBULIMIN

**për komisionet parlamentare
në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Janar, viti 2021

PARATHËNIE DHE FALMENDERIM

*Udhëzimet për mbikqyrje mbi zbulimin për herë të parë janë publikuar në maj të vitit 2018 me kërkesë dhe për përdorimin e tre komisioneve parlamentare me mandat që të vëzhgojnë sektorin e sigurisë dhe zbulimit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nga vitit 2018, në sistemin e zbulimit maqedonas të llogaridhënies janë bërë **ndryshime të shpejta dhe të rëndësishme. Janë themeluar institucione të reja dhe zbatohen rregullativa të reja, të cilat kërkojnë përshtatjen e proceseve të mbikqyrjes. Gjatë vitit 2020, kemi bërë shqyrtimin revizor të tekstit të Udhëzimeve, duke përgatitur një botim të reviduar që pasqyron të gjithë këto probleme.***

Nga vetë fillimi, hartimi i *Udhëzimeve* ishte një përpjekje e jashtëzakonshme kolektive që ka përfshirë edhe autorët e tekstit edhe lexuesit e mundshëm.

Si bashkëautorë të botimit të parë të *Udhëzimeve*, **Magdalena Lembovska, d-r Julijan Riçards dhe Vuter de Rider** në tekst kanë përfshirë perspektivat e vlefshme dhe të shumëllojshme të hulumtuesit, zbuluesit të mëparshëm të lartë dhe praktikuesit të mbikqyrjes. Teksti është pasuruar dhe harmonizuar me kontekstin e ri juridik dhe institucional përmes përpjekjes të jashtëzakonshme individuale dhe kolektive të **Igor Kuzevski, d-r Ice Iljevski** dhe kolegëve tonë nga zyra e DCAF në Shkup: **Vllado Gjerdovski dhe d-r Kire Babanoski**.

Anëtarë dhe këshilltarë të zgjedhur nga shërbimi i Parlamentit nga tri komisionet parlamentare përgjegjëse për mbikqyrjen e zbulimit dhe sigurisë na kanë dhënë informacione kthyesë për çdo hap nga hartimi i *Udhëzimeve*, nga përkufizimi i përmbajtjes të tyre deri në një rishikim gjithëpërfshirës të tekstit, që ka prodhuar këtë botim të dytë. Ne u jemi veçanërisht mirënjohës anëtarëve të **Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut** të cilët kanë ndarë kohën, edhe krahas detyrimeve të shumta të punës, për të diskutuar me autorët dhe të ndajnë me ne perspektivat nga të cilat mësuam shumë.

Parlamenti federal belg me mirësi ka mbështetur këtë publikim përmes përfshirjes aktive në Komisionin e përhershëm për mbikqyrje të shërbimeve të zbulimit (Komisioni I) në shkëmbimin e qëndrueshëm të praktikave të mira dhe mësimëve të nxjerra me kolegët nga Republika e Maqedonisë së Veriut.

Udhëzimet shqyrtojnë kornizën ligjvënëse maqedonase dhe sistemin për mbikqyrje dhe japin informacione për parimet ndërkombëtare dhe praktikën e mira në mbikqyrjen mbi zbulimin. Janë të parapara që të informojnë dhe mbështesin komisionet parlamentare në përmbushjen e mandatit të tyre të mbikqyrjes, që nga publikimi i parë, DCAF ka shfrytëzuar *Udhëzimet* si referencë në mbi 20 punëtori dhe ushtrime praktike të organizuara për komisionet parlamentare maqedonase. Nga ana e tyre, komisionet në mënyrë të drejtëpërdrejtë shfrytëzuan *Udhëzimet* për konceptualizimin dhe planifikimin e aktiviteteve mbikqyrëse që kanë kontribuar për përmirësimin e pakontestueshëm të performancës parlamentare në mbikqyrjen mbi zbulimin dhe sigurinë. Shpresojmë se ky version i reviduar i *Udhëzimeve* do të përgjigjet në pritshmëritë dhe nevojat e anëtarëve të rinj në Kuvend, duke vazhduar që të shërbejë si mjet i dobishëm dhe informativ për punën e tyre.

D-r Teodora Fuor, autorë kryesorë

Gjenevë, Janar, viti 2021



PËR DCAF

DCAF- Qendra e Gjenevës për qeverisjen e sektorit të sigurisë është e përkushtuar në përmirësimin e sigurisë të shteteve dhe popullit të tyre në kuadër të qeverisjes demokratike, sundimit të së drejtës, respektimit të së drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Nga themelimi në vitin 2000, DCAF ka kontribuar për një paqe dhe zhvillim më të qëndrueshëm duke u ndihmuar shteteve partnere dhe aktorëve ndërkombëtarë të cilët mbështesin këto shtete, që të përmirësojnë qeverisjen me sektorin e tyre të sigurisë përmes reformave përfshirëse dhe participative. Krijon produkte inovative të njohurisë, promovon norma dhe praktika të mira, jep këshilla juridike dhe politike dhe mbështet ndërtimin e kapaciteteve të palëve të përfshira nga sektori shtetëror dhe joshetëror i sigurisë.

Këshilli për themelimin e DCAF përbëhet nga përfaqësues të rreth 60 shteteve - anëtare dhe Kantonit të Gjenevës. Aktiv në mbi 80 vende, DCAF njihet ndërkombëtarisht si një qendrat udhëheqëse për qeverisjen e përkryer me sektorin e sigurisë (SSG) dhe reformat në sektorin e sigurisë (SSR). DCAF udhëhiqet sipas parimeve të neutralitetit, paanshmërisë, pronësisë lokale, pjesëmarrjes inkluzive dhe barazisë gjinore. Për më shumë informacione vizitoni faqen www.dcaf.ch dhe na ndiqni në Twitter në [@DCAF_Geneva](https://twitter.com/DCAF_Geneva).


DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance

Maison de la Paix
Chemin Eugène-Rigot 2E
CH-1202 Geneva, Switzerland
Tel: +41 22 730 94 00
info@dcaf.ch
www.dcaf.ch
Twitter [@DCAF_Geneva](https://twitter.com/DCAF_Geneva)

PËRMBAJTJA

Parathënie dhe falmenderim	2
Për DCAF	3
1. Hyrje	6
1.1 Çfarë paraqet mbikqyrja mbi shërbimet e zbulimit dhe pse është e rëndësishme?.....	7
1.2 Sfidat kryesore në qeverisjen demokratike në sektorin e sigurisë.....	9
2. Kornizat strategjike dhe ligjvënëse maqedonase për mbikqyrje mbi zbulimin	12
2.1 Korniza strategjike për sigurinë nacionale	13
2.2 Dispozitat ligjore për shërbimet e zbulimit	16
2.2.1 Bashkësia e sigurisë-zbulimit	19
2.2.1.1 Agjencia për zbulim.....	19
2.2.1.2 Agjencia e sigurisë nacionale.....	21
2.2.1.3 Shërbimi ushtarak për siguri dhe zbulim (SHUSZ)	23
2.2.2 Institucionet tjera të cilat kanë autorizime të zbatojnë metoda ndërhyrëse	24
2.2.2.1 Byroja për sigurinë publike.....	24
2.2.2.2 Drejtoria e policisë financiare	25
2.2.2.3 Drejtoria doganore	26
2.2.2.4 Qendra për vëzhgimin elektronik.....	27
2.2.3 Agjencia teknike - operative (ATO)	27
2.3 Sistemi maqedonas për mbikqyrje mbi zbulimin	29
2.3.1 Kontrolli i brendshëm	29
2.3.2 Kontrolli nga pushteti ekzekutiv.....	31
2.3.3 Mbikqyrja parlamentare	33
2.3.4 Trupat tjerë të pavarur	39
2.3.4.1 Këshilli për mbikqyrjen civile	39
2.3.4.2 Avokati i popullit	41
2.3.4.3 Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale	42
2.3.4.4 Drejtoria për sigurinë e informatave të klasifikuara	46
2.3.4.5 Enti shtetëror për revizion	46
2.3.4.6 Inspektorati shtetëror administrativ.....	47
2.3.4.7 Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat e karakterit publik	48
2.3.5 Prokurori publik/Gjyqësori.....	49

3. Aftësia e Komisionit për kryerjen e mbikqyrjes: vendosja e kushteve për mbikqyrje efektive	51
3.1 Procedurat e komisioneve	53
3.2 Takimet e përbashkëta dhe aktivitetet mbikqyrëse.....	55
3.3 Ekspertiza e komisionit.....	56
3.4 Qasja deri te informatat	59
3.4.1 Qasja parlamentare dhe përdorimi i informatave të klasifikuara.....	63
3.4.2 Qasja në ndarjen dhe shkëmbimin e informatave	66
3.4.3 Përdorimi, menaxhimi dhe ruajtja e të dhënave personale	68
4. Komisioni në veprim: mjetet për mbikqyrje	71
4.1 Raportet.....	73
4.2 Shqyrtimet.....	75
4.3 Vizitat në terren.....	78
4.3.1 Përgatitja	79
4.3.2 Zbatimi.....	80
4.3.3 Hapat e ardhshme të vizitës në terren	82
4.4 Aktivitetet anketuese.....	83
5. Jashtë nga cikli i fshehtësisë: mbikqyrja mbi zbulimin dhe qytetarët	88
5.1 Njoftimi publik.....	89
5.2 Vlerësimi i mbikqyrjes.....	91
5.3 Roli i shoqërisë civile në mbështetje të mbikqyrjes demokratike mbi zbulimin	93
6. Shtojcat	95
6.1. Shtojca A: Fjalori i nocioneve	96
6.2. Shtojca B: Pasqyra e legjislacionit maqedonas për mbikqyrjen parlamentare	100
6.3 Shtojca C: A Plani vjetor i aktiviteteve të Komisionit	116
6.4 Shtojca D: Pasqyrë e çështjeve në Planet vjetore të aktiviteteve.....	119
6.5 Shtojca E: Pasqyrë e aktorëve dhe proceseve	125



HYRJE

1.1 ÇFARË PARAQET MBIKQYRJA MBI SHËRBIMET E ZBULIMIT DHE PSE ËSHTË E RËNDËSISHME?

Mbikqyrja parlamentare i referohet ndjekjes të vazhdueshme¹, shqyrtimit, vlerësimit dhe hetimit të aktiviteteve të agjencive qeveritare dhe publike, duke përfshirë edhe zbatimin e politikave, legjislacionin dhe ekzekutimin e buxhetit shtetëror. Mbikqyrja parlamentare është një nga manifestimet më të rëndësishme të ndarjes të degëve të pushtetit në demokraci.

Mbikqyrja parlamentare duhet të përfshijë të gjithë sektorët e qeverisjes, duke përfshirë edhe shërbimet e zbulimit dhe sigurisë. Shërbimet e zbulimit punojnë në fshehtësi dhe kanë fuqinë që të shfrytëzojnë autorizimet e veçanta të cilat janë shumë invazive (ndërhyrëse) dhe shkelin të drejtat. Ndjekja e komunikimeve, mbikqyrja e fshehtë dhe hakimi janë vetëm dy autorizime të tilla. Për këtë shkak, shërbimet e zbulimit shihen me dyshim dhe mosbesim nga ana e publikut. Prandaj, nevoja për ligjshmëri, legjitimitet dhe llogaridhënie është më e madhe për shërbimet e zbulimit se sa për agjencitë tjera qeverit

› CILAT JANË DISA NGA AUTORIZIMET SPECIALE TË SHËRBIMEVE TË SIGURISË DHE ZBULIMIT?

- Përgjimi, pranimi, inçizimi dhe ndjekja e bisedave, telekomunikimi, apo bartja e të dhënave apo lëvizjeve në vend apo nga jashtë vendit.
- Kryerja e mbikqyrjes të fshehtë, evidentimi dhe ndjekja e informacioneve.
- Kryerja e bastisjes të hapësirave të mbyllave, hyrja (ndërhyrja) në pronë.
- Hapja e letrave dhe dërgesave tjera, pa pëlqimin e dërguesit apo adresantit.
- Kërkesa nga operatorët e rrjeteve publike të telekomunikimit të sigurojnë informacione në lidhje me identitetin e përdoruesve dhe qarkullimit që realizohet.
- Përdorimi i identiteteve të vjedhura apo të rrejshme, çelësave, softuerit për shënimin e fshehtë, kopjimin apo dëmtimin e bazave të të dhënave.
- Qasja deri te të gjithë vendet për instalimin e pajisjes për vëzhgim.
- Grumbullimi i informacioneve financiare për individët apo rrjetet.
- Përdorimi i burimeve të fshehta njerëzore.
- Vendosja dhe përdorimi i entiteve të rrejshme legale për mbështetjen e aktiviteteve operative.

Si ligjvënës, parlamenti është përgjegjës për miratimin e legjislacionit të qartë, të disponueshëm dhe gjithëpërfshirës që rregullon themelimin e shërbimeve të zbulimit dhe organizimin e tyre, autorizimet e tyre të veçanta dhe kufizimet. Aktivitetet mbikqyrëse parlamentare e shqyrtojnë, vlerësojnë dhe rishikojnë zbatimin e ligjeve dhe nëse dhe si operacionet e zbulimit janë në pajtim me kushtetutën, politikat e sigurisë nacionale, dhe legjislacionin. Parlamenti, gjithashtu, miraton buxhetet e shërbimeve të zbulimit dhe mund të luajë një rol të fuqishëm në mbikqyrje

¹ Në shumicën e shteteve, mbikqyrja parlamentare shqyrton aktivitetet dhe programet që tashmë i realizojnë shërbimet e zbulimit. Përjashtimi i vetëm është Kongresi i SHBA-së ku një numër i kufizuar i përfaqësuesve janë të informuar para se të fillojnë programet e ndjeshme zbuluese. Përzjerja eks-ante e parlamentit jo domosdoshmërisht lejon pjesëmarrjen e tyre në miratimin e vendimeve apo ndërprerjen e operacioneve, por mund të kompromentojë aftësinë e tyre që të të kritikojnë më vonë nëse diçka shkon keq.

gjatë ekzekutimit të buxhetit.

Mbikqyrja efektive parlamentare siguron urën ndërmjet informacioneve të zbulimit dhe qytetarëve dhe sjell përfitime për të gjithë: bashkësinë e zbulimit, vetë parlamentin dhe që është më e rëndësishme, për qytetarët.

- 1) Kur shërbimet e zbulimit mbajnë përgjegjësi dhe janë llogaridhënëse për përmbushjen e mandatit të tyre të rregulluar ligjor, përforcohet legjitimiteti dhe efikasiteti i tyre. Mbikqyrja mbron shërbimet e zbulimit nga keqpërdorimi politik dhe mund të ndihmojë që të krijohen vende të punës që janë me qëllim të mirë, të bazuara në meritokraci dhe jodiskriminuese për profesionistët e zbulimit. Llogaridhënia e përforcuar e shërbimeve të zbulimit e përmirëson besimin e qytetarëve në Qeveri.
- 2) Përfshirja efektive parlamentare në mbikqyrjen mbi zbulimin, e cila i lë pas dallimet politike dhe fokusohet në interesat nacionale, e ndihmon parlamentin që të ndërtojë kredibilitetin e tij si institucion demokratik dhe e përforcon respektin dhe besimin që e fiton nga bashkësia e zbulimit dhe qytetarët.
- 3) Mbikqyrja efektive mbron të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe siguron vendosjen e masave përkatëse mbrojtëse që të parandalohet zbatimi i gabuar apo keqpërdorimi i pushtetit. Mbikqyrja ka një rëndësi thelbësore për sundimin e të drejtës, për respektimin e të drejtave të njeriut, por gjithashtu dhe që të sigurohet që paratë e detyruesve tatimor shpenzohen në mënyrë efikase dhe ekonomike

› PSE ËSHTË E RËNDËSISHME MBIKQYRJA MBI ZBULIMIN?

Shërbimet e zbulimit dhe të sigurisë luajnë një rol jetik në mirëmbajtjen e sigurisë të shtetit. Debatet e hapura dhe publike për funksionet dhe autorizimet e tyre paraqesin një presion për përmirësimin e profesionalizmit dhe efikasitetit. Pa kontroll dhe mbikqyrje që do të sigurojnë se shërbimet e zbulimit u shërbejnë interesave nacionale dhe punojnë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet, shërbimet mund të bëhen gjeneratorë të krizave në vend të garantuesve të sigurisë.

Natyra e punës të zbulimit imponon shkeljen e ligjeve dhe të drejtave të njeriut. Sa më i madh është numri i syve që ndjekin shkeljet dhe zërat të cilat kërkojnë që këto shkelje të sillen në minimum, aq më mirë.

Siguria është e mirë publike për të cilën paguajnë qytetarët. Agjencitë për zbulim dhe siguri shpenzojnë para publike dhe duhet të jenë llogaridhënëse para detyruesve tatimorë.

Ekziston një funksion i rëndësishëm i edukimit publik që duhet realizohet përmes mbikqyrjes. Me këtë në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë mund të ndërtohet mbështetja e komunitetit për punën e rëndësishme të agjencive të zbulimit dhe sigurisë.

Nevoja e shërbimeve për siguri të brendshme që të pranohen publikisht është më e lartë në vendet me regjime të mëparshme autokratike – të cilat në të kaluarën kanë përdorur shërbimet e sigurisë për qëllimet personale. Shërbimet janë të prirura për dyshime nga qytetarët, mosbesim dhe sulme të legjitimitetit të tyre. Mbikqyrja u ndihmon shërbimeve që të rikthejnë kredibilitetin e tyre publik dhe të ripërkufizojnë vendin e tyre në shoqërinë demokratike.

1.2 SFIDAT KRYESORE NË QEVERISJEN DEMOKRATIKE NË SEKTORIN E SIGURISË

Mbikqyrja mbi zbulimin është vetëm një pjesë në mekanizmat sfiduese dhe të komplikuar të vendosura në shtetet bashkëkohore me qëllim të sigurimit të qeverisjes demokratike në sektorin e sigurisë, që përbëhet nga të gjitha strukturat, institucionet dhe personeli përgjegjës për sigurinë, qeverisjen dhe mbikqyrjen e nivelit nacional dhe lokal.

Sistemi për sigurinë nacionale ka karakteristika të veçanta që sjell roli i tij qëndror në realizimin e monopolit legjitim shtetëror në përdorimin e forcës. Ai akumulon fuqi të madhe dhe shumë aspekte nga puna e tij janë të mbuluara me fshehtësi. Megjithatë, sektori i sigurisë ka shumë karakteristika të përbashkëta me shërbimet tjera publike dhe duhet të përmbush standarde të ngjajshme (nëse jo edhe të njëjta) për efikasitet, drejtshmëri dhe përgjegjësi si dhe shërbimet tjera (publike). Në mungëse të mekanizmave përkatëse për kontroll dhe mbikqyrje, shërbimet e zbulimit dhe sigurisë lehtësisht mund të përfshihen në aktivitete të kundërligjshme, joefikasitet, keqpërdorim të pushtetit apo mund të përdoren për qëllime politike.

Qeverisja e mirë me sektorin e sigurisë e pasqyron përgjegjësinë e shtetit që të sigurojë siguri efikase dhe efektive, e njëkohësisht siguron llogaridhënie të shërbimeve të sigurisë dhe pajtueshmërinë e tyre me ligjin dhe standardet për të drejtat e njeriut.

› KARAKTERISTIKAT E PËRBASHKËTA TË SISTEMEVE EFEKTIVE DHE LLOGARIDHËNËSE TË SIGURISË:

- a) **Korniza ligjore dhe/ose kushtetuese** parashikon përdorimin legjitim dhe përgjegjës të forcës në pajtim me normat dhe standardet e pranuar globale për të drejtat e njeriut, duke përfshirë mekanizmat për sanksionimin e përdorimit të forcës dhe identifikimin e roleve dhe përgjegjësive të palëve të ndryshme të përfshira;
- b) Është vendosur **sistemi i institucionalizuar i leadershipit dhe qeverisjes**, duke përfshirë: mekanizmat për udhëzim dhe mbikqyrje mbi sigurinë nga ana e pushteteve dhe qeverive, sistemet për menaxhim efikas dhe kontroll, si dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- c) **Kapacitetet**: struktura, personeli, pajisja dhe burimet për sigurimin e sigurisë efikase;
- d) **Mekanizmat e bashkëveprimit** ndërmjet palëve të përfshira në siguri: vendosja e modaliteteve transparente për koordinim dhe bashkëpunim ndërmjet palëve të ndryshme të përfshira, të bazuara në rolet e tyre kushtetuese/ligjore dhe përgjegjësitë;
- e) **Cultura e shërbimit**: promovimi i unitetit, integritetit, disiplinës, paanshmërisë dhe respektimi i të drejtave të njeriut ndërmjet palëve të përfshira në siguri dhe formësimi i mënyrës në të cilën ata i kryejnë detyrat individuale.

Si institucione që përfaqësojnë qytetarët dhe bartësit e pushtetit ligjvënës, parlamenteve u është besuar kontrolli dhe mbikqyrja mbi pushtetin ekzekutiv në të gjithë fushat e pushtetit, duke përfshirë edhe sektorin e sigurisë. Parlamentet e mbikqyrin mandatin, autorizimet, organizimin, punën dhe financimin e të gjithë institucioneve në kuadër të sistemit të sigurisë. Për shkak të kompleksitetit, natyra politike e fshehtësisë që karakterizon punën e institucioneve të sigurisë, është jashtëzakonisht e rëndësishme që parlamenti të ketë autorizime të mjaftueshme ligjore, aftësi dhe përgatitje për mbikqyrje efikase. Qëllimi kryesor i mbikqyrjes parlamentare është që të sigurojë një ekuilibër ndërmjet shoqërisë dhe politikës të sigurisë gjatë realizimit të qëllimeve, politikave dhe procedurave të institucioneve në kuadër të sistemit të sigurisë, të cilat shpesh ndërhyjnë në të drejtat dhe liritë civile të garantuara me Kushtetutë.

Llogaridhënia demokratike e sektorit të sigurisë përfshin disa parime themelore: transparencë, ligjshmëri, llogaridhënie, pjesëmarrje dhe përfshirje të publikut. Pjesëmarrja duhet të shqyrtohet me kujdes dhe të mbahet mend nga çdo parlament, sepse, sadoqë mund të jetë i fuqishëm dhe efektiv, parlamenti asnjëherë nuk do të mund të sigurojë në mënyrë të pavarur përgjegjësi demokratike. Mbikqyrja parlamentare është vetëm një nga pesë nivelet e ndryshme të llogaridhënies të sektorit të sigurisë, të cilat duhet të kompletohen dhe të përforcohen njëra me tjetrën, kurse nivelet tjera janë kontrolli i brendshëm nga ana e vetë shërbimeve të sigurisë, kontrolli ekzekutiv nga ministrat dhe menaxherët tjerë të caktuar politik, kontrolli gjyqësorë dhe mbikqyrja e jashtme nga ana e mediave dhe shoqërisë civile.

Më tutje, ekzistojnë disa parakushte të cilat e bëjnë të mundur dhe funksional mbikqyrjen demokratike dhe parlamentare²:

- Shteti duhet të jetë aktori i vetëm në shoqëri që ka monopolin legjitim të forcës, dhe me këtë edhe sistemi i sigurisë do të jetë llogaridhënës para pushteteve legjitime demokratike;
- Parlamenti është sovran dhe e konsideron pushtetin ekzekutiv përgjegjës për zhvillimin dhe realizimin e politikës të sigurisë;
- Parlamenti ka një rol kushtetues që të përmirësojë dhe kontrollojë buxhetin e destinuar për nevojat e sistemit të sigurisë;
- Parimet e qeverisjes të mirë dhe sundimit të të drejtës zbatohen në të gjithë sektorët e Qeverisë, e sipas kësaj edhe në sektorin e sigurisë;
- Personeli i sistemit të sigurisë personalisht jep llogaridhënie para gjykatave për shkeljen e ligjeve nacionale dhe ndërkombëtare;
- Sistemi i sigurisë duhet të jetë politikisht neutral.

› CILAT JANË SFIDAT E ZAKONSHME PËR MBIQYRJEN DEMOKRATIKE MBI ZBULIMIN?

Fshehtësia: qeverisja, kontrolli dhe mbikqyrja mbi byrokracinë e madhe qeveritare është një proces më i ndërlikuar kur ka nevojë për fshehtësi. Institucionet e pavarura, por të ndërthurura mbikqyrëse me autorizime të qarta për qasje deri te informacionet mund të ndihmojnë gjatë tejkalimit të këtij problemi.

Diskrecioni: Profesionistët e zbulimit më së shpeshti kanë të drejtë diskrecionale që të marrin vendime të pavarura në punën e tyre. Mbikqyrja efektive te ato është një proces afatgjatë dhe i vështirë.


² Oliver Bakreski (2010): Roli i parlamentit në sektorin e sigurisë, Mbrojtja bashkëkohore maqedonase, nr.19, Ministria e mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, Shkup, fq 43

Vullneti politik: për shkak të nivelit të fshehtësisë në shërbimet e zbulimit, sigurimi i llogaridhënies të tyre nuk është gjithmonë i dobishëm për fitimin e votave. Prandaj, përfaqësuesit e zgjedhur mund të mos kenë stimulim që të investojnë kohë në mbikqyrjen mbi zbulimin. Sadoqë të jetë elegante struktura e mbikqyrjes, ajo do të jetë efektive vetëm nëse subjektet për mbikqyrje punojnë shumë.

Perceptimi i tepruar për ekzistimin e kërcënimit: kërcënimet e perceptuara për sigurinë nacionale mund të përdoren që të arsyetohen veprimet të cilat mund të jenë joproporcionale me kërcënimin dhe të dëmshme për parimet e qeverisjes demokratike, të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës. Kërkohet nivel i lartë i profesionalizmit, pavarësisht politike dhe mbikqyrjes efektive që të sigurohet analiza e të dhënave të zbulimit e cila nuk e mbivlerëson as nuk e nënvlerëson rrezikun nga kërcënimet për sigurinë nacionale.

Fushëveprimi ndërkombëtar: bashkëpunimi ndërkombëtar i zbulimit i zgjeron autorizimet dhe aktivitetet e shërbimeve nacionale të zbulimit jashtë mbulimit të sistemeve nacionale për kontroll dhe mbikqyrje. Autorizimet mbikqyrëse nuk përhapen jashtë nga jurisdiksioni nacional, por përkufizimi i fushëveprimit dhe natyrës të bashkëpunimit ndërkombëtar mund të parandalojë keqpërdorimin dhe të përforcojë kredibilitetin e shërbimeve nacionale të zbulimit.

Teknologjia: teknologjitë të cilat përdoren në punën e zbulimit përparojnë më shpejtë nga kompetencat dhe autorizimet për mbikqyrjen dhe kontrollin e tyre, që sjell deri te lëshimet respektivisht dështimet në llogaridhënie. Ekspertët teknik mund t'u sigurojnë trupave mbikqyrëse informacione thelbësore, ndërsa trupat ligjvënës duhet të mirëmbajnë kornizat ligjore që janë përfshirë mjaftueshëm për të mundësuar hyrje edhe të ndryshimeve të tilla.



KORNIZAT STRATEGJIKE DHE LIGJVËNËSE MAQEDONASE PËR MBIKQYRJE MBI ZBULIMIN

Qeverive dhe parlamenteve u nevojitet zbulim i cilësisë të lartë që të miratohen vendime përkatëse për sigurinë nacionale në më shumë fusha, nga vendosja e vëllimit dhe buxhetit të shërbimeve speciale të sigurisë deri te autorizimi për përdorimin e forcës. Krahas asaj që janë përdorues të informacioneve të zbulimit, parlamentet debatojnë, negociojnë dhe miratojnë dokumente strategjike dhe juridike të cilat e krijojnë mjedisin në të cilin funksionojnë shërbimet e zbulimit. Korniza ligjvënëse gjithashtu i përcakton **autorizimet ligjore** të Parlamentit dhe komisioneve të tij gjatë kryerjes të mbikqyrjes.

Kjo pjesë do të shqyrtojë kornizën momentale strategjike dhe ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke mundësuar vlerësim të shpejtë të dispozitave kryesore ligjore me të cilat rregullohet puna e zbulimit, organizimi i shërbimeve të ndryshme dhe llojet e informacioneve të cilat janë publikisht të disponueshme për autorizimet e zbulimit, metodat dhe mjetet. Mbikqyrja parlamentare përfshin detyrimin dhe përgjegjësië për të siguruar qartësi dhe gjithëpërfshirje të kornizave strategjike dhe juridike. Reforma e madhe ligjvënëse e ndërmarrë nga pushtetet maqedonase në vitet 2018-19 tregon se mangësitë potenciale në planifikimin strategjik dhe në legjislacion, me kujdes i shqyrtojnë ata që janë përgjegjës, ashtuqë qeverisja me shërbimet e zbulimit dhe llogaridhënia vazhdimisht përmirësohen.

2.1 KORNIZA STRATEGJIKE PËR SIGURINË NACIONALE

Në demokraci, shoqëria, dhe jo shërbimet e sigurisë, është ajo që përkufizon interesin nacional dhe atë që paraqet kërcënim për sigurinë nacionale. Ajo paraqet një proces të gjatë që rezulton me formimin e politikës dhe legjislacionit nacional të sigurisë. Përfshirja e parlamentit në debat dhe/ose në miratimin e politikave strategjike dhe dokumenteve për planifikim është pika fillestare e mbikqyrjes. Dy gjëra duhet të jenë në fokusin e parlamentit në lidhje me kornizën strategjike:

- Dokumentet për planifikimin strategjik duhet të kënaqin vlerat dhe parimet e përcaktuara me Kushtetutë;
- Shërbimet e sigurisë duhet të zbatojnë autorizimet e tyre në kuadër të qëllimeve, mandateve, prioriteteve dhe kufizimeve të përcaktuara në kornizën strategjike për siguri.

Korniza strategjike për siguri duhet të drejtohet drejtë jetës, vlerave dhe mirëqënies të njerëzve, duke integruar perspektivat, të cilat duhet të jenë të disponueshme për bashkësitë e ndryshme që përbëhen nga mosha të ndryshme, gjini, religjione, etnikume, orientime seksuale, dhe pakica tjera. Korniza strategjike që nuk është gjithëpërfshirëse, e përditësuar dhe e disponueshme për publikun mund të llogaritet si dobësi e qeverisjes demokratike, që e pengon qasjen koherente dhe strategjike drejtë mbikqyrjes të sektorit të sigurisë.

Dokumentet afatmesme dhe afatgjate, siç janë politikat nacionale të sigurisë, sigurojnë një kornizë të integruar që të përshkruhet se si vendi siguron mbrojtje për shtetin dhe qytetarët e tij. Këto dokumente gjithashtu mund të quhen *plan, strategji, libër i bardhë, koncept apo doktrinë*. Ata përkufizojnë nevojat dhe prioritet e sigurisë, identifikojnë institucionet përgjegjëse për aspektet e ndryshme të sigurisë dhe u japin udhëzime për politikat si dhe për resurset dhe mjetet që përdoren që të arrihen qëllimet e pritura të sigurisë. Ndonjëherë ekzistojnë edhe versione publike dhe të klasifikuara të dokumenteve të tilla, me qëllim që të balancohet nevoja për transparencë dhe fshehtësi. Përgjegjësitë për përgatitjen, miratimin dhe përditësimin e dokumenteve të tilla duhet që qartësohen me ligj, kurse komisionet parlamentare duhet të bëjnë presion mbi qeverinë që të respektojë afatet e përkohshme të këtij procesi.

› **CILAT JANË DISA PYETJE THEMELORE STRATEGJIKE NË MBIKQYRJEN MBI ZBULIMIN?**

- A punojnë zbuluesit në kuadër të kornizës strategjike të përcaktuar nga Qeveria dhe të miratuar nga Parlamenti?
- A kanë shërbimet e zbulimit autorizime të mjaftueshme ligjore, buxhet dhe personel që të përmbushin mandatin e tyre?
- Cilat probleme sistimore janë paraqitur në sektorin e sigurisë si rezultat i aktivitetit apo procesit të zbulimit?
- A janë keqpërdorur shërbimet e zbulimit nga liderët politik? Nëse po, si mund të parandalohet një gjë e tillë?
- A japin profesionistët për zbulim një analizë të paanshme dhe objektive apo analiza e tyre është e politizuar?

The most comprehensive strategic document for national security in the Republic of North Macedonia is the National Security Concept. Dokumenti më gjithëpërfshirës për sigurinë nacionale në Republikën e Maqedonisë së Veriut është **Koncepti nacional për siguri dhe mbrojtje**³. Koncepti i përcakton interesat nacionale, siguron një analizë për mjedisin e përgjithshëm të sigurisë (duke përfshirë rreziqet, kërcënimet dhe mundësitë) dhe vendos qëllimet dhe drejtimit për politikën nacionale të sigurisë dhe mbrojtjes. Koncepti asnjëherë nuk është përditësuar pas miratimit nga ana e Parlamentit në vitin 2003.

Koncepti kërkon nga Qeveria që më tutje të hartojë dhe miratojë një **Strategji të integruar për sigurinë nacionale**“ sa më shpejtë që është e mundur”. Kjo ka ndodhur në vitin 2008, por dokumenti nuk është i disponueshëm për publikun.

Presidenti miraton **Strategjinë nacionale për mbrojtje**, të përgatitur nga Ministria e mbrojtjes⁴. Strategjia e fundit për mbrojtje daton nga 24 marsi i vitit 2020⁵. Dokumenti nuk është diskutuar as nuk është miratuar nga ana e Parlamentit

Këshilli për siguri i Republikës të Maqedonisë së Veriut ka marrë një vend të rëndësishëm në funksionimin e sistemit të sigurisë. Këshilli i sigurisë përbëhet nga: Presidenti i Republikës së **Maqedonisë së Veriut, kryetari** i Kuvendit të Republikës së **Maqedonisë së Veriut, kryetari** i Qeverisë të Republikës së **Maqedonisë së Veriut, ministrat që udhëheqin me organet e administratës shtetërore në fushat e sigurisë, mbrojtjes dhe punëve të jashtme dhe tre anëtarë të cilët i emëron** presidenti i Republikës së **Maqedonisë së Veriut**. Presidenti i Republikës së **Maqedonisë së Veriut është edhe kryetar i Këshillit të sigurisë. Gjatë emërimit të tre anëtarëve**, presidenti kujdeset që përbërja e Këshillit të pasqyrojë në mënyrë përkatëse përbërjen e popullsisë në vend. Rregullimi i funksionit të Këshillit për siguri i Republikës së Maqedonisë së Veriut është rregulluar me Kushtetutën⁶ e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Këshilli shqyrton dhe iniciçon çështje në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit dhe formulon dhe u jep propozime Kuvendit dhe Qeverisë, të cilat më tutje duhet t'i miratojnë, pranojnë apo t'i

3 Neni 17, Ligji për mbrojtje, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 42/2001, 05/2003, 58/2006, 110/2008, 51/2011, 151/2011, 215/2015, 42/2020, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Maqedonisë V.nr.37/2002 (Gazeta zyrtare nr. 73/2002) dhe V.nr135/2002 dhe 155/2001 (Gazeta zyrtare nr. 78/2002)

4 Neni 18, Ligji për mbrojtje, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 42/2001, 05/2003, 58/2006, 110/2008, 51/2011, 151/2011, 215/2015, 42/2020, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Maqedonisë V.nr37/2002 (Gazeta zyrtare nr. 73/2002) dhe V.nr.135/2002 dhe 155/2001 (Gazeta zyrtare nr. 78/2002)

5 Strategjia për mbrojtje e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 75/2020 e miratuar në bazë të nenit 18 pq. 1, 1 nga Liqii për mbrojtje. Gazeta zurtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 42/2020

6 Neni 86 dhe amendamenti XIII, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 52/1991

kenë parasysh gjatë kryerjes të funksioneve të tyre, sidomos të atyre të lidhura me mbrojtjen, sigurinë dhe mbrojtjen e vendit.

Edhe pse Këshilli i sigurisë paraqitet në rolin e organit këshillëdhënës, duke patur parasysh përbërjen e tij dhe çështjet për të cilat diskuton dhe ndërton qëndrime, mendime dhe merr përfundime, pa dyshim se bëhet fjalë për një organ jashtëzakonisht të rëndësishëm. Ai luan një rol thelbësorë në krijimin e politikës të mbrojtjes dhe sigurisë të shtetit, dhe në funksionimin e përgjithshëm të sistemeve të mbrojtjes.

Reformat të cilat ishin zbatuar në sektorin e sigurisë - zbulimit në vitet 2017-202 kanë kushtëzuar një nevojë më të madhe për koordinim, respektivisht vendosjen e mekanizmave për përballje në kohë dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse me rreziqet e sigurisë dhe shkallëzimin e nivelit të kërcënimeve të sigurisë nacionale. Për qëllimet e koordinimit të bashkësisë të sigurisë - zbulimit është formuar **Këshilli për koordinim të bashkësisë të sigurisë - zbulimit**.

Këshilli për koordinim i bashkësisë të sigurisë-zbulimit përbëhet nga: kryetari i Qeverisë së Republikës të Maqedonisë së Veriut; zëvendës kryetari i Qeverisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut përgjegjës për zbatimin e Marrëveshjes të Ohrit dhe sistemit politik; ministri i punëve të brendshme; ministri i mbrojtjes; ministri i punëve të jashtme; ministri financave; drejtori i Agjencisë të sigurisë nacionale; drejtori i Agjencisë për zbulim dhe udhëheqësi i njësisë kompetente organizative për siguri ushtarake dhe zbulim në Ministrinë e mbrojtjes⁷. Këshilli duhet të kontribuojë në tejkalimin e dobësive dhe mangësive në funksionimin e shërbimeve të sigurisë-zbulimit, si dhe në sigurimin e shkallës më të lartë të efikasitetit dhe suksesit në punën e tyre.

› **NEVOJA PËR KOORDINIM TË BASHKËSISË TË SIGURISË - ZBULIMIT PARASHIHET PËR SHKAK TË⁸:**

- Mënyrës të koordinuar të veprimit të shërbimeve të sigurisë-zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- Vlerësimit të përbashkët për fushat që janë lëndë e interesit të përdoruesve dhe kornizat e përbashkëta në lidhje me prioritetet e sigurisë,
- Informimit të presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetarit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Qeverisë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në bazë të vlerësimit të bazuar në informacione nga të gjithë burimet relevante të grumbulluara me përdorimin me efikas të resurseve,
- Politikës të integruar të sigurisë.

Në kuadër të këtij Këshilli formohet Zyra e veçantë⁹ që është përgjegjëse që të bashkojë dhe të vlerësojë objektivitetin dhe relevancën e raporteve të parashtruara, njoftimeve, analizave, vlerësimeve dhe informacioneve tjera të shërbimeve të sigurisë-zbulimit, të cilat janë të rëndësishme për kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë-zbulimit për sigurinë nacionale të shtetit. Gjithashtu, ajo përgatit raporte me rekomandime për sigurinë nacionale, si dhe harton vlerësime për shkallën e kërcënimeve për sigurinë nacionale të shtetit. Me zyrën udhëheq Sekretari, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhë prej dy vitesh.

⁷ Ligji për koordinim të bashkësisë të sigurisë-zbulimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Gazeta zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut nr. 108/2019

⁸ Po aty, neni. 4 pg 2

⁹ Po aty, neni 12

Krahas dokumenteve strategjike të cilat janë specifike për sigurinë dhe zonën e mbrojtjes, informacione të rëndësishme janë dhënë në **Programin e Qeverisë** i cili e përcakton kornizën afatmesme të reformave të ardhshme dhe bazën, në bazë të së cilës pushteti ligjvënës, buxhetet vjetore dhe planet për aktivitete do të përgatiten nga ana e pushtetit ekzekutiv. Dokumenti prezantohet në Parlament për shqyrtim dhe miratim, e pasiqë të miratohet, duhet të bëhet pikë kryesore e referencës për vlerësimin e efikasitetit të Qeverisë. Aktivitetet parlamentare mbikqyrëse duhet të rrjedhin gjithmonë nga masat konkrete, reformat, politikat dhe detyrimet e ndërmarra në Programin e Qeverisë. Programi i Qeverisë 2017-2020 i përkufizon reformat e Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim (DSK) si prioritet kryesor, që ishte zbatuar në vitin 2018, duke u udhëhequr nga rekomandimet e Pribesë dhe praktika më e mirë e Europës. Krahas asaj, Qeveria detyrohet që në tërësi të mbështesë mbikqyrjen parlamentare mbi shërbimet¹⁰.

Në bazë të Programit të Qeverisë, çdo ministri në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut zhvillon një **plan strategjik** trevjeçar i cili përditësohet në nivel vjetor. Këto dokumente i shqyrtojnë rezultatet e arritura nga ministria në vitin paraprak dhe përcaktojnë misionin, vizionin, parimet e punës dhe prioritet për periudhën e ardhshme trevjeçare. Planet strategjike të Ministrisë të punëve të brendshme dhe Ministrisë të mbrojtjes¹¹ mund të informojnë deputetët për çështjet siç janë: programet e planifikuara zhvillimore, projektet e ardhshme, strategjitë që duhet të miratohen, zhvillimi i burimeve njerëzore dhe të ngjajshme. Por, planet strategjike të këtyre ministrive nuk udhëzojnë në aktivitetet e sektorëve të tyre të zbulimit; as që sqarojnë se si integrohen aktivitetet e zbulimit në strategjinë e përgjithshme të ministrisë. Megjithatë, këto informacione duhet të jenë të disponueshme për komisionet parlamentare me kërkesë të tyre. Nga ministrinë mund të kërkohej që të përgatisin një verzion publik të planit strategjik dhe verzion të klasifikuar (që përfshin njësitë e zbulimit), në dispozicion të komisioneve relevante.

2.2 DISPOZITAT LIGJORE PËR SHËRBIMET E ZBULIMIT

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe *sundimit të së drejtës*¹² kërkojnë që mandati dhe autorizimet e shërbimeve të zbulimit të përkufizohen në legjislacion. Ligji duhet të jetë i qartë, i parashikueshëm dhe i disponueshëm. Masat mbrojtëse kundër veprimit arbitrar duhet të bazohen mirë në legjislacion, që të sigurohet kundërpeshë e fshehtësisë dhe të garantojnë kundër diskriminimit, shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe mungesës të llogaridhënies. Qeveria mund të përgatise akte nënligjore, siç janë dekrete, urdhërat e ministrave apo udhëzimet e ministrave, të cilat nuk janë vënë në dispozicion të publikut. Megjithatë, ata nuk duhet të përfshijnë vetëm informacionet konkrete që do të mund të rrezikonin punën e shërbimeve të zbulimit dhe/ose të sigurisë nacionale nëse shpallen (publikohen) (siç janë metodat operative dhe përdorimi i pajisjeve të caktuara apo teknologjive). Rregullativat të cilat nuk shpallen duhet të jenë në pajtim me ligjet ekzistuese publike dhe me kushtetutën.

¹⁰ Shihni faqen 27 të dokumentit: Programi i Qeverisë 2017-2020

¹¹ MPB ka miratuar Planin Strategjik trevjeçar 2020-2022 të datës 10.02.2020. MM ka miratuar një Plan afatgjatë për zhvillim të aftësive mbrojtëse për periudhën 2019-2028. Dokumentet janë të disponueshme në formë elektronike (onlajn): [https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/STRATESKI%20PLAN%202020-2022\(1\).pdf](https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/STRATESKI%20PLAN%202020-2022(1).pdf); <http://www.mod.gov.mk/wp-content/uploads/2019/10/%D0%94%D0%9F%D0%A0%D0%9E%D0%A1-2019-2028-finalna-verzija.pdf>

¹² Parimi sipas të cilit të gjithë anëtarët në shoqëri (duke përfshirë edhe ata në Qeveri) konsiderohen se janë njësoj të ekspozuar në kodekse dhe proceset ligjore të shpallura publikisht.

› CILAT JANË STANDARDET AKTUALE EUROPIANE PËR CILËSINË E LIGJIT ME TË CILAT RREGULLOHET ZBULIMI?

Këshilli për të drejtat e njeriut pranë KB rekomandon që të gjithë shërbimet e zbulimit të konstituohen dhe të punojnë në pajtim me të gjithë ligjet që janë publikisht të disponueshme të cilat janë në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Shërbimet e zbulimit mund të ndërmarrin apo të detyrohen që të ndërmarrin aktivitete të cilat janë parashikuar dhe janë në pajtim me ligjet nacionale. Përdorimi i akteve nënligjore të cilat nuk janë publikisht të disponueshme është rreptësisht i ndaluar dhe dispozitat e tilla janë miratuar dhe mbesin në kuadër të ligjeve që janë publikisht të disponueshme. Dispozitat të cilat nuk shpallen nuk do të shërbejnë si bazë për aktivitetet të cilat kufizojnë të drejtat e njeriut. *(Raporti i UNHCR i raportuesit special Martin Shajnin, Praktikët e mira të KB për mandatin dhe bazën ligjore, Praktika 4, viti 2010)*

Gjykata europiane e të drejtave të njeriut (GJEDNJ) ka përcaktuar se kornizat ligjore nacionale duhet të jenë të qarta, të disponueshme dhe të parashikueshme. I detyron shtetet-anëtare që të përmbajnë masat minimale mbrojtëse në ligj, siç janë përmendja e natyrës të veprave penale të cilat mund të sjellin deri te urdhërat për përgjim dhe përkufizim të kategorive të njerëzve të cilët mund të vendosen nën mbikqyrje *(shihni, për shembull, Roman Zaharov kundër Rusisë, nr. 47143/06, 4 dhjetor 2015., paragrafi 227-231)*

Agjencia e Bashkimit European për të drejtat fundamentale (ABE) rekomandon që vendet-anëtare të BE-së të kenë ligje të qarta, konkrete, dhe gjithëpërfshirëse të zbulimit. Kornizat nacionale ligjore duhet të jenë sa më të hollësishme që është e mundur reth mandateve dhe autorizimeve të shërbimeve të zbulimit, si dhe për masat për ndjekje të cilat mund të përdoren. Mekanizmat mbrojtëse për mbrojtjen e të drejtave fundamentale duhet të përmenden në ligjet për zbulim, me garanca për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave për grumbullimin, mbajtjen, shpërndarjen dhe qasjen deri te të dhënat. *(ABE, Ndjekja nga ana e shërbimeve të zbulimit, viti 2017)*

Gjykata e drejtësisë e BE-së thotë se legjislacioni nacional duhet, në fillim, të përcaktojë rregulla të qarta dhe precize me të cilat rregullohet fushëveprimi dhe zbatimi i masës për mbajtjen e të dhënave dhe imponimin e masave minimale mbrojtëse, ashtuqë personat, të dhënat e të cilëve janë mbajtur të kenë garanca të mjaftueshme për mbrojtje efikase të të dhënave të tyre personale kundër rrezikut nga keqpërdorimi. Ky legjislacion në veçanti duhet të tregojë se në cilat rrethana dhe nën cilat kushte mund të miratohet masa për mbajtjen e të dhënave si masë parandaluese, me çka do të sigurohet se masa e tillë është kufizuar në atë që është rreptësisht e domosdoshme. *(GJDBE, lëndët e bashkuara C-203/15 dhe C-698/15, Tele2 Sverige dhe Votson kundër ministrit të punëve të brendshme, 21 dhjetor të vitit 2016, paragrafi 109)*

Misioni i shërbimeve të zbulimit është që të mbrojnë sigurinë nacionale dhe të parandalojnë kërcënimet për sigurinë nacionale. Prandaj, mënyra, në të cilën legjislacioni nacional përcakton **konceptin e sigurisë nacionale dhe kërcënimet për sigurinë nacionale** përcakton bazat ligjore për punën e zbulimit.

Por, kjo është fushë në të cilën nuk ka standarde të qarta ndërkombëtare. Përkufizimi i sigurisë nacionale konsiderohet si *çështje e sovranitetit nacional*; si *është përkufizuar siguria nacionale* dhe kërcënimet për sigurinë nacionale, vendoset në mënyrë diskrecionale nga ana e parlamenteve nacionale.

- e drejtësisë nuk ka kompetenca për rastet që përfshijnë masat e zbatuara nga pushtetet nacionale për mbrojtjen e sigurisë të brendshme të anëtarëve të BE-së
- Siguria nacionale përmendet në paragrafin 2 të neneve 8, 10 dhe 11 nga **Konventa europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ)** si një nga “qëllimet legjitime” që i mundëson shteteve të zbatojnë autorizimet e jashtëzakonshme që mund të kufizojnë mbrojtjen që zakonisht u jepet të drejtave themelore.
- Praktika gjyqësore e **Gjykatës europiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ)** në fushën e sigurisë nacionale rritet në vitet e fundit, duke u bërë udhëzimi kryesor për përkufizimin e ekuilibrit të drejtë ndërmjet imperativave të sigurisë nacionale dhe respektimit të të drejtave të njeriut në kornizat rregullatore dhe praktikën nacionale. Nocioni mbetet jo i përkufizuar qartësisht, kurse GJEDNJ i jep shkallë të caktuar të fleksibilitetit, të pasqyruar nga “margjina e vlerësimit” që e kanë shtetet në këtë sferë. Nocioni “margjina e vlerësimit” i referohet hapësirës për manovrimë që organet nga Strazburgu janë të gatshme t’ua japin pushteteve nacionale, në përmbushjen e detyrimeve të tyre në pajtim me Konventën Europiane për të drejtat e njeriut.¹³ Megjithatë, praktika gjyqësore europiane ka mundësuar që të jepet thelbi i caktuar *për konceptin e sigurisë nacionale. Definitivisht përfshin mbrojtjen e sigurisë shtetërore dhe demokracisë kushtetuese nga spiunazhi, terrorizmi, mbështetja e terrorizmit, separatizmi dhe nxitja e shkeljes të disiplinës ushtarake.*¹⁴

Nocioni i sigurisë nacionale për herë të parë është përkufizuar ligjërisht në Ligjin për koordinim të bashkësisë të sigurisë-zbulimit, të miratuar në vitin 2019. Në pajtim me këtë ligj, “siguria nacionale është gjendje e stabilitetit social, ekonomik dhe politik që është e domosdoshme për mbijetesën dhe zhvillimin e shtetit si shtet sovran, demokratik, të pavarur dhe social, si dhe për mbajtjen e rregullit kushtetues, gjendjen e realizimit të pandërprerë të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit në pajtim me Kushtetutën “.¹⁵

Ky përkufizim ligjor është harmonizuar me parimet e përgjithshme të dokumenteve ndërkombëtare. Interesat nacionale të sigurisë dhe mbrojtjes të Maqedonisë së Veriut, të cilat drejtëpërdrejtë dalin nga vlerat themelore të përcaktuara me Kushtetutë, e të cilat janë:

- Ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial dhe karakterit unitar të shtetit si kornizë thelbësore për ruajtjen dhe avancimin e identitetit shtetëror dhe kujdesin respektivisht edukimin e lirë dhe shprehjen e identitetit etnik dhe kulturor të të gjithë qytetarëve;
- Mbrojtja dhe avancimi i paqes dhe sigurisë, i jetës dhe shëndetit, i pronës dhe sigurisë personale të qytetarëve;
- Ruajtja dhe avancimi i vlerave demokratike të shtetit;
- Liritë dhe të drejtat e njeriut;
- Ruajtja dhe avancimi i demokracisë të fuqishme funksionale multi-etnike;
- Integrimi politik-mbrojtës në NATO, politik, ekonomik dhe i sigurisë në Bashkimin Europian dhe pjesëmarrja aktive në format tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar.

¹³ Steven Greer (2000): The Margin of Appreciation: Interpretation and Discretion under the European Convention on Human Rights, Council of Europe, p. 5

¹⁴ National Security and European case-law, ECtHR, Research Division, 2013, p. 5 https://www.echr.coe.int/Documents/Research_report_national_security_ENG.pdf

¹⁵ Ligji për koordinim të bashkësisë të sigurisë-zbulimit, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut nr. 108/2019

2.2.1 Bashkësia e sigurisë-zbulimit

Bashkësia e sigurisë-zbulimit e Republikës të Maqedonisë së Veriut përfshin këto shërbime të sigurisë-zbulimit: Agjencia e zbulimit (AZ), Agjencia e sigurisë nacionale (ASN), dhe njësia kompetente organizative për sigurinë ushtarake dhe zbulimin në Ministrinë e mbrojtjes, dmth Shërbimi ushtarak i sigurisë dhe zbulimit (SHUSZ).

› CILAT LLOJE DHE FUNKSIONE TË SHËRBIMEVE TË ZBULIMIT EKZISTOJNË?

Zbulimi i jashtëm apo i huaj – grumbullon, analizon dhe përgatit zbulimin që është relevant për sigurinë e jashtme të shtetit dhe paralajmëron për kërcënimet e ardhshme të jashtme.

Zbulimi i brendshëm apo vendor (shpesh quhen shërbime të sigurisë) grumbullon dhe analizon të dhënat relevante për sigurinë e brendshme të shtetit dhe për mbajtjen e rendit publik dhe sigurisë.

Zbulimi kriminalistik – përgatit të dhëna të zbulimit për krimin e organizuar, korrupsionin dhe aktivitetet kriminale që t'u ndihmohet organeve për zbatimin e ligjit.

Kundërzbulimi – zbulon dhe shkatërron spiunazhin e realizuar nga ana e shërbimeve të huaja për zbulim, të drejtuara kundër interesave të shtetit dhe popullsisë të shtetit.

Zbulimi ushtarak apo mbrojtës – gjeneron të dhëna të zbulimit që janë relevante për planifikimin e mbrojtjes, mbrojtjen e personelit në forcat e armatosura dhe bazat për mbështetjen e operacioneve ushtarake; ato janë pjesë e forcave të armatosura dhe mandatet e tyre janë më të kufizuara nga ata të shërbimeve civile.

Qendrat e specializuara nacionale – fokusohet në çështjet e caktuara, siç janë Qendra nacionale amerikane për kundërterrorizëm.

2.2.1.1 Agjencia për zbulim

Agjencia për zbulim (AZ) është themeluar në pajtim me ligj¹⁶ në vitin 1995 si institucion i pavarur shtetëror. Ligji parasheh se “Agjencia është kompetente që të grumbullojë të dhëna dhe informacione të rëndësishme për sigurinë dhe mbrojtjen e Republikës të Maqedonisë e Veriut dhe interesat ekonomike, politike dhe interesat tjera të shtetit. Agjencia kryen analiza dhe hulumtime të të dhënave dhe informacioneve të grumbulluara dhe detyrimisht njofton Presidentin e Republikës të Maqedonisë së Veriut, Qeverinë e Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe organet tjera shtetërore për çështjet e rëndësishme të fushëveprimit të tyre.”¹⁷

Si agjenci për zbulim jashtë shtetit, AZ ka një rëndësi shumë të madhe për sistemin e sigurisë nacionale dhe zbatimin e politikës të sigurisë të shtetit. AZ zhvillon mekanizma për parandalim, pritshmëri, paralajmërim të hershëm dhe vlerësim të rreziqeve dhe kërcënimeve për sigurinë nacionale. Në kuadër të kompetencave të saj bëjnë pjesë¹⁸:

- Paralajmërimi i hershëm, vlerësimi dhe parashikimet për tendencat dhe rreziqet e mundshme të sigurisë;
- Grumbullimi i të dhënave dhe informatave të rëndësishme për sigurinë dhe mbrojtjen, interesat ekonomike, politike dhe interesat tjera jetike të shtetit;
- Grumbullimi i të dhënave dhe informatave për parandalimin e terrorizimit ndërkombëtar dhe krimit të organizuar transnacional;

¹⁶ Ligji për Agjencinë për zbulim, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 19/1995

¹⁷ Neni 2, Ligji për Agjencinë për zbulim. Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 19/1995

¹⁸ <https://ia.gov.mk/celinadleznosti.html>

- Bashkëpunimi me pushtetet tjera nacionale dhe subjektet ndërkombëtare me qëllim të shkëmbimit në kohë të të dhënave, njoftimeve dhe informacioneve.

Drejtori i Agjencisë emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti për periudhë prej katër vitesh. Informacionet për numrin e të punësuarve dhe buxhetin e përgjithshëm të AZ, pa shpërndarje të mëtutjeshme në linjat buxhetore janë të disponueshme onlajn në ueb faqen e AZ.¹⁹ AZ është organizuar në gjashtë drejtori ²⁰:

- Zbulimi i strategjive dhe kërcënimeve hibride;
- Zbulimi i terrorizmit dhe format tjera të kërcënimeve asimtrike;
- Zbulimi teknik;
- Siguria;
- Punët e përgjithshme dhe mbështetja logjistike.

Në kryerjen e punës të saj, Agjencia për zbulim vendos bashkëpunim të ndërsjellë me organet tjera shtetërore dhe subjektet ndërkombëtare për shkëmbimin në kohë të të dhënave, njoftimeve dhe informatave.

Puna dhe organizimi i AZ është rregulluar mirë në legjislacion, me çrast publikisht janë të disponueshme informatat e rëndësishme për institucionin. Megjithatë, ekzistojnë fusha të përmirësimeve të mundshme të cilat duhet të ndiqen nga komisionet për mbikqyrje, që të sigurohet ekzistimi i llogaridhënies përmes mekanizmave efektive për kontroll të brendshëm dhe aktet nënligjore të përgatitura mirë.

- Ligji për AZ mund të jetë më preciz në aspekt të mjeteve dhe metodave të përdorura të punës. Ata duhet të përkufizohen nga ana e Qeverisë, ndërsa për përdorimin e tyre vendos Drejtori.²¹
- Parlamenti nuk ka kompetenca kur bëhet fjalë për zgjedhjen e Drejtorit. Mbikqyrja parlamentare është përcaktuar në formë të përgjithshme, në ligjin statutar: “Drejtori është i detyruar që të mundësojë kqyrje dhe të jap të gjithë njoftimet dhe të dhënat nga fushëveprimi i punës të Komisionit.”²²
- Të punësuarit në AZ të cilët punojnë në vende të veçanta të punës posedojnë dhe mbajnë armë, municion dhe pajisje tjetër të përcaktuar. Megjithatë, ata nuk kanë status ushtarak.
- Ligji për AZ asnjëherë nuk është ndryshuar nga miratimi i tij në vitin 1995²³, duke dhënë autorizime të rëndësishme diskrecionale të Drejtorit, me aktet nënligjore, të rregullojë çështje tjera. Të njëjtat mund të përfshijnë rolet dhe përgjegjësitë e të punësuarve, procedurat për punësim, mekanizmat për kontroll të brendshëm etj.
- AZ nuk i nënshtrohet legjislacionit për ndjekje të komunikimeve, por, megjithatë, ata mund të zbatojnë ndjekjen e komunikimeve në spektrin e radiofrekuencave.

¹⁹ Buxheti i tërësishëm i AZ për vitin 2019 është 234.650.119 denarë apo afërsisht 3.8 milion euro. Agjencia ka 254 të punësuar.

²⁰ <https://ia.gov.mk/organizacija.html>

²¹ Nenet 2, 13 dhe 16 nga Ligji për Agjencinë e zbulimit mund të interpretohen si carte blanche (duar të lira) në aspekt të metodave; kjo mund të sjellë deri te shkeljet para GJEDNJ dhe të vështirësojë mbikëqyrjen. Gjithashtu, AZ nuk është në kuadër të strukturës mbikqyrëse në Ligjin e ri për ndjekjen e komunikimeve.

²² Neni 11, Ligji për Agjencinë e zbulimit, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 19/1995

²³ Projekt ligji i ri për AZ ka hyrë në procedurë parlamentare në shkurt të vitit 2020, por Parlamenti është shpërbërë menjëherë më pas.

› ÇFARË DUHET TË PËRKUFIZOHET ME KORNIZËN LIGJORE?

- Mandatet e shërbimeve të zbulimit, duke përfshirë edhe fushat specifike të përgjegjësisë dhe listën gjithëpërfshirëse të detyrave të tyre; kufizimet e mandatit të tyre, siç është ndalesa për promovimin apo mbrojtjen e interesave të veçanta të grupit të caktuar politik, fetar, etnik apo grupit tjetër;
- Metodatat e lejuara dhe të palejuara dhe aktivitetet për kufizimet mbi përdorimin e tyre, sidomos metodat dhe aktivitetet e caktuara me të cilat pengohen të drejtat e njeriut;
- Strukturat organizative dhe përgjegjësitë gjatë ndarjeve;
- Modalitetet për bashkëpunim me trupat tjerë qeveritar dhe joqeveritar, duke përfshirë edhe shkëmbimin e informatave për operacionet e përbashkëta;
- Mekanizmat për kontroll dhe mbikqyrje përmes të cilave kërkohet llogaridhënie nga shërbimet e zbulimit, duke përfshirë kontrollin e brendshëm, ekzekutiv, gjyqësorë dhe ligjvënës si dhe trupat e pavarur të veçantë;
- Mjetet për ndihmën juridike në rast të kundërshtimit, keqpërdorimit apo shkeljes të të drejtave

2.2.1.2 Agjencia e sigurisë nacionale

Agjencia e sigurisë nacionale (ASN) është themeluar në vitin 2019²⁴ si shërbim kryesor i brendshëm i zbulimit në Maqedoninë e Veriut. Ajo e zëvendësoi Drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim²⁵ e cila ishte shfuqizuar. Për dallimi nga paraardhësi i saj, ASN nuk është pjesë e Ministrisë të punëve të brendshme, por është organ i pavarur i administratës shtetërore me status të personit juridik, pa autorizime policore. Detyrat e saj kryesore janë kundërzbulimi, kundër-terrorizmi dhe mbrojtja e rregullimit kushtetues.

Themelimi i një agjencie të veçantë dhe tërësisht të pavarur vendore, të privuar nga autorizimet policore, ishte një hap i rëndësishëm në harmonizimin e Maqedonisë së Veriut me standardet europiane dhe praktikatat e mira dhe në përgatitjet e vendit për anëtarësim të plotë në NATO (që është arritur në mars të vitit 2020) dhe aderimit në Bashkimin Europian.

Agjencia e sigurisë nacionale në kuadër të kompetencave të saj grumbullon, përpunon, analizon, vlerëson, shkëmben, ruan dhe mbron të dhënat dhe informacionet me qëllim të zbulimit dhe parandalimit të aktiviteteve që janë të lidhura me kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë për sigurinë nacionale të shtetit dhe atë:

- Spiunazhi,
- Terrorizmi dhe financimi i tij,
- Ekstremizmi i dhushëm,
- Të gjithë format e aktiviteteve serioze dhe të organizuara kriminale të drejtuara kundër shtetit,
- Parandalimi i veprave penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare
- Prodhimi i kundërligjshëm dhe proliferimi i armëve të shkatërrimit në masë apo komponentat e tyre, si dhe materialet dhe pajisjet të cilat janë të nevojshme për prodhimin e tyre,

²⁴ Në pajtim me Ligjin për Agjencinë e sigurisë nacionale, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 108/2019

²⁵ DSK – shkurtesa që përdoret shpesh për këtë shërbim

- Dëmtimi i interesave jetike ekonomike dhe sigurisë financiare të shtetit,
- Dëmtimi i sigurisë të bartësve të funksioneve të larta shtetërore dhe e objekteve të rëndësishme strategjike për shtetin,
- Zbulimi dhe parandalimi i aktiviteteteve tjera të lidhura me kërcënimet dhe rreziqet e sigurisë për sigurinë nacionale të shtetit.

Vendosja organizative në Agjencinë e sigurisë nacionale është bazuar mbi parimin funksional dhe territorial në nivel qendror dhe rajonal, të përcaktuar me vendim të Qeverisë. Në nivel qendror, ASN, është organizuar në katër drejtori kryesore: Drejtoria për operacione, Drejtoria për analitikë, Drejtoria për teknikë operative dhe Drejtoria për logjistikë.²⁶

Për çështje të rëndësishme për sigurinë nacionale, Agjencia e sigurisë nacionale e njofton presidentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshillin për koordinim të bashkësisë të sigurisë- zbulimit, si dhe subjektet tjera në varësi nga çështja që është lëndë e njoftimit. Gjatë punës të tij, nëse të dhënat e grumbulluara dhe informacionet tregojnë për ekzistimin e bazave për dyshim se përgatitet, organizohet apo është kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, Agjencia e sigurisë nacionale menjëherë e njofton prokurorinë publike kompetente.

Agjencia e sigurisë nacionale përdor metoda të ndryshme të grumbullimit të të dhënave dhe informacioneve, edhe atë: burime të hapura (publike); personat fizik; të dhënat zyrtare dhe informacionet nga organet e pushtetit shtetëror, ndërmarrjet publike, si dhe përdorimin e të dhënave dhe informacioneve nga evidencat e tyre zyrtare, koleksionet dhe regjistrat e të dhënave. Karakteristike për Agjencinë e sigurisë nacionale është grumbullimi i fshehtë i të dhënave dhe informacioneve përmes: ndjekjes të komunikimeve; ndjekjes dhe inçizimit telefonik dhe komunikimet tjera elektronike me pajisjet e veçante teknike, pa ndërmjetësimin e Agjencisë teknike operative dhe operatorëve; përdorimi i bashkëpunëtorëve të fshehtë; personat me identitet të fshehur; mbikqyrja mbi praktikat postare dhe praktikat tjera, vëzhgimi etj.

Ligji për ndjekjen e komunikimeve²⁷ e bën të domosdoshme dallimin ndërmjet:

1. Ndjekjes të komunikimeve si masë e posaçme hetimore, e përdorur nga ana e organeve të ndjekjes penale që të grumbullojnë dëshmi për qëllime të procedurës penale, dhe
2. Zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve për shkak të mbrojtjes të interesave të sigurisë dhe mbrojtjes të shtetit, e shfrytëzuar nga ASN në parandalimin dhe identifikimin e kërcënimeve të mundshme. ASN duhet të sigurojë miratim respektivisht leje nga Gjykata supreme me qëllim që të mundet ligjërisht të grumbullojë informacione përmes përdorimit të këtyre masave.

Sipas ligjit, ekzistojnë situata kur ASN mund të përdorë pajisje speciale teknike dhe mjete pa Agjencinë teknike operative dhe operatorët të veprojnë si ndërmjetësues. Masa për ndjekjen dhe inçizimin e komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike, e përcaktuar me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve (neni 34) mund të kryhet nga ASN vetëm kur teknikisht është e pamundur që të ndiqet dhe inçizohet përmbajtja e komunikimeve pa përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve speciale teknike (Ligji për ASN, neni 26).

Ligji për ASN ka një kapitull të veçantë për transparencën e punës të Agjencisë. Neni 64 nga ligji “Informimi dhe komunikimi me publikun”, parasheh se Agjencia në faqen e saj të internetit²⁸ do të publikojë “akte relevante të rëndësishme për punën, strukturën organizative të Agjencisë dhe

²⁶ <http://www.anb.gov.mk/zaAgen.html>

²⁷ Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 71/2018

²⁸ www.anb.gov.mk

raportin vjetor për punën”. Agjencia detyrohet të publikojë anketa dhe broshura nga fushëveprimi i punës të saj dhe shpalljet publike për punësim në faqen e saj të internetit.

2.2.1.3 Shërbimi ushtarak për siguri dhe zbulim (SHUSZ)

Shërbimi ushtarak për siguri dhe zbulim (SHUSZ) është pjesë integrale e Ministrisë të mbrojtjes (MM) dhe Armata e Republikës të Maqedonisë së Veriut (ARMV). Ligji për mbrojtje²⁹ nuk udhëzon në shërbimin si njësi e veçantë organizative. Megjithatë, ligji përkufizon aktivitetet për zbulimin dhe kundërzbulimin për qëllimet e mbrojtjes, të cilat janë dy shtylla të pandara të SHUSZ. Ata përfshijnë:

- Zbulimin dhe parandalimin e zbulimit dhe aktivitetit tjetër ndërhyrës të shërbimeve të huaja ushtarake të zbulimit dhe kundërzbulimit, që realizohet në vend apo jashtë shtetit, dhe është drejtuar drejtë mbrojtjes të Republikës;
- Zbulimi dhe parandalimi i të gjithë formave të aktivitetit terrorist në drejtim të mbrojtjes të Republikës;
- Zbatimi i mbrojtjes të kundërzbulimit të detyrave dhe planeve, dokumenteve, mjeteve materiale dhe teknike, fushave, zonave dhe objekteve të interesit për mbrojtjen.

SHUSZ është përbërë nga dy segmente::

1. **Sektor – shërbimi për sigurinë ushtarake dhe zbulimin në kuadër** të Ministrisë të mbrojtjes. Sektor-shërbimi ka 9 njësi, duke përfshirë. Njësinë për planifikim dhe punë të përgjithshme, njësinë për mbështetje, njësinë për KGMKI30, njësinë për zbulim 1, njësinë për zbulim 2, njësinë për kundërzbulim, njësinë për siguri, njësinë për siguri fizike dhe njësinë për analitikë.³¹
2. **Seksionet në kuadër të AGJRMV: J-2, C-2 dhe A-2.** Këto seksione kanë një vartësi të dyfishtë: në linjë komanduese nën shtabin e përgjithshëm të ARMV dhe sipas vijës profesionale nën Udhëheqësin e Sektorit – shërbimit për sigurinë ushtarake dhe zbulimin.

Rregullat për atë se si ky shërbim e kryen punën e tij janë të rregulluar me Rregullore³², në bazë të nenit 136 nga Ligji për mbrojtje, SHUSZ kryen kontrolle të sigurisë për personelin në kuadër të vendosjes ushtarake. Personat e autorizuar nga SHUSZ kanë të drejtë të grumbullojnë të dhëna, informacione, dhe njoftime.³³

Nuk ka informacione publikisht të disponueshme për personelin, kurse buxheti është inkorporuar në buxhetin e përgjithshëm të MM. SHUSZ nuk ka buxhet të veçantë dhe për të gjithë nevojat financiare është inkorporuar në buxhetin e përgjithshëm të MM. Drejtori i SHUSZ caktohet nga ana e Ministrisë të mbrojtjes.

SHUSZ realizon bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave me shërbimet ushtarake zbuluese dhe kundërzbuluese në vendet partnere dhe kryen koordinim me sistemet e kundërzbulimit në NATO. Personeli i SHUSZ është vendosur në misionet ushtarake paqëruajtëse ndërkombëtare në të cilat merr pjesë Maqedonia e Veriut.

29 Neni 133, Ligji për mbrojtje, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 42/2001, 05/2003, 58/2006, 110/2008, 51/2011, 151/2011, 215/2015, 42/2020, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Maqedonisë V.nr.37/2002 (Gazeta zyrtare nr. 73/2002) dhe V.nr.135/2002 dhe 155/2001 (Gazeta zyrtare nr. 78/2002)

30 Koordinimi, grumbullimi dhe menaxhimi me kërkesat për informatat

31 <http://morm.gov.mk/wp-content/uploads/2017/06/Organogram-juni-2017.pdf>

32 Rregullorja për realizimin e punëve nga zbulimi, kundërzbulimi dhe parandalimi dhe zbulimi i veprave penale nga mbrojtja, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 40/2003

33 Të punësuarit në SHUSZ (edhe në MM dhe në ARM) janë persona zyrtar të autorizuar me autorizime të precizuara në nenet 133, 134 dhe 136 nga Ligji për mbrojtje. Neni 4, paragrafi 1, t.7 si organe të autorizuar për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve për shkak të mbrojtjes të interesave të sigurisë dhe mbrojtjes të sigurisë kanë identifikuar: Agjencinë e sigurisë nacionale dhe Ministrinë e mbrojtjes – Shërbimi ushtarak për siguri dhe zbulim, si dhe Qendra për vëzhgimin elektronik pranë Ushtrisë si organ i autorizuar për spektrën e frekuentuar të radio valëve në frekuencat e larta, shumë të larta dhe ultra të larta (HF, VHF dhe UHF).

2.2.2 Institucionet tjera të cilat kanë autorizime të zbatojnë metoda ndërhyrëse

Krahas institucioneve që nxjerrin kompetencat e tyre nga Ligji për bashkësinë e sigurisë-zbulimit, disa trupa tjerë në Qeverinë maqedonase luajnë një rol të papërfillshëm në sektorin e zbulimit, e këto janë Byroja për sigurinë publike, Policia financiare, Drejtoria doganore, Qendra për vëzhgimin elektronike dhe Agjencia teknike operative. Në fakt, për qëllimet e procedurave penale, këto organe kanë privilegjet e tyre të zbulimit, përmes njësive të brendshme për zbulim kriminalistik dhe analizë, apo sektorët për kontrolla dhe hetime. Funkcionet e tyre të zbulimit u japin pushtet që të grumbullojnë informacion përmes metodave ndërhyrëse, mes të tjerave, me ndjekjen e komunikimeve. Edhe pse ata nuk janë gjithmonë të detyruar që të prezantojnë raporte konkrete për punën e tyre të zbulimit, ata janë pjesë e sistemit maqedonas të sigurisë dhe janë lëndë e mbikqyrjes parlamentare të realizuar nga Komisioni për mbrojtje dhe siguri dhe Komisioni për mbikqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve.

2.2.2.1 Byroja për sigurinë publike

Byroja për sigurinë publike është organ në përbërje të Ministrisë të punëve të brendshme që kryen punët policore në ministri, dhe organizimi dhe kompetenca e të cilës është rregulluar me Ligjin për policinë³⁴. BSP është pjesë e policisë gjyqësore dhe në pajtim me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve është një nga organet e autorizuar për ndjekjen e komunikimeve për qëllimet e procedurës penale; ata gjithashtu kanë edhe autorizimin ligjor të përdorin nëpunësit policor me identitet të fshehur. Me Byronë për sigurinë publike udhëheq drejtori, të cilin me propozim të ministrit për punë të brendshme e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për mandat prej katër vitesh.

Në kompetencë të Byrosë për sigurinë publike bëjnë pjesë:

- Planifikimi konceptuar, ndjekja dhe analiza e gjendjes të sigurisë dhe arsytet për paraqitjen e kriminalitetit dhe rrezikimi i sigurisë publike;
- Mbikqyrja e përgjithshme dhe profesionale dhe kontrolli mbi punën e njësive organizative të Policisë;
- Përpunimi i të dhënave personale nën kushtet dhe në mënyrë të përcaktuar me ligjin për policinë dhe ligjin e veçantë;
- Zbatimi i marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare për bashkëpunimin policorë dhe aktet tjera ndërkombëtare për të cilat është kompetente Policia;
- Kujdesi dhe gatishmëria e Policisë për veprim dhe punë në kushte të gjendjes të komplikuar të sigurisë dhe punët tjera të përcaktuara me ligj.

Vendosja e brendshme organizative e Byrosë për sigurinë publike bazohet në parimin e linjës dhe atë territorial. Për kryerjen e punëve policore nga kompetenca e Byrosë për sigurinë publike janë formuar këto njësi organizative:

- Sektori për punët policore nga kompetenca e përgjithshme dhe e veçantë që është përgjegjës për punën e përditshme policore nga fusha e rendit publik dhe qetësisë, parandalimit, si dhe për aktivitetet policore të cilat i referohen gjendjeve të komplikuar të sigurisë.
- Sektori për policinë kriminalistike që koordinon masat dhe aktivitetet me njësitë organizative kompetente për punët kriminalistike dhe Qendrat rajonale për punët

³⁴ Neni. 15, Ligji për policinë, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 114/2006, 06/2009, 145/2012, 41/2014, 33/2015, 31/2016, 106/2016, 120/2016, 21/2018, 64/2018 dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare nr. 148/2008

kufitare, në drejtim të veprimit të njëjtë të shërbimeve operative policore në terren.

- Sektori për zbulimin kriminalistik dhe analizë që punon në grumbullimin, përpunimin dhe analizën e të dhënave dhe informacioneve pas metodologjive dhe standardeve të përcaktuara paraprakisht për përpunimin, përgatit produkte analitike dhe raporte dhe bën shpërndarjen e tyre deri te njësitë organizative në njësitë organizative të Byrosë për sigurinë publike.
- Sektori për punët kufitare dhe migrimet që është përgjegjës për punën e përditshme policore nga fusha e punëve kufitare, aktiviteteve policore të cilat i referohen kriminalitetit ndërkufitar dhe migrimit, si dhe në punë të cilat i referohen të huajve dhe pranimit.
- Sektori për punët e qarkullimit që është përgjegjës për punën e përditshme policore nga fusha e qarkullimit dhe parandalimit të qarkullimit, kontrollimi i mënyrës të realizimit të testimit të lejes të vozitjes dhe testimi për kontrollimin e profesionalizmit të shoferit-instruktorit; merr pjesë në procedurën për lëshimin dhe marrjen e licensave për shofer-instruktor dhe veprimet tjera nga fusha e qarkullimit.
- Sektori për punët e përbashkëta dhe menaxhimin e burimeve njerëzore që është kompetent për kryerjen e punëve profesionale për nevojat e Byrosë për sigurinë publike në fushën e menaxhimit me burimet njerëzore, punët juridike dhe financiare, mbrojtjen e të dhënave personale dhe zhvillimin e personelit dhe përfaqësimin e komuniteteve që kujdeset për barazinë gjinore.

BSP ka përgjegjësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm të policisë, të cilët kryen nga këto struktura:

- Sektori për kontroll të brendshëm, standarde profesionale dhe hetime kriminalistike realizon kontroll të brendshëm në rastet e keqpërdorimit të mundshëm të autorizimeve policore.
- Komisionet speciale ad-hok të formuara nga drejtori të realizojnë mbikqyrje të përgjithshme dhe profesionale dhe kontroll të njësisve organizative policore³⁵.
- Tetë sektorë për punë të brendshme formohen në territorin nacional për shkak të kryerjes të punëve policore. Ata janë vendosur sipas madhësisë të fushës, madhësisë të popullsisë, numrit të veprave penale dhe kundërvajtjeve dhe rëndësisë të rrugëve dhe pozitës gjeografike të komunave.
- Katër qendrat rajonale për punët kufitare të themeluara për kryerjen e punëve policore të lidhura me inspeksionet kufitare dhe mbikqyrjen kufitare³⁶.

2.2.2.2 Drejtoria e policisë financiare

Roli i Drejtorisë të policisë financiare është i rëndësishëm në luftën kundër formave të sofistikuara të krimit të organizuar të cilat janë kushtëzuar me globalizimin dhe zhvillimin e shpejtë të teknologjisë, kurse janë të pranishme në vendet në tranzicion. Ajo është organ operativ në përbërje të Ministrisë të financave në cilësi të personit juridik dhe është themeluar me ligj të veçantë³⁷. Ajo është kompetente për mbrojtjen e interesave nacionale financiare, punën në fushën e financave, operacioneve tatimore dhe doganore, detektimin dhe ndjekjen e formave të komplikuara të krimit të organizuar financiar.

³⁵ Udhëzimi për mënyrën e kryerjes të mbikëqyrjes të përgjithshme dhe profesionale në Polici, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 42/2007 dhe 14/2017

³⁶ Ligji për policinë dhe Ligji për punët e brendshme, si dhe ueb faqja e MPB <https://mvr.gov.mk/page/organogram>

³⁷ Ligji për policinë financiare, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut, nr. 12/2014, 43/2014, 33/2015, 27/2016, 83/2018 dhe 198/2018

Me punën e drejtorisë të policisë financiare udhëheq drejtori të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës të Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrit të financave. Në kuadër të strukturës organizative bëjnë pjesë:

- Sektori për analizë kriminalistike zbuluese,
- Sektori për hetime të integruara dhe financiare dhe
- Sektori për financa, çështjet normative-juridike dhe burimet njerëzore.

Drejtoria e policisë financiare është pjesë përbërëse e policisë gjyqësore si organ për ndjekjen penale të kryerësve të veprave penale nga fusha e kriminalitetit të organizuar financiar dhe veprave tjera penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, kurse me të cilat fitohet në formë të kundërligjshme përfitimi pronësorë (prona) me vlerë të konsiderueshme apo i shkaktohet dëm buxhetit të shtetit.

Drejtoria e policisë financiare kryen zbulimin dhe hetimin kriminalistik të veprave penale nga fusha e kriminalitetit të organizuar financiar të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, si dhe kapjen dhe paraqitjen e kryerësve të tyre, sigurimin e dëshmimeve dhe masave dhe aktiviteteve tjera të cilat mund të përdoren për zhvillimin e pandërprerë të procedurës penale.

Gjithashtu, ajo bën grumbullimin dhe analizimin e të dhënave për transaksionet në para të gatshme, ndërmerr masa parahetimore dhe masa tjera kur ekzistojnë dyshime të bazuara për kryerje të veprave penale, bën ndjekjen e gjurmëve të parave me qëllim të zbulimit të veprave të ndëshkueshme të përcaktuara me ligj, si dhe kqyrjen dhe kontrollimin e të dhënave të kontabilitetit dhe evidencave në sistemet kompjuterike në prani të personit përgjegjës apo nga personi i autorizuar prej tij. Sidomos e rëndësishme është kompetenca e Drejtorisë të policisë financiare gjatë kryerjes të analizës forenzike kompjuterike të sistemeve kompjuterike përkohësisht të marra dhe pajisjeve tjera elektronike.

2.2.2.3 Drejtoria doganore

Drejtoria doganore është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë të financave të Republikës të Maqedonisë së Veriut e cila ka status të personit të veçantë juridik dhe është themeluar me ligj të veçantë³⁸. Me atë udhëheq drejtori të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kompetencat themelore të Drejtorisë doganore janë:

- Realizimi i mbikqyrjes doganore, doganimit i mallit, kontrolli doganor, realizimi i mbikqyrjes të akcizës në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, masat hetimore dhe të zbulimit me qëllim të parandalimit, zbulimit dhe hetimit të kundërvajtjeve doganore dhe veprave penale;
- Mbrojtja e sigurisë dhe sigurimit të njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mbrojtja e objekteve me vlerë historike, artistike dhe arkeologjike, të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera, si dhe masat tjera të politikës tregtare të përcaktuara me ligj;
- Kryerja e kontrollave doganore pas doganimit;
- Kryerja e kontrollave të brendshme dhe revizioneve në të gjithë sferat e punës doganore dhe funksionimi i tërësishëm i Drejtorisë doganore, me qëllim të zbulimit të rasteve të mosrespektimit të ligjeve dhe akteve interne dhe keqpërdorimi gjatë kryerjes të detyrave zyrtare nga ana e të punësuarve;

³⁸ Ligji për drejtorinë doganore, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 46/2004, 81/2005, 107/2007, 103/2008, 64/2009, 105/2009, 48/2010, 158/2010, 53/2011, 113/2012, 43/2014, 167/2014, 33/2015, 61/2015, 129/2015 dhe 23/2016

- Zhvillimi i procedurës kundërvajtëse, shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse për kundërvajtjen e kryer doganore, devizore apo të akcizës, si dhe iniciimi i procedurës për veprat penale të përcaktuara me ligj.

Drejtoria doganore i kryen kompetencat e saj në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse punët nga domeni i saj i kryen përmes administratës qendrore dhe pesë doganierëve. Drejtoria qendrore, koordinon dhe udhëheq me kompetencat doganore në të tërë territorin e shtetit, kurse doganat koordinojnë dhe udhëheqin me rajonin përkatës. Puna e Drejtorisë doganore kryhet përmes këtyre sektorëve: Sektori për përgjegjësinë profesionale, Sektori për sistemin doganor, Sektori për akciza, Sektori për kontroll dhe hetime, Sektori për menaxhimin e burimeve njerëzore, Sektori për çështjet financiare, Sektori për punët administrative dhe teknike, Sektori për punët juridike, dhe Sektori për teknologjitë informative dhe të komunikimit.³⁹

Drejtoria doganore ka kompetencën e lejuar ligjore që të kërkojë informacione përkatëse dhe ndihmë nga organet tjera shtetërore dhe institucionet, si dhe realizimin e bashkëpunimit me drejtoritë doganore të shteteve tjera me qëllim të parandalimit të kundërvajtjeve dhe veprave penale doganore.

2.2.2.4 Qendra për vëzhgimin elektronik

Qendra për vëzhgimin elektronik është njësi në kuadër të shtabit të përgjithshëm të Armatës të Republikës të Maqedonisë së Veriut. Me atë udhëheq komandanti të cilin e zgjedh shefi i shtabit të përgjithshëm. Qendra për vëzhgimin elektronik grumbullon të dhëna të zbulimit përmes vëzhgimit elektronik me qëllim të paralajmërimit të hershëm dhe mbrojtjes të forcave të armatosura. Vëzhgimi elektronik është sidomos i rëndësishëm në kushtet e luftës për grumbullimin e informacioneve për armikun. Qendra për vëzhgimin elektronik kontribuon për:

- Shpërndarjen efektive të fuqisë luftarake, duke përfshirë edhe në misionet jashtë territorit nacional;
- Sigurimin e objekteve të rëndësishme për mbrojtjen;
- Pengimin e spektrit elektromagnetik;
- Mbrojtjen elektronike të forcave;
- Mbështetjen për veprimet bashkëpunuese mbrojtëse gjatë sulmit të shtetit.

Qendra për vëzhgimin elektronik ka autorizim për ndjekje të komunikimeve, por vetëm në radio spektrin e caktuar (HF – frekuenca e lartë, VHF – Frekuenca shumë e lartë dhe UHF – Frekuencë ultra e lartë) të cilat janë specifike për qëllimet mbrojtëse.⁴⁰

2.2.3 Agjencia teknike - operative (ATO)

Me reformat në sistemin e ndjekjes të komunikimeve, në kuadër të reformës më të gjërë të sistemit të sigurisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me ligj të veçantë⁴¹ është formuar agjencia e re e cila ka rol teknik. Agjencia teknike-operative është një organ shtetëror i pavarur dhe i mëvetësishëm që siguron ndërlidhje teknike ndërmjet operatorëve teknik dhe organeve të autorizuar për ndjekjen e komunikimeve, në rastet kur me urdhër gjyqësorë është miratuar respektivisht lejuar ndjekja e komunikimeve për shkak të nevojave të **hetimeve penale**, apo për shkak të mbrojtjes të interesave të sigurisë dhe mbrojtjes të shtetit – **sigurisë nacionale**. ATO-ja

³⁹ <http://www.customs.gov.mk/index.php/en/about-us-en/koi-sme-nie/organizacija-mk/sektori-cu-2-mk>

⁴⁰ Neni 4 pg 1, t 7, Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 71/2018

⁴¹ Ligji për agjencinë teknike - operative, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë, nr. 71/2018

nuk posedon mundësi teknike për qasje në përmbajtjen e komunikimit të ndjekur. Lidhja teknike ndërmjet operatorëve dhe organeve të autorizuar sigurohet *vetëm dhe ekskluzivisht* në bazë të *urdhërit të lëshuar gjyqësorë* për ndjekjen e komunikimeve.

Me ATO-n udhëheq drejtori, të cilin e emëron dhe shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Drejtori zgjidhet me shumicën prej dy të tretave të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve që i takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë, pas shpalljes publike të shpallur paraprakisht. Mandati i tij është pesë vite pa të drejtë të zgjidhjes të sërishme.

Vendosja organizative e ATO-s është rregulluar me Rregulloren për organizimin e brendshëm që është e klasifikuar, për të cilën nuk ka informacione që janë publikisht të disponueshme.

Për shkak të sigurimit të kushteve teknike gjatë lidhjes ndërmjet operatorëve dhe organeve të autorizuar, ATO duhet të mundësojë:

- Lidhjen teknike ndërmjet operatorëve dhe pajisjes ndërmjetësuese (LEIMD⁴²) të vendosur në ATO;
- Lidhjen teknike ndërmjet pajisjeve teknike (LEIMD и LEMF⁴³) të vendosur në ATO;
- Lidhjen teknike ndërmjet pajisjeve teknike (LEMF) të vendosur në ATO dhe stacionet e punës që shfrytëzohen për realizimin e ndjekjes të komunikimeve të vendosura në hapësirat e organeve të autorizuar.

Përparësia edhe në themelimin e ATO-s, si segment në sektorin e zbulimit, është fakti se eliminohet mundësia teknike për lidhjen e pavarur, ndjekjen dhe inçizimin e telefonëve dhe komunikimeve tjera elektronike nga operatorët, nga ana e organeve të autorizuar për grumbullimin dhe analizën e informatave të zbulimit. ATO-ja është subjekt teknik i cili në bazë të urdhrit gjyqësorë mundëson (lëshon sinjal deri te stacionet e punës) për ndjekjen e komunikimit të caktuar elektronik. Por edhe krahas ekzistimit të ATO-s, shërbimet e caktuara vetëm në raste të caktuara⁴⁴ dhe në bazë të urdhrit gjyqësorë, kanë mundësinë për ndjekjen e pavarur të komunikimeve, pa ndërmjetësim nga ATO.

Pajisjet ndërmjetësuese për ndjekjen e komunikimeve të cilat janë në pronësi të operatorëve janë të vendosur në ATO. Ky arranzhman institucional e pengon përqëndrimin e pushtetit në një institucion, me çrast lehtësohet llogaridhënia. ATO-ja është e dizajnuar si tampon zonë ndërmjet organeve të autorizuar për shfrytëzimin e përgjimeve dhe operatorëve, e me këtë kryhet edhe funksioni i mbikqyrjes profesionale në sistemin e ndjekjes të komunikimeve.

Një pjesë e rëndësishme nga puna e ATO-s është kryerja e mbikqyrjes profesionale mbi punën e operatorëve për çka formohet Komisioni për mbikqyrje profesionale i përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë. Komisioni kryen mbikqyrje mbi përdorimin e pajisjes teknike dhe përcuesve elektronik të komunikimit të cilat shërbejnë për lidhjen e ATO-s me operatorët. Pas mbikqyrjes të kryer, Komisioni përgatit Raport për punën e operatorit.

ATO-ja parashtron plan vjetor deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për punën e ATO-s, kurse sipas nevojës apo me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut parashtron edhe raporte shtesë.

ATO-ja në kryerjen e punëve nga kompetenca e saj bashkëpunon me organet vendore dhe të huaja shtetërore, organizatat e shteteve tjera me veprimtari të ngjajshme edhe me organizatat ndërkombëtare nga fusha e sigurisë, sigurisë informative dhe telekomunikimeve.

⁴² Pajisja ndërmjetësuese (LEIMD) është pajisje teknike ndërmjetësuese dhe mbështetje përkatëse softuerike e cila mundëson aktivizimin e masës të ndjekjes dhe inçizimit të komunikimeve telefonike dhe komunikimeve tjera elektronike

⁴³ Pajisjet për ndjekjen e komunikimeve (LEMF) janë mjete për ndjekjen e komunikimeve deri te të cilat përcillet përmbajtja e komunikimit të ndjekur dhe informatat në lidhje me komunikimin e ndjekur nga pajisja teknike e operatorit përmes ATO-s deri te stacionet e punës të cilat i posedojnë organet autorizuar

⁴⁴ Në bazë të Ligjit për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 71/2018

2.3 SISTEMI MAQEDONAS PËR MBIKQYRJE MBI ZBULIMIN

Ekzistojnë nivele të ndryshme të kontrollit dhe mbikqyrjes të cilat kontribuojnë për llogaridhënie të zbulimit. Ata plotësojnë njëra tjetrën dhe përforcohen mes veti, kurse mangësitë në një nivel kanë potencial që të ndikojnë në të gjithë sistemin. Ky kapitull shkurtimisht do të prezantojë parimet kryesore të cilat sqarojnë nivelin konkret të kontrollit dhe mbikqyrjes, kurse më tutje shqyrtojnë dispozitat më relevante ligjore të cilat përkufizojnë atë nivel në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

› KUSH ËSHTË PËRGJEGJËS PËR KËRKESËN PËR LLOGARIDHËNIE NGA ANA E SEKTORIT TË ZBULIMIT?

1. **Kontrolli i brendshëm** – me drejtimin e nëpunësve dhe mekanizmave për kontroll të brendshëm dhe revizion. Mbështetet në urdhëra të përhershëm, rekrutim, trajnim, koordinim të personelit (duke përfshirë mekanizmat për mbrojtje të të drejtave të nëpunësve dhe disiplinimin e individëve).
2. **Kontrolli ekzekutiv** – nga ana e ministrive relevante dhe funksionerëve ekzekutiv. Në bazë të politikave, direktivave, prioritetëve, përgjegjësi para parlamentit.
3. **Mbikqyrja parlamentare** – nga ana e komisioneve relevante mbikqyrëse. Në bazë të ligjeve, procedurave parlamentare, aktiviteteve mbikqyrëse, miratimit dhe shqyrtimit të buxhetit shtetëror.
4. **Revizioni gjyqësorë** – nga gjyqësori i pavarur. Përfshin autorizimin për miratimet e veçanta të masave ndërhyrëse dhe gjykimin për shkelje të pretenduara të ligjit.
5. **Mbikqyrja e jashtme** – nga ana e mediave dhe shoqërisë civile. Në bazë të gazetarisë hulumtuese, hulumtimit të pavarur, debatit publik për politikat alternative dhe prioritetet.

2.3.1 Kontrolli i brendshëm

Udhëheqësia e brendshme kontrollon aktivitetet e përditshme të zbulimit dhe kujdeset që nëpunësit e zbulimit në mënyrë efikase të kryejnë punën e tyre në pajtim me ligjet relevante nacionale dhe ndërkombëtare. Vlerat, etika dhe rëndësia juridike e të punësuarve në shërbimet e zbulimit është e rëndësishme më të madhe.

- Udhëheqësia e brendshme duhet që në mënyrë aktive të promovojë kulturën e llogaridhënies, profesionalizmit, integritetit, përfshirjes, barazisë gjinore dhe respektimin e dallimeve, duke filluar me punësimin efikas dhe proceset e trajnimit. Ata gjithashtu koordinojnë proceset për vlerësim të suksesit dhe kontributit të personelit. Udhëheqësit (menaxherët) duhet të zbatojnë kritere të forta gjatë përzgjedhjes që të sigurojnë punësimin e njerëzve me vlerat përkatëse. Ata gjithashtu duhet të sigurojnë trajnim të vazhdueshëm, duke përfshirë edhe për çështjet që i referohen të drejtave të njeriut dhe për rolin e mbikqyrjes-që të ushqejnë vetëdijen dhe përgatitjen për bashkëpunim me trupat e jashtëm për mbikqyrje.
- Drejtorët caktohen për periudhën e caktuar kohore që të mbrojnë nga presioni politik apo ndryshimet në pushtet. Ata mund të largohen nga detyra vetëm nëse shkelin të drejtat e caktuara.

- Inspektorët e brendshëm të përgjithshëm vlerësojnë ligjshmërinë e veprimtarisë zbuluese dhe paralajmërojnë menaxherët dhe pushtetin ekzekutiv për problemet e caktuara individuale apo sistematike.

Kontrolli i brendshëm zakonisht është përkufizuar shkurtimisht me ligje, të cilat janë të detajuara me akte nënligjore dhe dispozita të brendshme, siç janë procedurat për ndarjen, njoftimin dhe vlerësimin e aktiviteteve zbuluese apo kodekse të sjelljes dhe standardet profesionale. Informacionet që janë publikisht të disponueshme për mekanizmat dhe procedurat për kontroll të brendshëm në shërbimet maqedonase të zbulimit janë të pakta.

- **Ligji për punë të brendshme** parashikon një njësi të veçantë organizative përgjegjëse për vlerësimin e ligjshmërisë të punës të të punësuarve në Ministrinë për punë të brendshme. Departamenti për kontroll të brendshëm, hetime penale dhe standarde profesionale sipas detyrës zyrtare vepron në informacionet e fituara nga parashtresat e qytetarëve, dokumentet e brendshme dhe informacionet nga të punësuarit në MPB. Mund të veprojë sipas urdhërit të Ministrit të punëve të brendshme. Sektori kryesisht merret me veprimin e gabuar nga ana e policisë.
- **Ministria e mbrojtjes** kryen kontroll të brendshëm përmes inspektorëve të cilët kontrollojnë nëse puna e të punësuarve është në pajtim me ligjet relevante. *Sektori për inspektim në mbrojtje* bën mbikqyrje mbi ligjshmërinë e operacioneve në Ministrinë e mbrojtjes, Shtabin e përgjithshëm dhe Armatën; gjithashtu mund të mbikqyr punë të caktuara në interes të mbrojtjes, në kuadër të organeve shtetërore, vetqeverisjes lokale, shoqatave tregtare, ndërmarrjeve publike, institucioneve dhe shërbimeve, në pajtim me ligjin dhe Rregulloren për mbikqyrje inspektuese në fushën e mbrojtjes. Duke marrë parasysh Planin afatgjatë për zhvillim të aftësive mbrojtëse 2019-2028, Ministria e mbrojtjes, gjithashtu, përfshin një njësi të veçantë – Sektorin për revizion të brendshëm.
- **Ligji për Agjencinë e zbulimit** nuk ka dispozita që rregullojnë kontrollin e brendshëm.
- **Agjencia për sigurinë nacionale** e përcakton kontrollin e brendshëm në ligjin e saj të themelimit. Ai zbatohet nga ana e njësisë të veçantë organizative, jurisdiksioni i të cilit është paraparë me ligj.⁴⁵

Komisionet parlamentare janë përgjegjëse për mbikqyrjen e këtyre politikave të brendshme, mekanizmave dhe praktikave. Madje edhe nëse ata bazohen në urdhëra të klasifikuara ekzekutive dhe procedura të brendshme, komisionet mbikqyrëse mund të fitojnë qasje deri te këto dokumente.

Mënyra e rëndësishme që Parlamenti të ndikojë mbi kontrollin e brendshëm është që të ketë fjalë në caktimin e drejtorëve të shërbimeve. Në disa vende, pushteti ekzekutiv konsultohet me partitë opozitare dhe/ose komisionet parlamentare para caktimit të drejtorëve. Parlamenti mund të vendos pyetje për personin e nominuar apo ta ftojë në dëgjim (seancë). Kjo ndihmon që të parandalohet që pushteti ekzekutiv të caktojë persona të cilët mbrojnë apo promovojnë interesat e tij politike. Gjithashtu, mund të promovojë integritimin e përfaqësimit të ndryshëm dhe perspektivat në procesin e mbikqyrjes.

⁴⁵ Nenet 52-54, Ligji për Agjencinë e sigurisë nacionale, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut, nr. 108/2019

› CILI ËSHTË DALLIMI NDËRMJET KONTROLLIT DHE MBIQYRJES?

Kontrolli nënkupton autorizimin që të drejtohen politikat dhe aktivitetet e organizatës, për shembull, përmes sjelljes të rregullave, kodeve apo politikave të cilat vendosin se si duhet të funksionojë një organizatë.

Mbikqyrja nënkupton kontrollimin dhe vërtetimin e respektimit të rregullave dhe ligjeve dhe zbatimin e kodekseve dhe politikave.

Mbikqyrja mund të kryhet nga shumë aktorë dhe institucione të ndryshme, ndërsa kontrolli është kryesisht përgjegjësi e udhëheqësisë dhe pushtetit ekzekutiv.

2.3.2 Kontrolli nga pushteti ekzekutiv

Autoriteti dhe legjitimiteti përfundimtar i aktiviteteve të zbulimit mbështetet në miratimin parlamentar të autorizimeve të tyre, mandateve dhe shpenzimeve. Por, për shkaqe praktike dhe për shkak të natyrës të ndjeshme dhe urgjencës të punës të zbulimit, kontrolli efektiv dhe i përditshëm qëndron te Qeveria. Pushteti ekzekutiv politik është klienti kryesor, urdhërdhënës, kontrolluesi dhe mbiqyrësi i punës të shërbimeve të zbulimit. Ai vendos politikat gjithëpërfshirëse dhe prioritetet e shërbimeve të zbulimit, shpërndarjen e resurseve, formulimin e direktivave, akteve nënligjore dhe udhëzimeve për aspekte të ndryshme të punës të zbulimit, nga shkëmbimi i informacioneve me partnerët e huaj deri te përdorimi i metodave ndërhyrëse për grumbullimin e informacioneve. Si klientë kryesorë të zbulimit, pushteti ekzekutiv duhet të sigurojë drejtime respektivisht udhëzime për atë se cilat produkte të zbulimit janë të nevojshme, dhe duhet të jap shqyrtime kthyesë për raportet e fituara të zbulimit. Mungesa e këtyre shqyrtimeve kthyesë mund të rezultojë në produkte jo adekuate të zbulimit.

Pushteti ekzekutiv duhet të zbatojë kontroll efikas të jashtëm mbi shërbimet e zbulimit.

Qeveria si organ qëndror i pushtetit ekzekutiv është përgjegjëse për sigurinë nacionale dhe prandaj duhet të integrojë dhe koordinojë mundësitë dhe përpjekjet operative të të gjithë institucioneve në sektorin e sigurisë.

Strukturat qeveritare janë të pajisura për drejtimin dhe koordinimin e shërbimeve të zbulimit në kohë reale. Ministrave përgjegjës u duhet një shkallë e mjaftueshme e kontrollit mbi shërbimet e zbulimit dhe të drejtë që të kërkojnë informacione prej tyre; atyre gjithashtu ju duhen mekanizma për sanksionimin dhe ndërmarrjen e veprimeve në rastet e shkeljeve juridike. Megjithatë, kontrolli efektiv ekzekutiv nuk nënkupton përgjegjësi të drejtëpërdrejtë udhëheqëse për operacionet e zbulimit. Ekziston nevoja për vendosjen e ekuilibrit të vërtetë në raportet ndërmjet bashkësisë ekzekutive dhe të zbulimit:

- Shumë kontroll ekzekutiv dhe ndikim mbi punën e informatave të zbulimit mund të sjellë deri te keqpërdorimi i shërbimeve për interesat politike.
- Mangësia e kontrollit ekzekutiv krijon rrezikun nga keqpërdorimi i autorizimeve të zbulimit dhe resurseve nga ana e individëve në kuadër të shërbimeve, për interesat e tyre personal

› CILAT TRUPA JANË PËRGJEGJËS PËR KONTROLLIN EKZEKUTIV MBI SHËRBIMET E ZBULIMIT?

- Resoret më të gjëra ministrore siç janë mbrojtja, punët e brendshme, drejtësia, për shërbimet e zbulimit të cilat janë organizuar si njësi në kuadër të ministrive.
- Kryeministri (për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar).
- Presidenti (për shembull, në Romani).
- Trupi i përbashkët nga Presidenti dhe Kryeministri (për shembull, në Kroaci, Slloveni).
- Trupi kolektiv, siç është Këshilli i sigurisë nacionale (për shembull, Kroaci, Romani, Serbi).

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe në të gjithë vendet tjera, pushteti ekzekutiv (duke përfshirë edhe Presidentin e Republikës dhe Qeverinë) janë përdoruesit kryesorë të punës të zbulimit. Shërbimet grumbullojnë dhe analizojnë informacionet për kërcënimet e zbuluara kundër shtetit dhe popullsisë të tij. Ata i japin këto informacione për Qeverinë, duke mundësuar që të zhvillohet dhe realizohet një politikë e sigurisë. Llogaridhënia kërkohet përmes akteve nënligjore dhe rregullativës të brendshme. Megjithatë, ka pak informacione të karakterit publik që mundësojnë vlerësim relevant për atë se si kontrolli ekzekutiv realizohet në realitet.

- Shërbimi ushtarak i zbulimit (SHUSZ) është përgjegjës para Ministrit të mbrojtjes.
- Qeveria e emëron dhe shkarkon drejtorin e Agjencisë të sigurisë nacionale (ASN), me propozim të Kryeministrit
- AZ drejtëpërdrejtë njofton Presidentin e Republikës të Maqedonisë së Veriut, i cili ka të drejtë të caktojë dhe shkarkojë drejtorin e AZ. Qeveria ka kompetenca të fuqishme në lidhje me AZ sepse i parasheh metodat dhe mjetet e punës të AZ, megjithatë ligji nuk precizon se në cilën mënyrë.⁴⁶ Drejtori, nga ana tjetër, ka një autonomi të tërësishme për atë se cilat masa duhet të përdoren – nuk ekziston një dispozitë ligjore për kontrollimin paraprak nga Qeveria. Metodatat specifike të cilat përdoren në një operacion janë të klasifikuara, por nuk ka arsye se pse ligji të mos përmend në kushtet e përgjithshme se cilat janë metodatat të cilat janë “parapare”

› SFIDAT KONKRETE PËR MBIQYRJË DHE KONTROLL MBI ZBULIMIN NË KONTEKSTIN TRANZITOR:

Shërbimet e zbulimit janë elementi themelor në ruajtjen e regjimeve autoritare apo totalitare, që do të thotë se ata mund të paraqesin një sfidë të veçantë kur do të përcillen në qeveritë e reja demokratike:

- Informacionet e grumbulluara nga regjimi i mëparshëm mund të përdoren për kërcënim, zhvatje apo manipulim politik.
- Kërkimi i drejtësisë për keqpërdorimet nga e kaluara mund të nxisin interesat e fuqishme që të ndërpresin tranzicionin politik.

⁴⁶ Neni. 4, Ligji për Agjencinë e zbulimit, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 19/1995

- Mosndëshkimi i keqpërdorimeve të mëparshme mund të rrënojë institucionet politike, sidomos nëse personeli nga regjimi i mëparshëm mbetet në funksion.
- Funksionarët qeveritarë, përfaqësuesit e zgjedhur, shoqëria civile dhe mediat në shtetet në tranzicion mund të jenë të pajisura keq apo të mos ken vullnet që të ndjekin siç duhet punën e shërbimeve të zbulimit.
- Mungesa e kornizës ligjore për mbikqyrjen demokratike dhe kontrollin, fragmentimi i shërbimeve dhe mandatet respektivisht kompetencat e gjëra të shërbimeve të zbulimit e vështirësojnë mbikqyrjen
- **Ligjet e mëparshme dhe rregullativat mund të jenë diskriminuese** apo të mos sigurojnë masa përkatëse për kompensim të **dëmit apo qasjes në drejtësi**.

Mbikqyrja parlamentare varet nga kontrolli ekzekutiv. Ata të cilët kryejnë mbikqyrje duhet të parandalojnë ndikimin ekzekutiv të tepërt që sjell deri te politizimi jo i drejtë i shërbimeve, por nga ana tjetër ata duhet të kujdesen sepse pushteti ekzekutiv ka autorizime të qarta ligjore dhe mjete që të kryejnë një kontroll efektiv mbi punën e shërbimeve të zbulimit. Ministrat munden të thirren në përgjegjësi për aktivitetet e shërbimeve të zbulimit vetëm nëse kanë pushtet të vërtetë të kontrollit dhe informata përkatëse për aktivitetet që ndërmarrin shërbimet.

2.3.3 Mbikqyrja parlamentare

Mbikqyrja mbi zbulimin është një nga fushat më të reja⁴⁷ dhe më të vështira të punës parlamentare. Në shumicën e demokracive sot është pranuar se të gjithë aktivitetet shtetërore duhet të jenë të hapura për mbikqyrje dhe hetim nga ana e Parlamentit. Shërbimet e zbulimit nuk janë përjashtim nga kjo rregull, edhe pse shpesh zbatohen kufizimet dhe restriksionet në informatat të cilat u jepen subjekteve që kryejnë mbikqyrjen.

› CILI ËSHTË FUSHËVEPRIMI I MBIKQYRJES MBI SHËRBIMET E ZBULIMIT?

- **Ligjshmëria** – i referohet pajtueshmërisë me të gjithë dispozitat e zbatueshme ligjore nga legjislacioni nacional primar dhe sekundar, si dhe me standardet të cilat rrjedhin nga konventat ndërkombëtare dhe “e drejta e butë” (siç janë vendimet e gjykatave ndërkombëtare, kodekset e sjelljes, rezolutat, rekomandimet etj.).
- **Efektiviteti** – i referohet shkallës deri te e cila shërbimi i arrin qëllimet konkrete të përkufizuara në politikat qeveritare (siç janë mbajtja e kërcënimeve në një nivel të caktuar).
- **Efikasiteti** – i referohet asaj se si kapacitetet financiare dhe njerëzore përdoren në mënyrë më ekonomike gjatë kryerjes të mandatit të shërbimeve

⁴⁷ Në aspektin historik, siguria nacionale, e sidomos zbulimi konsiderohet si fushë ekskluzive e kompetencës të pushtetit ekzekutiv, ndërsa pushteti ligjvënës dhe gjyqësorë e shtyn përzierjen. Madje edhe në vitet e 90-ta, pas përfundimit të luftës të ftohtë, mbikqyrja parlamentare mbi zbulimin është bërë normë dhe parakusht për demokracinë.

Autorizimet ligjvënëse

- Vendosija e kornizës ligjore për mbikqyrje;
- Ndikimi mbi politikën qeveritare në nivel të gjërë.

Kontrolli i buxhetit

- Miratimi i shpërndarjes buxhetore për secilin institucion të sigurisë;
- Mbikqyrja/verifikimi i respektimit të buxhetit të ndarë;
- Sanksioni në rast të shpenzimit të tepërt/jo legjitim nga ana e pushtetit ekzekutiv.

Mbikqyrja e drejtëpërdrejtë

- Organet mbikqyrëse
 - Komisioni (et) parlamentare;
 - Trupat e pavarura mbikqyrëse për të ndihmuar parlamentin.
- Përfshirja në vendimet e rëndësishme
 - Miratimi paraprak në rast të: misionëve të huaja, luftës, gjendjes të jashtëzakonshme, marrëveshjet ndërkombëtare;
 - Post kontrolli i vendimeve (me mundësi për revokim apo zëvendësim);
 - Caktimi i funksionarëve të lartë;
 - Miratimi apo konsultimet për furnizimet e rëndësishme për qëllimet e mbrojtjes
- Qasja deri te informacionet e (klasifikuara)
 - „Marrja e dokumentit”/Zbulimi proaktiv
 - Diskutimet/dëgjuesat
 - Informacionet/konsultimet
 - Mbrojtja e fshehtësisë
- Autorizimet e hetimit – parlamentet mund të themelojnë komisione anketuese me autorizime që të dëgjojnë dëshmitarë.

Komisionet e veçanta të specilizuara për mbikqyrje mbi zbulimin janë themeluar në më shumë shtete europiane. Në analizën krahasuese të parlamenteve në të gjithë Europën, asnjë zonë tjetër e mbikqyrjes parlamentare nuk është caktuar në mënyrë tjetër, të organizuar dhe ndarë me mandat të detyrave. Në thelb, ekzistojnë tre qasje në vendosjen e mbikqyrjes zbuluese, të cilat zhvillohen drejtë specializimit më të madh dhe kompleksitetit organizativ.

1) Komisionet për mbrojtje dhe siguri. Në disa vende, një komision me mandat të gjërë merret me legjislacionin dhe mbikqyrjen e të gjithë sektorit të sigurisë, duke përfshirë edhe shërbimet dhe sektorët e zbulimit. Kjo qasje u mundëson anëtarëve që të zhvillojnë një mirëkuptim gjithëpërfshirës të sektorit të sigurisë dhe të integrojnë mirë proceset ligjvënëse dhe mbikqyrëse. Ky është sot rasti me vendet si Shqipëria, Mali i Zi, Moldavia, të cilat kanë një sektor relativisht të vogël të sigurisë, por para një dekade apo dy kjo ishte qasje e më shumë demokracive dhe vendeve në tranzicion.

2) Komisionet për mbikqyrje mbi zbulimin. Shumica a madhe e parlamenteve europiane

⁴⁸ Është përshtatur nga Hans Born (2013): Parliamentary oversight of the security sector, European Parliament – OPPD, p. 25. https://www.dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/EP_Parliamentary_Oversight_Security_Sector_2013_BOH.pdf

kanë themeluar (krahas komisioneve të mbrojtjes dhe sigurisë) trupa të specializuar të punës të cilat merren ekskluzivisht me mbikqyrjen mbi zbulimin. Ata kanë mandat të ngushtë, të fokusuar për mbikqyrje, ashtuqë anëtarët e zgjedhur dhe personeli munden më së miri të shfrytëzojnë kohën dhe resurset dhe më së mirë dhe më shpejtë të zhvillojnë ekspertizën. Në disa vende, mandati i këtyre komisioneve është ekskluzivisht mbikqyrja, kurse përgjegjësitë e tyre në procesin ligjvënës janë të kufizuara.

3) Trupat e ekspertëve jashtë Parlamentit: Rritet numri i shteteve të cilët vendosin trupa ekspertësh për mbikqyrje mbi zbulimin, jashtë komisioneve parlamentare. Anëtarët janë funksionarë të lartë publik, anëtarë të njohur të shoqërisë civile, anëtarë aktual dhe të mëparshëm të gjyqësorit dhe politikanë të mëparshëm. Ata më së shpeshti kanë kompetenca që të mbikqyrin ligjshmërinë e punës të shërbimeve të zbulimit dhe respektimin e të drejtave të njeriut, por kompetencat e tyre gjithashtu mund të përfshijnë ndjekjen e efektivitetit të punës, praktikat administrative apo përdorimin e metodave ndërhyrëse për grumbullimin e informacioneve. Këto trupa zakonisht i përcakton respektivisht zgjedh Parlamenti dhe ata parashtrojnë raport në Parlament dhe/ose në pushtetin ekzekutiv. Belgjika, Kroacia, Danimarka, Gjermania, Greqia, Norvegjia, Holanda dhe Suedia janë shembuj të vendeve të tilla.

Strukturat e krijuara në kuadër të Parlamentit maqedonas të cilat kanë mandat që të sigurojnë një llogaridhënie të zbulimit e ilustrojnë evolucionin e njëjtë drejtë specializimit dhe komplikueshmërisë institucionale të mbikqyrjes mbi zbulimin.

- 1)** Komisioni për mbrojtje dhe siguri me një kompetencë të përgjithshme ligjvënëse dhe mbikqyrje mbi sektorin e zbulimit është përgjegjës për mbikqyrje mbi zbulimin ushtarak në kuadër të Ministrisë të mbrojtjes.
- 2)** Komisioni i specializuar për mbikqyrje mbi zbulimin shqyrton dy shërbimet kryesore – Agjencinë e sigurisë nacionale dhe Agjencinë e pavarur të zbulimit
- 3)** Komisioni i tretë parlamentar ka kompetenca shumë precize dhe të specializuara, dhe e ndjek zbatimin e metodave ndërhyrëse për grumbullimin e informacioneve.
- 4)** Ligji i ri për ndjekjen e komunikimeve i miratuar në prill të vitit 2018 sjell një institucion të ri në sistemin e mbikqyrjes: trupin civil (qytetar) që është jashtë Parlamentit (Këshilli për mbikqyrje civile), që pranon ankesa dhe shqyrton ligjshmërinë e përgjimit.

Krahas këtyre trupave të mbikqyrjes me mandat të veçantë për sektorin e sigurisë dhe zbulimit, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ka formuar një komision të përheshëm anketues⁴⁹ për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Komisioni shqyrton rastet e dyshimit serioz apo gjetjeve të cilat tregojnë për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë.

Autorizimet ligjore⁵⁰ të trupave për mbikqyrje janë parakushti i parë për mbikqyrje efektive mbi zbulimin. Autorizimet ligjore të tre komisioneve parlamentare maqedonase mbështeten (1) në dispozitat e përgjithshme ligjore të cilat rregullojnë mbikqyrjen parlamentare, dhe (2) dispozitat e veçanta të cilat rregullojnë mbikqyrjen mbi zbulimin.

(1) Baza juridike për mbikqyrjen parlamentare është shënuar në Kushtetutën e Republikës të Maqedonisë së Veriut në të cilën theksohet: “Kuvendi kryen kontroll parlamentar dhe mbikqyrje mbi Qeverinë dhe mbi bartësit tjerë të funksioneve publike që janë përgjegjës para Qeverisë.”⁵¹

⁴⁹ Edhe krahas emrit të saj, megjithatë, ajo nuk ka autorizime hetuese (të ftojë dëshmitarë)

⁵⁰ Shtojca A jep shqyrtim të ekstrakteve relevante nga ligji të cilat komisioneve parlamentare u japin autorizime ligjore për mbikqyrje mbi zbulimin

⁵¹ Neni 68, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Ligji për Parlamentin ka një kapitull të veçantë të quajtur “mbikqyrja parlamentare” që rregullon diskutimet mbikqyrëse si instrumenti kryesor për mbikqyrje.

Rregullorja e punës të Parlamentit është dokumenti më i vjetër i detajuar juridik që rregullon të drejtat dhe detyrimet e deputetëve duke përfshirë edhe të drejtën e informimit, përdorimin e pyetjeve parlamentare dhe interpelancën si mjet për mbikqyrje, punën me informacionet e besueshme dhe procedurën për përzgjedhje të trupave të punës

Megjithatë, këto dispozita të përgjithshme i referohen drejtëpërdrejtë komisioneve për mbikqyrje mbi zbulimin. Disa prej tyre janë mjete të rëndësishme të cilat deputetët mund t'i përdorin në mënyrë proaktive. Për shembull, në rastet kur nëpunësit publik nuk paraqiten pasi që të jenë të ftuar në seanca të komisionit apo kur komisionet, për shkaqe të caktuara, nuk mbajnë takime, deputetët e caktuar mund të kryejnë mbikqyrje përmes shtruarjes të pyetjeve parlamentare në seancën parlamentare. Meqënëse deputetët nga komisionet mbikqyrëse kanë një certifikat të sigurisë, mund të kërkojnë përgjigje me shkrim në rastet kur përgjigja përmban informacione të klasifikuara.

(2) Përveç këtyre dispozitave të përgjithshme të cilat i referohen Parlamentit në tërësi, mbikqyrja mbi aktivitetet mbikqyrëse, nga ana e komisioneve të përkushtuara parlamentare, parashihet shkurt në disa ligje.

- Neni 11 nga Ligji i Agjencisë të sigurimit parasheh se “drejtori është përgjegjës që të mundësojë qqyrje dhe të sigurojë të gjithë informacionet dhe të dhënat në fushëveprimin e punës të komisionit”.
- Neni 60 nga Ligji i Agjencisë të sigurisë nacionale thotë se “drejtori është i detyruar, me kërkesë të trupit kompetent punues të Kuvendit për mbikqyrje të Agjencisë, të lejojë qqyrje në dokumentacion, të jap të dhëna dhe informacione për punën e Agjencisë dhe të përgjigjet në pyetjet në lidhje me punën e Agjencisë”.
- Të dy shërbimet janë të detyruara që të dorëzojnë raport vjetor për punën e tyre deri te komisioni. Agjencia e sigurisë nacionale, gjithashtu, dorëzon programin vjetor të punës⁵².

Kompetencat e komisioneve parlamentare dmth “fushëveprimi i tyre i punës” është përkufizuar me vendimet parlamentare në fillim të secilit legjislacion të ri.

Sipas këtij burimi të autorizimeve ligjore⁵³, **Komisioni për mbikqyrje mbi punën e Agjencisë të sigurisë nacionale dhe Agjencisë për zbulim**, ka një mandat të fuqishëm mbikqyrës, që përfshin respektimin e ligjit gjatë realizimit të autorizimeve të shërbimeve, respektimin e të drejtave të njeriut, e madje edhe metodat dhe mjetet që përdorin shërbimet, siç janë kapacitetet financiare, kadrovike dhe teknike. Shërbimet kanë për detyrë që të sigurojnë informacione të nevojshme për realizimin e mandatit mbikqyrës të komisionit.

Ligji për ndjekjen e komunikimeve, i miratuar në prill të vitit 2018, sqaron dhe përforcon autorizimet ligjore të Parlamentit në **mbikqyrjen e përgjimit të komunikimeve**. Komisioni parlamentar që ka mandat në këtë detyrë është përkufizuar nga këto karakteristika:

Përbërja: Me komisionin udhëheq anëtari i opozitës (neni 38). Dhënia e rolit udhëheqës për opozitën në mbikqyrje konsiderohet si praktikë e mirë në përcaktimin e llogaridhënies të aktiviteteve qeveritare të cilat zhvillohen në fshehtësi, ku keqpërdorimi dhe përdorimi arbitrar i autorizimeve janë lehtësisht të disponueshme.

⁵² Neni 60, pg. 6, Ligji për Agjencinë e sigurisë nacionale, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut nr. 108.2019

⁵³ Vendimi parlamentar nr. 08-1396/1 nga 31 maj 2017

Mandati. Komisioni e autorizon që të shqyrtojë ligjshmërinë dhe efikasitetin (neni 40) e përgjimeve. Ligjshmëria duhet të vlerësojë përmes krahasimit të të dhënave statistikore të cilat i gjenerojnë operatorët e shërbimeve, ATO-ja dhe trupat tjerë të autorizuar për realizimin e përgjimit (neni 41-3). Komisioni mund të kryejë mbikqyrje pa një njoftim paraprak, sipas nevojës, dhe të paktën një herë në periudhën prej tre muajsh, madje edhe pa shumicën e votave (neni 33). Këto dispozita ndihmojnë në vendosjen e një klime të llogaridhënies dhe praktikën e rregullt të mbikqyrjes. Duhet të kihet kujdes në disa dispozita ligjore, interpretimi i mëtutjeshëm i të cilave dhe zbatimi janë të rëndësishme për përkufizimin e fushëveprimit të ardhshëm të mbikqyrjes:

- Përderisa ligjshmëria i referohet realizimit të përgjimit të komunikimit për qëllimet e hetimeve penale (policia gjyqësore, neni 7), dhe gjithashtu për qëllime të sigurisë dhe të mbrojtjes (nga ana e DSK dhe MM, neni 18) duket se efikasiteti i referohet vetëm përgjimeve për qëllimet e hetimeve penale, kurse qëllimi mbikqyrës duhet të realizohet përmes analizës të raportit të prokurorit publik (neni 40(3)).
- Që të shqyrtohet efikasiteti i përgjimeve të cilat realizohen për qëllimet e sigurisë nacionale dhe mbrojtjes, komisioni do të ketë nevojë për burime të ndryshme dhe më të ndërlikuara të informacioneve. Sipas frymës të ligjit, mbikqyrja duket se fillimisht merret me sigurimin e zbatimit të drejtë të masave hetimore dhe proceseve, dhe rrjedhimisht, mbikqyrja fillimisht është drejtuar drejtë sferës funksionale të zbulimit, por kjo nuk përjashton mundësinë për angazhimin e mbikqyrjes në aktivitetet operative dhe efikasitetin e tyre

Qasja në ekspertizë. Ligji parasheh (neni 39) se më së voni në afat prej 50 ditësh pas caktimit të tij, komisioni do të angazhojë dy ekspertë për mbështetje të përhershme teknike. Në afat prej 6 muajsh, komisioni duhet të krijojë një listë të ekspertëve nacional dhe ndërkombëtarë që të sigurojnë mbështetje të bazës nga rasti në rast. Ligji përmend detyrimin e agjencive të tjera shtetërore që të sigurojnë një mbështetje ekspertësh me kërkesë të komisionit. Këto janë masa të jashtëzakonshme me qëllim të rritjes të ekspertizës të komisionit dhe që të rritet aftësia të përfshihen në mbikqyrje efektive. Ekspertiza e pamjaftueshme në punët e zbulimit është një nga problemet më të mëdha të zbulimit, në çdo vend. Ligji i ofron komisionit disa mënyra të ndryshme për zgjidhjen e këtij problemi dhe, me vendosjen e afateve të ngushta për punësim të ekspertizës, e përforcon komisionin që të ndërmarrë veprime dhe të zgjidh këtë çështje.

Qasja deri te informacionet. Të dhënat deri te të cilat ka qasje komisioni me qëllim që të realizojë mandatin e tij për mbikqyrje mbi *ligjshmërinë* janë përmendur në nenin 41-3. Komisioni mund të kontrollojë numrin e autorizimeve të lëshuara dhe llojet e ndjekjeve që janë zbatuar. Me supozimin se dokumentacioni deri te i cili ka qasje përmban indikacione të tilla specifike, gjithashtu, mund të kontrollojë llojet e kundërvajtjeve për të cilat janë zbatuar lloje të ndryshme të ndjekjeve. Ky lloj i mbikqyrjes është i rëndësishëm, sepse mund të bind politikanët në Kuvend se ndjekja nuk del jashtë kontrolli.

- Megjithatë, komisioni duhet të përkushtohet që të marrë informacione të cilat përputhen me kompetencat për mbikqyrje kur bëhet fjalë për efikasitetin në përgjim. Kjo do të thotë se duhet të shkoj përtej ndjekjes të “gjurmëve në letër” dhe krahasimit të të dhënave statistikore dhe të zhvillojë aftësi të mjaftueshme për zbulimin e fakteve që të hetojë sjelljen dhe evidencën e agjencive kompetente.
- Qasja deri te informatat e klasifikuara (neni 37) udhëzon se anëtarët e organit mbikqyrës duhet të “posedojnë certifikat të sigurisë me shkallë përkatëse për qasje deri te informacionet e klasifikuara”, kurse certifikati i tillë do të lëshohet në afat prej 30 ditësh. Në varësi nga ajo se saktësisht cili nivel i informatave duhet të rishikohet, e sidomos nëse përfshin informata operative, kjo duket se është jashtëzakonisht e shkurtër dhe një afat kohor ndoshta tepër ambicioz për kontrollimin dhe miratimin e certifikatëve të sigurisë.

Njoftimi. Aty ku janë zbuluar parregullsi, komisioni duhet të informojë prokurorinë, organet kompetente (për mbrojtjen e të dhënave) dhe, sipas nevojës, Kuvendin dhe qytetarët. Mund të përgatisë raporte të veçanta kur këtë do ta kërkojë Kuvendi. Raportet vjetore të komisionit duhet të shpallen (neni 45). Ligji mbështet praktikën e mirë të përmenden afate të qarta kohore për shpalljen e raporteve. Komisioni duhet të dorëzojë raportin vjetor deri te Kuvendi më së voni deri në fund të shkurtit çdo vit (neni 45(1)), që është një qëllim tejte ambicioz

- Ligji është pak i paqartë për atë se kur dhe si do të shpallen publikisht rezultatet nga hetimet dhe mbikqyrja. Komisioni do të informojë publikun kur kjo do të jetë e nevojshme pa dhënë të dhëna konkrete (neni 44). Pyetja për atë se çfarë do të thotë “sipas nevojës” dhe kush vendos për këtë, duhet të sqarohet sërish në Rregulloren e punës të komisionit.
- Një qëllim tjetër shumë ambicioz kur bëhet fjalë për njoftimin është theksuar në nenin 51: Komisioni do të njoftojë Këshillin e mbikqyrjes civile për rezultatet e secilës kërkesë në afat prej 15 ditësh. Është pak e mundur që ky afat përfundimtar mund të përmbushet rregullisht, edhe pse dukshëm se do të varet nga resurset kadrovike të cilat janë në dispozicion të komisionit.

Ligji për ndjekjen e komunikimeve i referohet vetëm njëres nga tre komisionet parlamentare mandatet e të cilave përfshijnë aspekte dhe institucione të ndryshme në kuadër të sektorit maqedonas të zbulimit. Megjithatë, dispozitat e tij ambicioze sygjerojnë ndryshimet drejtë mbikqyrjes të përforcuar dhe kanë potencial që të inspirojnë komisionet tjera që të përkushtohen drejtë ndryshimeve në ligje, rregullativë dhe praktika, me qëllim të përmirësimit të kontributit parlamentar në mbikqyrjen mbi zbulimin. Mund të parashihi disa hapa të mundshme për zhvillimin e mëtejshëm të autorizimeve ligjore të komisioneve:

- **Miratimi apo ndryshimi i rregullores të punës të komisioneve.** Autorizimet e përforcuara ligjore të parapara në Ligjin për ndjekjen e komunikimeve për komisionet relevante duhet të përdoren për zhvillimin e praktikave efikase të mbikqyrjes, të cilat rregullisht do të zbatohen nga komisionet. Miratimi i rregullores të punës të komisioneve (e kërkuar nga neni 46 i ligjit) është hapi i ardhshëm i domosdoshëm në paraqitjen e dispozitave nga ligji në udhëzime praktike, të hollësishme për punë të komisioneve. Dy komisionet tjera duhet të ndjekin shembullin, sepse anëtarët janë të vetëdijshëm se mbikqyrja mbi zbulimin është përgjegjësi e përbashkët për secilin prej tyre.
- **Miratimi i ligjeve të shkruara për të gjithë shërbimet/sectorët e zbulimit.** Pakoja ligjore e miratuar në periudhën 2018-19 duhet të jetë vetëm fillimi i një reforme ligjore gjithëpërfshirëse e sektorit të zbulimit dhe mbikqyrjes të tij. Përprerja të ngjajshme janë në vijim e sipër në shumë shtete europiane. Mandati ligjor i të gjithë agjencive dhe sektorëve që mund të përdorin metodat ndërhyrëse për grumbullimin e informatave duhet të përkufizohet më qartë në rregullativën ligjore (Agjencia e zbulimit dhe Agjencia e sigurisë nacionale). Duhet të shmangen paqartësitë dhe përplasjet me qëllim që të krijohet një bazë e qartë për llogaridhënie.
- **Mundësia për miratimin e legjislacionit të veçantë për sektorin e zbulimit.** Sfidat e njohura për procesin e mbikqyrjes mbi zbulimin kërkojnë një bazë të fuqishme ligjore dhe procedura të qarta për punën e trupave mbikqyrëse. Në vend se autorizimi ligjor për kryerjen e mbikqyrjes të jetë shpërndarë në disa ligje dhe rregulla, disa vende kanë vendosur që të miratojnë një ligj të veçantë që në mënyrë të qartë të parasheh mandatin dhe autorizimet e trupave mbikqyrëse (Gjermania, Sllovenia, Mali i Zi, Britania e Madhe dhe Romania janë vetëm disa prej shembujve). Kjo sjell disa përparësi: i qartëson rregullat e lojës në mbikqyrje dhe e bënë të pakontestueshme autorizimin ligjor të mbikqyrjes. Kështu kontribuohet drejtë shikueshmërisë më të madhe, prestigjit

dhe kredibilitetit të trupave përgjegjëse për mbikqyrje, nga një në mandat tjetër, duke kontribuar për përmirësimin e memorisë institucionale.

Mbikqyrja mbi zbulimin është ambicioze, e ndryshueshme dhe një përpjekje krenare. Mbikqyrja duhet të shihet si një proces në pafundësi, edhe krahas të gjithë sfidave, duhet të avancohet në aspekt të efikasitetit të tij. Problemi kryesor në mbikqyrje qëndron kryesisht në kulturën institucionale dhe institucionet e zbulimit të cilat, të miratuara nga shteti, kanë të drejtë ligjore të përdorin metoda ndërhyrëse, metoda për grumbullimin e informacioneve dhe autorizime të tjera të veçanta. Miratimi i legjislationi është përgjegjësi e parlamentit. Por, ligjet asnjëherë nuk mund të formulohen aq saktësisht që të përjashtojnë të gjithë potencialet për keqpërdorim të pushtetit. Gjithmonë do të ketë mënyra që të shfrytëzohen zbrazëtit, nëse institucionet të cilat kanë mandat të sigurojnë sundimin e të drejtës siç janë parlamenti dhe gjyqësori, nuk kanë mundësi apo nuk duan që të pengojnë këtë.

› ÇFARË LLOJË TË AUTORIZIMEVE LIGJORE KANË KOMISIONET PARLAMENTARE PËR MBIKQYRJE MBI ZBULIMIN NË BE?

Autorizimet themelore (20 deri në 24 parlamente të analizuar)

- Mbikqyrje mbi politikat e shërbimeve dhe administratës, buxhetit dhe shpenzimeve;
- Pranimi i raporteve të shërbimeve të zbulimit dhe/ose nga pushteti ekzekutiv;
- Mund të kërkojnë nga shërbimet e zbulimit dhe/ose pushteti ekzekutiv që t'i dorëzojnë informata komisionit.

Autorizimet e zgjeruara (4 prej 24) – autorizimet themelore janë zgjeruar me:

- Pranimin e ankesave nga qytetarët;
- Inicimin e hetimeve sipas iniciativës personale dhe kryerjen e inspektimeve të objekteve;
- Dhënien e rekomandimeve apo vendimeve të detyrueshme;
- Mund të përfshihen në procesin e miratimit të masave të ndjekjes.

Agjencia e BE-së për të drejtat fundamentale (FRA), Ndjekja nga ana e shërbimeve të zbulimit, masat dhe mjetet themelore mbrojtëse në Europë. Mapimi i kornizës ligjore të shteteve-anëtare, viti 2015

2.3.4 Trupat tjerë të pavarur

2.3.4.1 Këshilli për mbikqyrjen civile

Ligji për ndjekjen e komunikimeve nga viti 2018⁵⁴ vendos edhe një nivel të mbikqyrjes mbi zbulimin, përmes trupit civil që është përgjegjës të kryejë mbikqyrje mbi ligjshmërinë e përgjimit të komunikimeve. Ky është një hap i rëndësishëm drejtë ndërtimit të besimit të publikut në sektorin e zbulimit, sidomos për shkak të asaj se një numër i madh i anëtarëve të shoqërisë civile kanë qënë objekt i përgjimit të kundërligjshëm në të kaluarën.

Puna e Këshillit për mbikqyrje civile është ngushtë e lidhur me Parlamentin, e sidomos me Komisionin parlamentar për mbikqyrje mbi ndjekjen e komunikimeve. Këshilli përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë (tre ekspertë dhe tre përfaqësues të organizatave joqeveritare) të cilët i cakton Parlamenti pas shpalljes të konkursit publik. Këshilli dorëzon raportin vjetor deri te

⁵⁴ Ligji për ndjekjen e komunikimeve, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë, nr. 71/2018

Parlamenti, i cili shqyrtohet në seancën e Parlamentit. Hapësirat e punës të Këshillit i siguron Parlamenti, me çrast mundësohet një bashkëpunim më i ngushtë dhe komunikim ndërmjet komisioneve parlamentare dhe Këshillit.

Risia tjetër e përfshirë në ligjin për ndjekjen e komunikimeve është mundësia që qytetarët të dorëzojnë parashtresa në rastet e dyshimit për përgjim të kundërligjshëm. Këshilli dhe Parlamenti do të ndajnë përgjegjësinë për të trajtuar këto parashtresa. Në fakt, Këshilli do ta pranonte dhe parashtresën dhe të mbante një komunikim me palët e përfshira, ndërsa komisioni parlamentar do të ishte përgjegjës për kontrollimin dhe vërtetimin e ekzistimit të kundërvajtjes. Parashtresat e qytetarëve mund të jenë parashtruar në formë me shkrim përmes arkivës të Kuvendit, të dërguara me postë apo përmes plotësimit të formularit specifik. Parashtresat e dorëzuara deri te Këshilli duhet të mbajnë emër dhe mbiemër, datën dhe vendin e lindjes të parashtruesit, kërkesën e qartë konkrete dhe periudhën kohore të cilës i referohet.⁵⁵ Pas pranimit të parashtresës, Këshilli duhet menjëherë të dorëzojë kërkesën deri te komisioni parlamentar për mbikqyrje mbi ndjekjen e komunikimeve, duke kërkuar prej tyre që të shqyrtojnë parashtresën. Në ndërkohë, në bazë të parashtresës, Këshilli kryen mbikqyrje në ATO dhe organet e autorizuara. Komisioni ka afat prej 15 ditësh që të shqyrtojë dhe të njoftojë Këshillin (neni 51.2). Për veprimin efektiv të përbashkët si përgjigje për ankesat, Parlamenti duhet të zhvillojë rregulla dhe procedura të qarta me të cilat rregullohet bashkëpunimi dhe komunikimi ndërmjet dy trupave.

Autorizimet e komisionit parlamentar janë më të gjëra sepse nuk mund të realizohet mbikqyrja mbi ATO, organet kompetente dhe operatorët, në mënyrë të pavarur apo përmes ekspertëve teknik, madje edhe pa paralajmërim. Krahas kësaj, për dallim nga Këshilli, komisioni mund të marrë logot gjatë kohës të fillimit dhe përfundimit të masës për ndjekjen e komunikimeve. Për shkak të ruajtjes të besueshmërisë të masave për ndjekjen e komunikimeve, njoftimi i komisionit deri te Këshilli vetëm informon nëse në rastin konkret është vërtetuar keqpërdorim apo jo. Pas marrjes të njoftimit, Këshilli njofton parashtruesin e parashtresës. Në rast të keqpërdorimit, Këshilli gjithashtu e informon publikun (neni 51.7) dhe prokurorin publik kompetent (neni 51/6).

Këshilli është gjithashtu i autorizuar të kryejë mbikqyrje mbi ATO-n dhe organet e autorizuara, sipas iniciativës personale. Në këtë rast, ai mund të kryejë mbikqyrje vetëm sipas njoftimit paraprak, për qasje deri te të dhënat e kopjeve të anonimizuara⁵⁶ nga urdhërat e tre muajve paraprak; kjo i mundëson Këshillit që të krahasojë numrin e urdhërave për ndjekjen e komunikimeve, kohëzgjatjen e ndjekjes dhe numrat amë. Roli hetues i Këshillit duket se varet nga autorizimet hetuese të komisionit përkatës parlamentar (shihni nenin 51/2).

Këshilli në pajtim me ligjin sjell Rregulloren për punën e tij, me të cilën rregullohen çështjet për mënyrën e punës të Këshillit. Këshilli vepron me dokumentet në të cilat ka shenjë të sekretit (fshehtësisë) në mënyrë të përcaktuar me ligj dhe rregullat tjera me të cilat rregullohet ajo fushë që të mos vijë deri te shkelja e sigurisë të informatave të klasifikuara dhe keqpërdorimi i të dhënave personale.

Ekziston rreziku i dyfishimit të punës të Këshillit dhe komisionit (sidomos në lidhje me parashtresat e publikut) por gjithashtu edhe nga ndarja e qëndrimeve dhe gjetjeve për punën e shërbimeve. Efektiviteti i mbikqyrjes që kryejnë këto trupa do të varet shumë nga zhvillimi i mëtutjeshëm i procedurave, praktikave dhe profesionalizmit në kuadër të komisioneve të Kuvendit dhe Këshillit për mbikqyrje civile. Rregullat e qarta të procedurave gjithashtu duhet të minimizojnë rrezikun e politizimit të mbikqyrjes.

⁵⁵ Rregullorja e Këshillit

⁵⁶ Anonimizimi është procesi në të cilin të gjithë elementet identifikuese të përmendura në urdhër, duke përfshirë edhe të dhënat personale dhe të dhënat tjera, largohen në mënyrë që garanton se subjekti i të dhënave personale nuk mund të jetë i identifikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo jo të drejtëpërdrejtë.

2.3.4.2 Avokati i popullit

Avokati i popullit është institucion i pavarur, i mëvetësishëm dhe profesional që ka për qëllim të kontribuojë për rritjen e nivelit të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qytetarit dhe avancimin e vlerave demokratike. Mandatet e institucioneve të ombudsmanit variojnë në mënyrë të konsideruar në të gjithë Europën dhe shumica nuk luajnë ndonjë rol të konsideruar mbi zbulimin. Madje kur edhe ligjet u lejojnë konkretisht që të hetojnë parashtresat nga qytetarët për shërbimet e sigurisë dhe zbulimit, ata rrallëherë e bëjnë këtë në praktikë. Megjënëse mund të japin vetëm rekomandime, ndikimi i tyre mbi sjelljen e shërbimeve apo në situata të shkeljes të të drejtave të njeriut në situatën e caktuar është i kufizuar.

Roli i avokatit maqedonas të popullit në mbikqyrjen mbi zbulimin mund të jetë domethënës, duke patur parasysh atë se mandatin ja jep legjislacioni nacional. Baza juridike për punën e ombud-institucionit rrjedh nga neni 77 i Kushtetutës të Republikës të Maqedonisë së Veriut, e cila e autorizon “që të mbrojnë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve kur shkelen nga organet e administratës shtetërore dhe nga organet dhe organizatat tjera që kanë autorizime publike”. Çdo qytetar ka të drejtë të parashtrojë ankesë deri te Avokati i Popullit – i cili zgjidhet nga parlamenti për periudhën prej tetë vitesh dhe që mund të rizgjidhet vetëm edhe njëherë.

Ligji për avokatin e popullit, i miratuar në vitin 2003⁵⁷, i jep mandat të qartë dhe autorizime të qarta hetuese të cilat janë në pajtim me Parimet e Parisit dhe dokumentet tjera të zbatueshme ndërkombëtare. Avokati i popullit mund të iniciojë hetime sipas iniciativës personale (neni 13) mbi bazë të arsyes të kuptueshme apo pas vlerësimit se mund të ndodhin keqpërdorime. Ai ka autorizim që të detyrojë institucionet publike që të sigurojnë informacione dhe sqarime të detajuara në lidhje me çfarëdo ankesa të kohshme; dhe gjithashtu ka të drejtë të hyjë në hapësirat e institucionit për qasje deri te dokumentacioni i tyre (neni 24). Të gjithë nëpunësit shtetëror (duke përfshirë edhe udhëheqësit e shërbimeve të zbulimit) duhet ta respektojnë kërkesën e tij, pavarësisht nëse informacionet e kërkuara janë të klasifikuara (neni 27). Pasiqë Avokati i popullit do të vërtetojë se ka patur shkelje, ai ka të drejtë: të propozojë mënyra për heqjen e pengesës të vërtetuar, të iniciojë procedurë disiplinore apo të kërkojë që prokurori publik të iniciojë procedurë penale (neni 32).

Ligji i ri për ndjekjen e komunikimeve (neni 56) i jep Avokatit të popullit rol në mbikqyrje mbi ligjshmërinë e përgjimit, nga aspekti i mbrotjes të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Megjithatë, edhe krahas këtij autorizimi të fortë ligjor për mbikqyrje, institucioni i Avokatit të popullit nuk ka evidencë për mbrojtjen aktive të të drejtave të njeriut në lidhje me qytetarët përballë sektorit të sigurisë dhe zbulimit. Avokati i popullit, sidomos ndjek gjendjet e respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të personave në organet, organizatat dhe entet në të cilat liria e lëvizjes është e kufizuar.

Kur Avokati i popullit do të konstatojë se janë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të parashtruesit të parashtesës apo se janë bërë parregullsi tjera, mundet:

- Të jep rekomandime, propozime, mendime dhe dëshmi për mënyrën e largimit të shkeljeve të konstatuara;
- Të propozojë sërish që të zbatohet procedura e caktuar në pajtim me ligjin;
- të iniciojë iniciativë për ngritjen e procedurës disiplinore kundër personit zyrtar, respektivisht personit përgjegjës, dhe të dorëzojë kërkesë deri te prokurori publik kompetent për iniciimin e procedurës për vërtetimin e përgjegjësisë penale.

⁵⁷ Ligji për Avokatin e popullit, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut nr. 60/2003, 181/2016, 189/2016, 35/2018 dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese (Gazeta zyrtare nr. 111/2007)

Avokati i popullit çdo vit e njofton Parlamentin për punën e tij, përmes dorëzimit të raportit që është publikisht i disponueshëm të cilin e prezanton në seancë plenare të Parlamentit në të cilin marrin pjesë edhe përfaqësues nga Qeveria. Kjo mund të jetë një mundësi që Parlamenti të përfshihet në dialog më të detajuar me Avokatin e popullit, në përpjekjen për të shkëmbyer leksione shkencore dhe të zhvillojë plotësim të veprimeve.

2.3.4.3 Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale

Respektimi dhe mbrojtja e privatësisë të qytetarëve, si dhe siguria dhe fshehtësia e të dhënave personale, janë liri dhe të drejta të garantuara me Kushtetutën e Republikës të Maqedonisë së Veriut. Garanca e tyre reale dhe mbrojtja praktikisht fillon me themelimin e Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale në vitin 2005, e cila me miratimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale nga vitit 2020⁵⁸, quhet Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale.

Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale është një organ shtetëror i mëvetësishëm dhe i pavarur me të cilën udhëheq drejtori të cilin e zgjedh dhe shkarkon Kuvendi i Republikës të Maqedonisë së Veriut me mandat prej pesë vitesh. Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale deri te Kuvendi i Republikës të Maqedonisë së Veriut dorëzon raportin vjetor, kurse sipas nevojës edhe raportet shtesë.

Agjencia është një nga trupat më të rëndësishëm të pavarur mbikqyrës kur bëhet fjalë për mbikqyrjen mbi zbulimin, duke patur parasysh se shërbimet e zbulimit grumbullojnë dhe përpunojnë sasi të mëdha të të dhënave të ndjeshme personale. Gjithashtu, kjo është një nga trupat kompetente për mbikqyrje të masave për ndjekje të komunikimeve për shkak të vërtetimit të ligjshmërisë të aktiviteteve të cilat ndërmerren gjatë përpunimit të të dhënave personale dhe masave të cilat ndërmerren për mbrojtjen e tyre. Përgjegjësitë ligjore të cilat i kanë shërbimet e zbulimit në fushën e mbrojtjes të të dhënave personale kryesisht i referohen:

- Ligjshmërisë dhe legjitimitetit të përpunimit të të dhënave personale në punën e zbulimit.
- Zbatimi i masave relevante teknike dhe organizative të cilat minimizojnë rrezikun nga keqpërdorimi i mundshëm.
- Për të qënë të sigurtë se kur ndodhin keqpërdorime, ata lënë gjurmë që askush nuk mund t'i ndryshojë, duke mundësuar reagim të shpejtë dhe ndarje të qartë të detyrimeve dhe përgjegjësi të atyre të cilët përpunojnë të dhënat personale në kuadër të shërbimeve të sigurisë-zbulimit.

Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale siguron kontroll sistematik dhe të pavarur mbi ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale duke përfshirë hetimin, kontrollimin, dhënien e drejtimeve, dhe trajnimet për mbrojtjen e të dhënave personale. Supervizioni respektivisht mbikqyrja e rregullt kryhet sipas programit vjetor, megjithatë, mund të kryhet edhe supervizioni i jashtëzakonshëm me propozim/iniciativë të organit shtetëror, personit juridik apo fizik, sipas detyrës zyrtare apo nëse supervizioni dyshon se ka patur shkelje të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu mund të kryhet edhe supervizioni respektivisht mbikqyrje kontrolluese për shkak të largimit të shkeljeve të konstatuara.

Gjatë kryerjes të supervizionit, supervizioni nga Agjencia⁵⁹ ka të drejtë:

- Të kontrollojë aktet e përgjithshme dhe individuale, dokumentet, dosjet kompjuterike, informatat dhe dëshmitë tjera në vëllim sipas lëndës të supervizionit, si dhe të kërkojë

⁵⁸ Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020

⁵⁹ Neni 105, Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020

- dhe të mbajë kopje të të njëjtave në formë të shkruar apo elektronike pa kompenzim,
- Të kryejë kontroll në hapësirat afariste apo zyrtare dhe objektet tjera ku bëhet përpunimi i të dhënave personale dhe të kërkojë kqyrje në përpunimin e tyre,
 - Të kryejë kqyrje në dokumentet për identifikim personal të personave për shkak të vërtetimit të identitetit të tyre në pajtim me ligjin,
 - Të kërkojë nga kontrollori, respektivisht përpunuesi, që me shkrim apo me gojë të jap sqarim në lidhje me çështjet nga fushëveprimi i supervizionit,
 - Të kërkojë analizë eksperte dhe mendim kur kjo është e nevojshme për supervizionin
 - Të përdor mjete teknike për fotografimin si dhe të sigurojë regjistrim në video të cilat mund të përdoren në supervizion
 - Të testojë pajisjen me të cilën bëhet përpunimi i të dhënave personale dhe pajisjen ku ruhen të dhënat personale, si dhe të testojë sistemin e informatave dhe infrastrukturën e informatave në kuadër të të cilave kryhet përpunimi i të dhënave personale, me përfaqësues të autorizuar të kontrollorit, respektivisht përpunuesit,
 - Të shfrytëzojë pajijsjet e komunikacionit të kontrollorit, respektivisht përpunuesit për shkak të përmbushjes të qëllimeve të supervizionit dhe
 - Të sigurojë dëshmi tjera të nevojshme sipas lëndës të supervizionit.

Pas supervizionit të kryer përgatitet procesverbal në të cilin shënohen gjetjet e gjendjes të gjetur dhe shkeljet eventuale të dispozitave respektivisht akteve për mbrojtjen e të dhënave personale. Nëse institucioni nuk vepron sipas rekomandimeve të dhëna, Agjencia njofton Qeverinë apo Parlamentin me një raport të veçantë. Agjencia, gjithashtu, dorëzon raport vjetor deri te Parlamenti, të shpallur në ueb faqen e Agjencisë⁶⁰. Raportet e Agjencisë janë një mjet i dobishëm për mbikqyrje mbi punën e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Parlamenti mund të ndjek zbatimin e rekomandimeve të dhëna në këto raporte dhe mund të kërkojë informata dhe sqarime për masat dhe veprimet e ndërmarra me qëllim që të përmirësohen parregullsitë e identifikuara gjatë kohës të mbikqyrjes nga ana e Agjencisë.

› CILAT JANË PRAKTIKAT E MIRA NDËRKOMBËTARE PËR GRUMBULLIMIN E TË DHËNAVE DHE ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE TË ZBULIMIT DHE PËRDORIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE?

Praktika 21. Legjislacioni nacional përshkruan llojet e masave për grumbullim në dispozicion të shërbimeve të zbulimit, qëllimet e lejuara të grumbullimit të informatave të zbulimit, kategoritë e personave dhe aktivitetet të cilat mund të jenë objekt i grumbullimit të informatave të zbulimit, pragu i nevojshëm i dyshimit që të arsyetohet përdorimi i masave për grumbullimin, kufizimin dhe kohëzgjatjen për të cilën mund të përdoren masat për grumbullimin, dhe procedurat për miratimin, mbikqyrjen dhe kontrollimin e përdorimit të masave për grumbullimin e informatave të zbulimit.

Praktika 23. Ligji që është publikisht i disponueshëm përshkruan llojet e të dhënave personale të cilat mund të posedojnë shërbimet e zbulimit dhe cilat kriterë i referohen përdorimit, mbajtjes, fshirjes dhe shpalosjes të këtyre të dhënave. Shërbimeve të zbulimit u është lejuar që të mbajnë të dhënat personale të cilat janë rreptësisht të nevojshme për qëllimet e përmbushjes të mandatit të tyre.

Praktika 24. Shërbimet e zbulimit kryejnë vlerësime të rregullta të rëndësisë dhe

⁶⁰ Neni 67 dhe 70, Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020

saktësisë të të dhënave personale të cilat i posedojnë. Ata janë ligjërisht të detyruar të fshijnë apo përditësojnë informacionet e tilla të cilat do të vlerësohen si të pasakta apo se nuk janë më të rëndësishme për mandatin e tyre, punën e institucioneve të mbikqyrjes apo procedurave të mundshme juridike.

Praktika 25. Ekziston institucion i pavarur që mbikqyr përdorimin e të dhënave personale nga shërbimet e zbulimit. Ky institucion ka qasje deri te gjithë dosjet të cilat i posedojnë shërbimet e zbulimit dhe ka autorizim të urdhërojë shpalosjen respektivisht zbulimin e informatave për palët e interesit, si dhe shkatërrimin e dosjeve apo përmbytjetve të të dhënave personale.

KB, Këshilli për të drejtat e njeriut, M.Shajnin (viti 2020)

Kontrolli sistematik mbi mbrojtjen e të dhënave personale nga ana e shërbimeve të zbulimit duhet të ndjek zbatimin e këtyre parimeve:

Ligjshmëria - të dhënat personale duhet të përpunohen në pajtim me ligjin, mjafton edhe transparencë në lidhje me subjektin e të dhënave personale, duke marrë parasysh specifikat e zbulimit, kur transparencë është e shpeshtë (e arsyetuar), kufizuar ("ligjshmëria, drejtshmëria dhe transparencë");

Legjitimiteti- të dhënat personale duhet të grumbullohen për të dhëna specifike, të qarta dhe legjitime;

Proporcionaliteti - të dhënat personale që përpunohen duhet të jenë përkatëse, relevante dhe të kufizuara për qëllimet e nevojshme për të cilat përpunohen ("vëllimi minimal i të dhënave");

Saktësia - të dhënat personale duhet të jenë të sakta dhe të ruajtura në formë që siguron identifikimin e subjekteve të të dhënave personale, dhe jo më gjatë se që është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen; dhe

Mbrojtja fizike - të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë që mundëson nivelin përkatës të sigurisë, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga përpunimi i paautorizuar dhe i kundërligjshëm, si dhe humbjen e rastësishme të tyre, shkatërrimin apo dëmtimin, me përdorimin e teknikave relevante apo masave organizative.

Duke patur parasysh atë se pjesa respektivisht lidhja me e dobët në sigurinë informatave është faktori njeri, një nga punët më të rëndësishme që duhet të sigurohet nga mbrojtja është që të zbatohen **teknikat përkatëse dhe masat organizative** gjatë përpunimit të të dhënave personale.

› PYETJE TË CILAT MUND TË DREJTOJNË VLERËSIMIN E MASAVE TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE:

- A është bërë identifikimi, vlerësimi dhe klasifikimi i rrezikut të proceseve me të cilat bëhet përpunimi i të dhënave personale (analiza e rrezikut)?
- A zbatohet mbrojtja teknike dhe e interguar e të dhënave personale?
- A mbahet evidencë për aktivitetet (operacionet) për përpunimin e të dhënave personale?
- A realizohen aktivitete për ngritjen e vetëdijes dhe trajnimin e të punësuarve për privatësinë dhe rreziqet e sigurisë?
- Si sigurohet siguria e përpunimit të të dhënave personale? (pseudonizimi dhe kriptimi respektivisht kodimi i të dhënave personale; sigurimi i besueshmërisë të vazhdueshme, integriteti, disponueshmëria dhe rezistenca e sistemeve të

përpunimit; aftësia për vendosjen në kohë dhe të sërishme të disponueshmërisë për të dhënat personale dhe qasja deri te ato në rast të incidentit fizik apo teknik; testimi i rregullt, vlerësimi dhe evaluimi i efektivitetit të masave teknike dhe organizative me qëllim të garantimit të sigurisë të përpunimit)

- Cila është mënyra e sigurimit të autentifikimit të personave të autorizuar në sistemin e informacionit?
- Cila është mënyra e sigurimit të kontrollit të qasjes deri te sistemi i informacionit?
- Cila është mënyra e sigurimit të evidencës për secilën qasje deri te sistemi i informacionit?
- Cila është mënyra e menaxhimit me incidente? (incidente të cilat prishin besueshmërinë, integritetin apo disponueshmërinë e të dhënave personale)
- Në çfarë pajisje kryhet përpunimi i të dhënave personale?
- Si është mbrojtur rrjeti i brendshëm i shërbimeve të sigurisë?
- Si janë siguruar serverët dhe ueb faqet e shërbimeve të zbulimit?
- Si përpunohen të dhënat personale të cilat janë të pseudoanimizuara apo të cilat janë të kriptuara?
- Cilat janë detyrimet dhe përgjegjësitë e administratorit të sistemit të informacionit dhe të personave të autorizuar gjatë përdorimit të dokumenteve dhe pajisjes të komunikimit informatik?
- Çfarë procedurash ekzistojnë për proceset e raportimit, reagimit dhe sanimit të incidenteve?
- Çfarë procedurash ekzistojnë për të bërë kopje të sigurta, arkivim dhe ruajtje, si dhe për kthimin e sërishëm të të dhënave të ruajtura personale?
- Si shkatërrohen dokumentet dhe si është mënyra e shkatërrimit, fshirjes dhe pastrimit të mediave?
- A është vendosur sistemi efektiv i evidentimit të qasjes të autorizuar (logimet), që do të përfshijë zbatimin e masave dhe kontrollave të cilat do të sigurojnë gjurmë revizore (information security audit trail) përmes evidentimit të qasjes të autorizuar (shënimet) në sistemet e informacionit në të cilat bëhet përpunimi i të dhënave personale, dhe atë: emri dhe mbiemri i personit të autorizuar, stacioni i punës prej ku qaset deri te sistemi i informacionit, data dhe koha e qasjes, të dhënat personale ndaj të cilave është qasur, lloji i qasjes me operacionet të cilat janë ndërmarrë gjatë përpunimit të të dhënave, shënim për autorizim gjatë secilës qasje, shënim për çdo qasje jo të autorizuar dhe shënim për refuzimin automatik nga sistemi i informacionit. Gjithashtu, evidenca që të përfshijë edhe shënimin e të dhënave për identifikimin e sistemit të informacionit nga i cili kryhet një përpjekje e jashtme për qasje deri te funksionet operative apo të dhënat personale pa nivelin e nevojshëm të autorizimit (Log management që siguron „input“, „edit“, „update“, „delete“ dhe „view“ log)?
- A bëhet bartja e informatave të cilat përmbajnë të dhëna personale me mbrojtje të veçantë me metoda përkatëse që do të garantojnë se të dhënat nuk do të jenë të lexueshme gjatë bartjes (në format të kriptuar apo format tjetër përkatës)?
- A bëhet qasja fizike deri te serverët, harduerët, mediat, respektivisht sistemet në të cilat kryhet përpunimi i të dhënave personale vetëm nga personat e autorizuar (siguria fizike e pajisjes në shërbimet e zbulimit)?

2.3.4.4 Drejtoria për sigurinë e informatave të klasifikuara

Drejtoria për sigurinë e informatave të klasifikuara⁶¹ është organ i pavarur i administratës shtetërore me cilësi të personit juridik që ka për qëllim zbatimin e politikës të mbrojtjes të informatave të klasifikuara. Me atë udhëheq drejtori të cilin e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat prej katër vitesh. Në lidhje me vendosjen organizative, ajo është ndarë në tre sektorë dhe atë:

- | |
|--|
| ((1) Sektori për punë të përgjithshme dhe juridike për mbështetjen e punës të drejtorit, për bashkëpunim ndërkombëtar dhe mbikqyrje inspektuese, |
| (2) Sektori për sigurinë administrative, personale dhe industriale të informatave të klasifikuara dhe |
| (3) Sektori për sigurinë informatike dhe fizike, si dhe më shumë njësi. |

Funksioni mbikqyrës i Drejtorisë për sigurinë e informatave të klasifikuara realizohet përmes kryerjes të mbikqyrjes inspektuese për të vërtetuar përmbushjen e kushteve për përdorimin e informatave të klasifikuara në organet shtetërore të administratës shtetërore, organet e jurisprudencës, organet e njësisë të vetëqeverisjes lokale, shoqëritë tregtare, ndërmarrjet publike, entet dhe shërbimet e rëndësishme për mbrojtjen, përdorimin dhe shkëmbimin ndërkombëtar të informatave të klasifikuara dhe personat tjerë juridik dhe fizik. Sipas Ligjit për ndjekjen e komunikimeve, Drejtoria është një organ mbikqyrës me detyrë që të vërtetojë ligjshmërinë në të vepruarit me informatat e klasifikuara të ATO-s dhe organet kompetente.

Mbikqyrja inspektuese realizohet përmes inspektorëve për siguri të informatave të klasifikuara të cilët janë të autorizuar që të kryejnë mbikqyrjen mbi zbatimin e ligjit dhe akteve tjera nga fusha e sigurisë të informatave të klasifikuara dhe të propozojnë masa për largimin e parregullsive të vërtetuara dhe mangësitë në afatin e caktuar. Mbikqyrja inspektuese mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme apo kontrolluese.

- Mbikqyrja e rregullt inspektuese kryhet në pajtim me programin vjetor,
- Mbikqyrja e jashtëzakonshme inspektuese kryhet në bazë të iniciativës të dorëzuar nga subjektet e caktuara apo sipas detyrës zyrtare (dyshimi i inspektorit)
- Mbikqyrja kontrolluese inspektuese kryhet pas kalimit të afatit për largimin e mangësisë të vërtetuara.

Gjatë kryerjes të mbikqyrjes inspektuese, inspektorët kanë të drejtë në qasje dhe kqyrje në çdo kohë dhe pa njoftim, në objekte, hapësira afariste, hapësira banesore dhe në hapësira në të cilat përdoren dhe ruhen informatat e klasifikuara.

Në rastet kur gjatë kryerjes të mbikqyrjes, inspektori konstaton shkelje të ligjit apo akteve tjera dhe vërteton kundërvajtje, inicohet procedura kundërvajtëse. Ndërsa nëse vërteton ekzistimin e veprës penale, menjëherë e njofton drejtorin për shkak të inicimit të procedurës para gjykatës kompetente.

2.3.4.5 Enti shtetëror për revizion

Institucioni më i rëndësishëm kur bëhet fjalë për sigurimin e llogaridhënies financiare të shërbimeve të zbulimit është Enti shtetëror për revizion (ESHR). Ky institucion i pavarur shtetëror përbëhet nga profesionistët të cilët janë të specializuar për zbulimin e parregullsive financiare.

⁶¹ Ligji për informatat e klasifikuara, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 275/2019

Raportet ndërmjet Parlamentit dhe ESHR janë të rregulluara me Ligjin për revizionin shtetëror. Drejtori dhe zëvendës-drejtori i ESHR zgjidhen nga parlamenti në periudhë prej 9 vitesh. Programi vjetor i ESHR dorëzohet në Parlament ekskluzivisht për dhënien e informatave.⁶² ESHR gjithashtu dorëzon raporte individuale për revizionet e kryera dhe raportin vjetor për punën e saj, por vetëm raporti vjetor është lëndë e diskutimit në Parlament. Raportet individuale për revizionin e kryer nga shërbimet e zbulimit ende nuk janë diskutuar me komisionet relevante.⁶³

Spektori për revizion të subjekteve nga pushteti ligjvënës, ekzekutiv, organet e administratës shtetërore dhe ndërmarrjet publike të cilat kryejnë punë publike, mbrojtja, siguria publike, gjyqësori, prokuroria publike dhe avokati i shtetit janë përgjegjës për mbikqyrje mbi shërbimet e zbulimit. Në kuadër të këtij sektori ekziston edhe njësia për revizion të Buxhetit ku bëjnë pjesë edhe subjektet nga fusha e mbrojtjes dhe siguria publike.

Në përfundimin e mandatit të tij, ESHR ka qasje deri te informatat e klasifikuara. Kjo përfshin qasjen e lirë në hapësirat zyrtare dhe në pronën e subjektit të revizionit, të drejtën e kqyrjes në libra, formularë dhe dokumentacion tjetër, të dhënat elektronike dhe sistemet e informatave, si dhe të drejtë që të kërkojnë sqarimin për të gjithë pyetjet që janë të rëndësishme për kryerjen e revizionit. Gjatë kryerjes të revizionit për fushat specifike, Enti shtetëror për revizion mund të angazhojë persona profesionist dhe ekspertë nga fusha e revizionit. Meqënëse qasja në dokumentet e shërbimeve të zbulimit është kufizuar për institucionet tjera mbikqyrëse, ESHR mund të luaj një rol të rëndësishëm në llogaridhënien e zbulimit. Prandaj, është e rëndësishme që ESHR të ketë kujdes me raportet financiare të shërbimeve të zbulimit dhe të kryejë revizione të rregullta për shpenzimet e tyre. Komunikimi i përfortuar ndërmjet komisioneve mbikqyrëse dhe ESHR, gjithashtu, do të kontribuojë për rritjen e llogaridhënies financiare përmes shkëmbimit më të mirë të informatave ndërmjet ESHR dhe komisioneve mbikqyrëse, e madje edhe planifikimin e aktiviteteve të përbashkëta.

2.3.4.6 Inspektorati shtetëror administrativ

Inspektorati shtetëror administrativ⁶⁴ është organ në përbërje të Ministrisë të shoqërisë informative dhe administratës në Republikën e Maqedonisë së Veriut në cilësi të personit juridik. Ai ka për qëllim kryerjen e mbikqyrjes mbi zbatimin e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, Ligjit për mbikqyrjen inspektuese dhe ligjet tjera që përmbajnë dispozita për procedurën administrative. Në lidhje me vendosjen organizative në kuadër të Inspektoratit shtetëror administrativ ekzistojnë: Spektori për kryerjen e mbikqyrjes inspektuese -Lindje dhe Spektori për kryerjen mbikqyrjen inspektuese - Perëndim

Mbikqyrja nga ana e Inspektoratit shtetëror administrativ i referohet vërtetimit:

- Në kohë, ekonomik dhe efikas të realizimit të të drejtave dhe interesave të qytetarëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurën administrative në zgjidhjen e punëve administrative;
- Veprimi në afatet e parapara në procedurën administrative të shkallës të parë dhe të shkallës të dytë, si dhe afatet e përcaktuara me aktet e organeve gjyqësore;
- Ekzekutimi i akteve të plotfuqishme administrative;
- Pranimi i parashtresave;

⁶² Neni 23, Ligji për revizionin shtetëror. Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 66/2010, 145/2010, 12/2014, 43/2014, 154/2015, 192/2015, 27/2016 dhe 83/2018

⁶³ ESHR ka kryer revizion në Agjencinë e zbulimit në vitin 2007

⁶⁴ Ligji për inspektimin administrativ. Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 69/2004, 22/2007, 115/2007, 51/2011, 164/2013, 41/2014, 33/2015, 156/2015, 193/2015, 53/2016 dhe 11/2018

- Mënyra e sjelljes dhe punës të nëpunësve administrativ dhe të punësuarve, me qëllim të sigurimit të respektimit të parimeve të ligjshmërisë, integritetit profesional, efikasitetit, përgjegjësisë dhe lojalitetit gjatë kryerjes të detyrave të tyre zyrtare etj.

Në kryerjen e mbikqyrjes inspektuese, inspektorët janë autorizuar që të realizojnë kqyrje të drejtëpërdrejtë në zbatimin dhe ekzekutimin e dispozitave për punën zyrtare, t'i tregojnë subjektit të mbikqyrjes për mangësitë dhe mungesat e përcaktuara në punë, dhe të urdhërojnë që në afatin e caktuar të bëhet largimi i mangësive të përcaktuara. Për mbikqyrjen e kryer inspektive, inspektori përpilon procesverbal me gjetje për gjendjen e vërtetuar, kurse largimi i mangësive të përcaktuara në punë e rregullon me vendim në të cilin janë përcaktuar afatet për kryerjen e tyre. Mbikqyrja inspektuese mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme apo kontrolluese.

Rëndësia e Inspektoratit shtetëtor administrativ në kryerjen e mbikqyrjes mbi shërbimet e zbulimit bazohet në përcaktimin e parregullsisë në punën administrative dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe mbrojtjen e interesit publik.

2.3.4.7 Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat e karakterit publik

Agjencia për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat e karakterit publik⁶⁵ është organ shtetëror i mëvetësishëm dhe i pavarur i detyruar për të qenit të hapur për publikun, të subjekteve të cilat janë titullar të informatave si dhe realizimin e të drejtës për qasje të lirë në informatat e karakterit publik të personave fizik dhe juridik.

Rëndësia e kësaj Agjencie për mbikqyrjen mbi shërbimet e zbulimit rrjedh nga kompetenca e saj që të zhvillojë procedurë administrative dhe të vendos për ankesat kundër vendimeve me të cilat titullari i informatës ka refuzuar apo ka hedhur poshtë kërkesën për qasje në informatat e kërkuarve (persona fizik dhe juridik).

2.3.4.8 Njësia qendrore për harmonizim të sistemit të kontrollit të brendshëm publik financiar

Kontrolli i brendshëm publik financiar si tërësi është element përbërës i menaxhimit nacional me financat publike. Ai paraqet një koncept gjithëpërfshirës i cili i referohet të gjithë sektorit publik, sidomos të hyrave dhe të dalave të pushtetit qendror, duke përfshirë edhe mjetet e huaja. Ai siguron se:

- Financat publike shpenzohen në mënyrë të rregullt, etike, ekonomike, efektive dhe efikase;
- Harmonizimi i punës me ligjet, aktet tjera, politikën e përcaktuar, planet dhe procedurat;
- Mbrojtja e pronës dhe resurseve tjera nga humbjet e shkaktuara nga menaxhimi i keq, harxhimi dhe përdorimi i paarsyetuar, si dhe nga parregullsitë dhe keqpërdorimet etj

Njësia qendrore për harmonizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm publik financiar⁶⁶ është pjesë e Ministrisë të financave të Republikës të Maqedonisë së Veriut që ka për qëllim koordinimin e zhvillimit, vendosjes, zbatimit dhe mbajtjes të sistemit të kontrollit të brendshëm publik financiar, që, përfshin menaxhimin dhe kontrollin financiar, revizionin e brendshëm dhe harmonizimin e tyre.

Shërbimet e zbulimit nevojitet që në mënyrë transparente, ekonomike, efikase dhe efektive të përdorin mjetet financiare nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ndërlidhshmëria e shërbimeve të zbulimit në këtë pjesë është e nevojshme që menaxhimi dhe kontrolli financiar

⁶⁵ Ligji për qasje të lirë në informatat e karakterit publik, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 101/2019

⁶⁶ Ligji për kontrollin e brendshëm publik financiar, Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 90/2009 dhe 188/2013

të realizohet në të gjithë nivelet e shërbimeve dhe të përfshijë të gjithë mjetet, duke përfshirë edhe mjetet nga Bashkimi Europian dhe nga burimet tjera.

2.3.5 Prokurori publik/Gjyqësori

Judicial control is one of the most powerful safeguards in the use of intrusive methods, therefore legislation should clearly prescribe applicable principles for ex-ante judicial approval of a measure and for ex-post judicial review, during the implementation and upon termination of the measure. These principles (such as legitimacy, proportionality, legality, necessity, subsidiarity or ultima ratio) should be binding for all state authorities involved in the initiation, authorisation and implementation of intrusive methods for information collection.

Besides the authorisation of these measures, the judiciary undertakes several other actions of relevance for intelligence oversight:

- *Vendos për akuzat për keqpërdorim, aktivitet kriminale apo qasje deri te informatat në lidhje me çështjet që lidhen me zbulimin. Ashtuqë fshehtësia nuk mund të udhëheq drejt pandëshkueshmërisë, dispozitat e veçanta gjyqësore sigurojnë zbatimin e ligjit madje edhe gjatë mbrojtjes të informatave të klasifikuara;*
- *Siguron qasje deri te mjeti juridik, në rastet kur individët ankohen për shkelje të të drejtave të tyre nga ana e shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit dhe parashtron ankesë gjatë arrestimit, marrjes në pyetje, paraburgimit apo përzierjes në privatësinë e tyre;*
- *Kryen revizion gjyqësorë, me të cilin sigurohet kompatibiliteti i të gjithë ligjeve dhe politikave në lidhje me zbulimin, të hartuara nga pushteti ligjvënës apo ekzekutiv, me kushtetutën;*
- *Në shumë vende i ndihmon mbikqyrjes parlamentare apo të pavarur, kurse anëtarët e gjyqësorit (apo anëtarët pensionist të gjyqësorit) kontribuojnë me ekspertizën e tyre në hetimet parlamentare apo komisionet për mbikqyrje apo në zbatimin e hetimeve speciale.*

Mbrojtja gjyqësore, si parim i përgjithshëm gjatë zbatimit të masave ndërhyrëse, në të kaluarën ka qënë e lënë pas dore (jo vetëm në Maqedoni, por edhe në më shumë vende) prandaj kur është kërkuar dhe është fituar leje gjyqësore për ndjekje, në praktikë ka qënë vetëm formalitet. Gjykatësi nuk ka patur, apo nuk është konsideruar përgjegjës që të kontrollojë nëse ndjekja ka qënë e arsyetuar në bazën materiale. Në vend të kësaj, gjykatësi vetëm ka kontrolluar formalitetet (psh nëse vepra penale për të cilën kërkohet ndjekja është vepër për të cilën lejohet ndjekja). Sot, kjo qasje e kufizuar deri në miratimin respektivisht lejen gjyqësore është në kundërshtim me standardet europiane kurse situata ndryshon në mënyrë të konsideruar edhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Mossuksesi i gjyqësorit në kontrollimin e përdorimit të autorizimeve speciale nga ana e shërbimeve të zbulimit nuk konsiderohet sukses për demokracinë dhe sundimin e të drejtës.

Nga vetë vendosja kushtetuese dhe kompetencat të cilat i ka prokuroria publike, rrjedhin edhe marrëdhëniet e saj me organet tjera të cilat në mënyrë aktive janë përfshirë në zbulimin, sqarimin, të dëshmuarit dhe parandalimin e kriminalitetit. Prokuroria publike kujdeset për ligjshmërinë e masave dhe veprimeve të ndërmarra në procedurën parahetimore dhe kryen mbikqyrje mbi respektimin e të drejtave të njeriut nga ana e anëtarëve të shërbimeve të zbulimit. Kontrolli të cilin e kryen prokurori publik, si organ shtetëror i jep të drejtë të kryejë mbikqyrje profesionale në punën e shërbimeve të zbulimit. Gjithashtu, aktiviteti kontrollues realizohet edhe përmes vlerësimit të kallzimit penal që përcillet deri te prokurori publik që mund të konstatojë se dëshmitë që përmbahen atje nuk janë marrë respektivisht siguruar në formë ligjore.

Gjyqësori ka një rol të rëndësishëm në propozimin, miratimin dhe realizimin e masave të posaçme hetimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Roli i tij është i dukshëm në lidhje me përgjimin e komunikimeve, siç është paraparë në Ligjin e ri për ndjekjen e komunikimeve.

Ligji siguron dy nivele të kontrollit në realizimin e përgjimeve të komunikimeve për qëllimet e hetimeve penale dhe për qëllimet e sigurisë nacionale dhe mbrojtjes⁶⁷, me prokurorin publik dhe gjykatësin që lëshon urdhërin për ndjekjen e komunikimeve⁶⁸ si trupa kontrollues për realizimin e masave për ndjekjen e komunikimeve. Kontrolli i tyre i referohet ligjshmërisë në zbatimin e masave, dhe subjektet e kontrollit janë trupat e autorizuar, operatorët dhe ATO-ja. Krahas miratimit të masave, ligjvënësja ka siguruar edhe autorizime të fuqishme për gjyqësorin: kontroll pa palajmërim të lokacioneve, pajisjes dhe dokumentacionit, qasje e drejtëpërdrejtë deri te sistemi elektronik i regjistrimit, kontrolli i përdorimit të pajisjeve speciale teknike etj.

Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut dorëzon raport deri Parlamenti i cili duhet të përmbajë informata për zbatimin e masave të posaçme hetimore. Komisioni që mbikqyr ndjekjen e komunikimeve do të shqyrtojë këtë raport si pjesë e detyrës që të kryejë mbikqyrje në efikasitetin e përgjimit të komunikimeve.

Ashtu si edhe te një numër i madh i shteteve europiane, sistemi kryesor i kontrollit mbi mbikqyrjen në Republikën e Maqedonisë së Veriut është gjyqësori, i cili mbështetet në prokurorët dhe gjykatat. Mbikqyrja parlamentare dhe civile e paraparë në kornizën e re ligjore janë paraparë si “rezerva”. Nëse prokurorët nuk veprojnë si filtër *në zbatimin e mbikqyrjes, kurse gjykatat nuk marrin seriozisht lejet dhe ndjekjen e mandateve, atëherë sistemet “rezervë” nuk do të mundën që të kompenzojnë këtë mospunë në kontroll. Në rastin më të mirë, atë që mund ta bëjnë është të zbulojnë mosfunksionimin e kontrollit gjyqësorë.*


› CILI ËSHTË DALLIMI NDËRMJET MBIQYRJES PARLAMENTARE DHE MBIQYRJES GJYQËSORE?

- Mbikqyrja parlamentare më shumë përfshin politikën, ndërsa mbikqyrja gjyqësore merret ekskluzivisht me çështjet e ngushta juridike; gjyqësori vetëm reagon në çështjet respektivisht pyetjet juridike të dorëzuara për gjykim, nuk mundet në mënyrë të pavarur të ndërmarrë iniciativë;
- Mbikqyrja parlamentare është e pakufizuar në teori. Deputetët kanë legjitimitet demokratik të kërkojnë informata dhe sqarime për cilindo aspekt të punës të agjencisë qeveritare dhe kanë të drejtë të kryejnë inspektim të hapësirave dhe vetë të kontrollojnë kapacitetet ndërhyrëse;
- Gjykatësit kanë tendencë të tregojnë lëshime më të mëdha për pushtetin ekzekutiv për çështjet e sigurisë nacionale dhe zbulimin sesa deputetët;
- Edhe pse parlamentet zakonisht kanë autorizim të vogël mbi punët operative, ata kanë autorizime të gjëra gjyqësore për përcaktimin e mandatit dhe buxhetit për shërbimet e sigurisë, që është instrument i ndikimit mbi sjelljen e tyre.

⁶⁷ Në shumë vende europiane, kërkesat për përdorimin e metodave ndërhyrëse për grumbullimin e informatave për qëllimet e Sigurisë nacionale nga ana e shërbimeve të zbulimit dorëzohen drejtëpërdrejtë deri te gjykatësi përgjegjës, pa filtër të prokurorit.

⁶⁸ Gjykatësi i procedurës paraprake që lëshon urdhërin për masën e posaçme hetimore në pajtim me ligjin për ligjshmërinë dhe gjykatësi i Gjykatës supreme së Republikës të Maqedonisë që lëshon urdhër për ndjekjen e komunikimeve, në mënyrë përkatëse. Ligji për ndjekjen e komunikimeve, neni. 57-61.

3



**AFTËSIA E KOMISIONIT PËR KRYERJEN E
MBIKQYRJES: VENDOSJA E KUSHTEVE PËR
MBIKQYRJE EFEKTIVE**

Që mbikqyrja të jetë e besueshme, duhet të mbështetet në **autorizimin gjyqësor**; te përkufizuar qartë, të parapara në Kushtetutë dhe ligje, dhe duhet të përmbush standardet demokratike të cilat mundësojnë funksionimin e sistemit të instrumenteve të kontrollit të ndërsjellë, kurse llogaridhënia të paraqesë parim themelor të qeverisjes dhe menaxhimit. Kapitulli paraprak nga këto Udhëzime ka dhënë shqyrtimin e kornizës ligjore që i jep parlamentit autorizime ligjore që të përfshihet në mbikqyrje mbi zbulimin. Institucionet dhe dispozitat ligjore të cilat mundësojnë mbikqyrje mbi zbulimin janë të vendosura. Megjithatë, autorizimet ligjore nuk janë të mjaftueshme për mbikqyrjen efektive. Parlamenti duhet të ketë **aftësinë** për të shfrytëzuar autorizimet e tij ligjore dhe t'i transformojë në aktivitete mbikqyrëse, dhe atë duhet ta bëjë në bazë rutinore. Që të ndodh kjo, komisionet mbikqyrëse duhet të ekipohen me personel, informacione, ekspertizë dhe rregulla të përkufizuara mirë për zhvillimin e mbikqyrjes. Ky kapitull do të shqyrtojë kushtet që do u mundësojnë komisioneve që në tërësi të shfrytëzojnë të drejtën e tyre ligjore dhe të përfshihen në mbikqyrjen efektive mbi zbulimin.

Mbikqyrja parlamentare është funksion i parlamentit si tërësi, megjithatë është më zhvilluar në mënyrë më efikase dhe më të dukshme në nivel të komisionit. Struktura e insitucionalizuar mirë e komisioneve të përhershme⁶⁹, që është paralele me strukturën e Qeverisë, është e një rëndësisë thelbësore për efikasitetin e parlamentit. Komisionet e fuqishme zhvillojnë një etos të pavarur, kapacitete për mendim të pavarur, të paanshëm dhe veprim. Ata janë veprimi kryesor për ndikimin parlamentar në procesin e krijimit të politikave dhe për shqyrtimin e pushtetit ekzekutiv.

Komisionet e seancës plenare tregojnë për të gjithë ligjet dhe vendimet parlamentare që duhet të ndërmerren në fushën e tyre të aktivitetit. Raportet e tyre ofrojnë pikën fillestare për të gjithë debatet për legjislacionin në seancën plenare dhe paraqesin një mjet themelor për formulimin e rekomandimeve për Qeverinë. Ata kërkojnë llogaridhënie të agjencive ekzekutuese (duke përfshirë shërbimet e zbulimit), kryesisht prej dy këndvështrimeve:

1. Administrative – testimi i politikave të tyre dhe veprimeve që të sigurohet se respektojnë sundimin e të drejtës dhe rregullat e popullsisë dhe të shmanget administrata me defekte, humbja e resurseve publike dhe korrupsioni në qeverisje;
2. Politike – përpjekje të vlerësohen zgjidhjet politike të pushtetit ekzekutiv, konsistenca e tyre me interesat nacionale dhe programi i qeverisë, zbatimi i tyre dhe pasojat.

CILAT JANË NIVELET E VEPRIMIT NË MBIKQYRJEN PARLAMENTARE?	
SEANCA PLENARE	Miratimi i politikës/strategjisë për siguri dhe politikë qeveritare Zbatimi i ligjeve Leja për përdorimin e fondeve publike (Ligji për buxhetin shtetëror) Propozime dhe vota për besim Pëlqimi për emërimet kryesore (ministra, drejtorë të zbulimit)

⁶⁹ Ad hok komisionet mund të themelohen me një mandat të veçantë dhe të ngushtë, siç janë për propozim-ligjin e caktuar apo çështjen nën hetim, të cilat përbëhen pas përfundimit të mandatit të tyre.

KOMISIONET	Raportet ligjvënëse, raportet mbikqyrëse Rekomandimet Shqyrtimet dhe komisionet anketuese Vizitat dhe inspektimet në terren Hetimi pas ankesave nga qytetarët Iniciativat dhe ndryshimet ligjvënëse
DEPUTETËT	Deklarata politike Pyetjet dhe interpelancat (në plenare, me gojë dhe me shkrim) Kërkesa për informacione (të lira apo të klasifikuara)

3.1 PROCEDURAT E KOMISIONEVE

Procedurat parlamentare (shpesh njihen si “Urdhëra të përhershme” apo “**Rregullore të punës**”) janë koleksion i rregullave, etikës dhe praktikës të cilat rregullojnë takimet dhe aktivitetet tjera të Parlamentit. Rregullorja e punës (**RRP**) miratohet nga ana e Parlamentit në seancën parlamentare, në fillim të secilit mandat ligjvënës. Qëllimi është që të lehtësojë funksionimin e pandërprerë dhe efikas në Parlament dhe të sigurojë bazën për zgjidhjen e të gjithë çështjeve që mund të rrjedhin dhe i referohen procedurës, e njëkohësisht duke marrë parasysh të drejtat e anëtarëve të tyre. Parimet e përgjithshme të procedurës parlamentare përfshijnë sundimin e shumicës me respektimin e të drejtave të pakicës.

Mandati dhe modalitetet e punës të më shumë komisioneve parlamentare shkurtimisht është përkufizuar në ligjet dhe në rregulloret e përgjithshme të Parlamentit. Kjo u jep autorizim të mjaftueshëm ligjor për realizimin e mandatit të tyre. Megjithatë, komisionet me mandat veçanërisht të ndjeshëm dhe të vështirë, siç janë komisionet për mbikqyrje mbi zbulimin, munden që detajisht të përkufizojnë mandatin e tyre dhe autorizimet për mbikqyrje me **vendim të veçantë të Parlamentit**, i cili u jep legjitimitet dhe besim më të madh derisa e kryejnë mbikqyrjen, sepse e tregon mbështetjen e të gjithë Parlamentit për mandatin e tyre.

Rregullorja për punën e Komisionit miratohet nga ana e anëtarëve të komisionit në fillim të mandatit të komisionit, me qëllim që të përkufizohet më mirë mandati i tij dhe të mundësohet funksionimi i pandërprerë në procesin e miratimit të vendimeve në kuadër të komisionit. Zakonisht, Rregullorja i referohet:

- Mandatit të komisionit – duhet të përshkruajë pyetjet dhe/ose institucionet në fushëveprimin e komisionit. Meqënëse komisioni zhvillon ekspertizën e tij dhe kuptimin e rrjeteve të zbulimit dhe aktiviteve, ka mundësi që të dëshirojë të zgjerojë apo ripërkufizojë mandatin dhe mënyrën e bashkëveprimit me institucionet e mbikqyrura.
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e kryetarit, zëvendësve dhe personelit.
- Procedura për thirrjen dhe zhvillimin e takimit të komisionit, duke përfshirë edhe kuorumin e nevojshëm (e rëndësishme për shmangien e bllokimeve nga kryetari nëse është eprori i vetëm).
- Rregullat për shqyrtimin dhe votimin – duhet të kujdesen që grupet e pakicave të mund

të shprehin qëndrimet e tyre dhe të marrin pjesë në proceset e marrjes të vendimeve.

- Mundësi për zëvendësimin e anëtarit nga kolegët tjerë në rast të mungesës të pashmangshme.

› **SI KOMISIONET PARLAMENTARE PËR MBIQYRJE ORGANIZOJNË PUNËN E TYRE?**

- Miratojnë Rregullore për punë të komisionit.
- Sqarojnë mandatin dhe prioritetet: legjislacion apo mbikqyrje; politika, buxhete apo operacione?
- Vendosin për profilin e kuadrit administrativ dhe profesional që u nevojitet; e bindin Parlamentin (Këshillin për buxhet, neni 27 nga Ligji për Kuvendin) të ndajë mjete të mjaftueshme për komisionin që të mundësohet punësimi i ekspertëve të nevojshëm (dhe për mbështetje të përhershme dhe të përkohshme apo mbështetje në lidhje me pyetjet)
- Themelojnë nën-komisionet dhe/ose caktojnë raportues që janë përkushtuar në mbikqyrje të një institucioni apo pyetjeje konkrete (siç janë zbatimi i rekomandimeve të komisionit, ligji i veçantë apo reforma). Kanë përgjegjësi që të ndjekin pyetjet përkatëse dhe rregullisht të informojnë komisionin për përparimin, të planifikojnë dhe të organizojnë aktivitetet konkrete për mbikqyrje në atë fushë, të sigurojnë komunikim të rregullt me shërbimin e mbikqyrur për atë çështje, të identifikojnë nevojat e komisionit për ekspertizë të jashtme për atë çështje.
- Identifikojnë burime të pavarura të informacioneve dhe ekspertizës, jashtë nga shërbimet e zbulimit dhe trupa mbikqyrës: akademika, organizatat (tink-tanke) nacionale dhe ndërkombëtare, organizatat e shoqërisë civile etj.
- Mendojnë se cilat mjete për mbikqyrje të shfrytëzojnë që të fitojnë kuptimin e mirë për strukturat dhe proceset e zbulimit – të kërkojnë takime informative, të ndjekin raportet e agjencive, të organizojnë vizita në terren dhe inspektime, të thërrasin personelin e zbulimit në shqyrtime, të vendosin për pyetjet dhe interpelancat e seancës plenare etj. Plan për përdorimin e mjeteve specifike të mbikqyrjes në pajtim me qëllimet konkrete të mbikqyrjes dhe prioritetet
- Vendosin për planin vjetor për aktivitete që të lehtësojnë planifikimin dhe angazhimin e ekspertëve dhe komunikimin me shërbimet e zbulimit (shihni Shtojcën Ç)
- Vendosin lidhje të mira me mediat – identifikojnë gazetarët me interes dhe njohuri për çështjet e sigurisë të cilat janë të përgatitura që të njoftojnë për aktivitetet e komisionit me profesionalitet dhe objektivitet.

3.2 TAKIMET E PËRBASHKËTA DHE AKTIVITETET MBIKQYRËSE

Parlamenti maqedonas ka vendosur një mekanizëm kompleks dhe të specializuar për mbikqyrje mbi zbulimin, të përbërë nga tre komisione parlamentare dhe një trup të mbikqyrjes civile. Përbërja, detyrat, vëllimi i punës, transparenca dhe qëllimet e këtyre trupave variojnë. Ekzistojnë përplasje ndërmjet mandateve të tyre, duke iu mundësuar shërbimeve nëse dëshirojnë të shmangin mbikqyrjen themelore. Komunikimi, bashkëpunimi i ekspertëve dhe veprimi i përbashkët ndërmjet komisioneve janë të domosdoshme për disa arsye:

- 1. Kuptimi më i mirë i zbulimit.** Sektori i zbulimit është i madh dhe i komplikuar, kurse shërbimet e zbulimit nuk veprojnë në mënyrë të izoluar. Komisionet përgjegjëse mund të bëjnë një vlerësim real të gjendjes në sektorin e zbulimit dhe çfarë efekti ka mbi mjedisin e sigurisë në tërësi. Ndarja tradicionale e punës ndërmjet agjencive të ndryshme të zbulimit mbetet sfida për shkak të kërcënimeve ndërkufitare të ditëve të sotme. Ekziston një bashkim në rritje i përgjigjeve ekzekutive për kërcënimet, bashkëpunimin intensiv ndërqeveritar dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në zbulim, vija të paqarta ndërmjet funksioneve të zbulimit dhe ndërmjet përdorimit publik dhe privat të informacioneve si pasojë e përdorimit të realizuesve. Mbikqyrja zhvillohet në mënyrë institucionale, me komisione parlamentare të cilat janë të fokusuara në sektorët konkret qeveritarë, por ajo që nevojitet sot është mbikqyrja funksionale. Me fjalë të tjera, Parlamenti duhet të zhvillojë të kuptuarin gjithëpërfshirës të proceseve dhe rrjetave të cilat përfshijnë edhe ata që zhvillojnë informatat e zbulimit në lidhje me sigurinë.
- 2. Ngjeshja e resurseve dhe ekspertizave.** Resurset (personeli, koha, buxhetet) për mbikqyrje janë gjithmonë shumë të vogla në krahasim me resurset e atyre që mbikqyren. Prandaj është e rëndësishë jetike që ata të jenë të ekuilibruara që të kenë ndikim më të madh. Ekspertiza e zhvilluar nga secili komision në fushën e tij të ekspertizës dhe përvoja e tij në zbatimin e mbikqyrjes efektive duhet të ndahet me të tjerët. Ky është një hap i vogël drejtë korrigjimit të asimetrisë ndërmjet shërbimeve të zbulimit dhe Parlamentit
- 3. Krijimi i përparësisë më të madhe politike.** Puna e komisioneve mund të ndikojë më së miri mbi pushtetin ekzekutiv dhe sektorin e zbulimit. Komisionet nuk kanë pushtet për ekzekutim, rekomandimet e tyre nuk janë juridikisht të detyrueshme për pushtetin ekzekutiv. Ata duhet të mbështeten në fuqinë e argumenteteve, në publicitet dhe mbështetje shumëpartiake që të bindin Parlamentin që të ndjek këshillat e tyre dhe pushteti ekzekutiv të respektojë rekomandimet e tyre. Kur veprojnë bashkarisht, komisionet kanë një legjitimitet të përforcuar dhe zëri i tyre i bashkuar ka një rëndësi domethënëse politike.

Për këto shkaqe, zhvillimi i bashkëpunimit dhe plotësimi i veprimit ndërmjet komisioneve të sigurisë dhe të zbulimit është i rëndësishë thelbësor për mbikqyrjen efektive. Është e drejtë dhe përgjegjësi e komisioneve që të përkufizojnë **kur** (cilat situata) dhe **si** (cilat procese) do të punojnë bashkarisht dhe do të bashkojnë forcat në mbikqyrje. Kjo mund të rregullohet në këto mënyra:

- Joformalisht dhe ad-hok, pas bisedimeve ndërmjet kryetarëve të komisioneve dhe anëtarëve, me qëllim që bashkarisht të debatojnë dhe analizojnë politikat e përgjithshme, strategjinë për legjislacion (siç janë strategjia për sigurinë nacionale, ligji për ndjekjen e komunikimeve, statusi i personelit ushtarak, statusi i zbuluesve etj) apo të hetojnë çështjet e interesit të përbashkët dhe të organizojnë shqyrtime të përbashkëta të

funkционерëve publik apo vizita të përbashkëta studimore dhe inspektime në terren.

- Formalisht, mund të parashikohet në Rregulloren e punës të secilit komision. Rregullorja për punën e secilit komision duhet të përshkruaj situatat dhe procedurat për takimet e përbashkëta, ashtuqë rregullorja vijuese në mënyrë përkatëse do të ndryshohet, pas konsultimeve ndërmjet komisioneve, me qëllim që të hartohen dispozita të tilla konvergjente. Me kalimin e kohës, pasi që takimet e përbashkëta të komisioneve bëhen një praktikë e vendosur, mund të përgatitet rregullorja për takimet e përbashkëta të komisioneve.
- Tre komisionet që kanë për detyrë mbikqyrjen mbi zbulimin dhe sigurinë, gjithashtu, duhet të zhvillojnë praktikën e takimeve me komisionet tjera, në bazën nga rasti në rast, që të diskutohet për politikën, legjislacionin dhe veprimin e përbashkët mbikqyrës.
- Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve dhe ekspertiza me Këshillin për mbikqyrje civile (shihni 2.3.4) do të duhet të shqyrtohet me kujdes, sidomos nga ana e Komisionit për mbikqyrje mbi përgjimin.

Qasja themelore në organizimin e aktiviteteve të mbikqyrjes duhet të jetë **zbatimi i qasjes holistike të bazuar në rezultate** (Komisioni i Venedikut, viti 2015). Pyetja e rëndësishme nuk është se cili lloj, apo sa trupa mbikqyrëse janë themeluar, por nëse rezultati është arritja e mbikqyrjes efektive.

3.3 EKSPTERTIZA E KOMISIONIT

Problem më i madh në mbikqyrje është asimetria e informatave dhe ekspertiza që ekziston ndërmjet Parlamentit dhe shërbimeve të sigurisë. Në pothuajse të gjithë rethanat, shërbimet e zbulimit kanë përparësi në aspekt të ekspertizës, qasjes deri te informacionet dhe lirisë të marrjes të vendimeve në lidhje me procesin e tyre, detyrat dhe resurset. Mbikqyrja është në masë të madhe e varur nga pushteti ekzekutiv dhe diponimi i shërbimeve për shkëmbimin e informatave për aktivitetin e zbulimit.

Zhvillimi i ekspertizës, të dihet se çfarët nevojitet të kërkohet dhe cilat pyetje të vendosen është parakusht për një mbikqyrje efektive. Anëtarët e komisionit dhe këshilltarët kadrovik duhet të njohin mirë legjislacionin, politikën dhe funksionet e shërbimeve maqedonase të zbulimit dhe të zbatojnë këto njohuri për të kontrolluar nëse shërbimet i kënaqin kërkesat për demokraci, të drejtat e njeriut dhe procesin e duhur juridik. Mund të ndahen disa lloje të ekspertizës, të nevojshme për mbikqyrje mbi zbulimin.

1. Ekspertiza për mbikqyrjen demokratike – të kuptuarit e mirë të rëndësisë të mbikqyrjes dhe funksionit të Parlamentit në demokraci, njohja e mjeteve për mbikqyrje, njohja e procedurave të Parlamentit dhe komisioneve. Puna e Parlamentit, procedura ligjvënëse, funksioni i komisioneve dhe roli i tyre në sistemin e instrumenteve të kontrollit reciprok të cilat mundësojnë llogaridhënien demokratike janë unike, dhe vështirë të kuptueshme për personat e jashtëm. Para se të kuptojnë karakteristikën e botës të zbulimit, anëtarët e komisioneve (sidomos deputetët e rinj) duhet të kuptojnë dhe internalizojnë parimet dhe modalitetet e mbikqyrjes, të ndërtojnë qëndrim, vullnet politik dhe guxim të nevojshëm për realizimin e mbikqyrjes ndikuese.

2. Ekspertiza juridike – njohja e qartë e kornizës strategjike dhe të gjithë ligjet dhe dispozitat relevante për mbështetjen e aktivitetit të zbulimit në Maqedoni. Kjo duhet të përfshijë ligjet dhe procedurat me të cilat rregullohet:

- Fushëveprimi dhe mandati i të gjithë shërbimeve të zbulimit;
- Të drejtat e njeriut, privatësia dhe liritë qytetare (civile) dhe kur të njëjtat mund të jenë shkelur për shkak të arsyeve nacionale të sigurisë;
- Përdorimi i autorizimeve speciale si psh rekrutimi i agjentëve apo zbatimi i ndjekjes të komunikimit;
- Mbrojtja e të dhënave, përfshirja e të gjithë ligjeve relevante dhe direktivave të BE-së.
- Ankesat e qytetarëve dhe ankesat nga të punësuarit në shërbim, duke përfshirë edhe atë mbrojtje të paraparë në personelin e zbulimit, si për shembull mbrojtja nga urdhri i kundërligjshëm apo mbrojtja e lajmëtarëve.

3. Ekspertiza operative – të kuptuarit për atë se si funksionojnë shërbimet. Pavarësisht nëse anëtarët e komisioneve kanë një përvojë paraprake në punët e zbulimit apo jo, të gjithë ata duhet të përkushtohen që të kuptojnë funksionin e zbulimit në shtetin bashkëkohor. Kjo duhet të përfshijë:

- Sferat e ndryshme të shërbimit shtetëror të zbulimit, duke marrë parasysh edhe dimensionet e shërbimeve civile, ushtarake, dhe policore dhe çështja e grumbullimit të informatave të zbulimit në vend dhe jashtë vendit;
- Format kryesore përmes të cilat grumbullohen dhe analizohen informatat, siç janë: zbulimi njerëzorë (HUMINT); përgjimi dhe zbulimi i komunikimeve (COMINT); zbulimi i burimeve të hapura (OSINT); zbulimi fotografik (IMINT); operacionet e mbuluar të mbikqyrjes; dhe operacionet informative, dhe ofanzive dhe defanzive.
- Njohja e parimeve dhe mekanizmave të bashkëpunimit me partnerët jashtë vendit;
- Të kuptuarit se cilat agjenci dhe trupa janë përgjegjës për këto aktivitete të ndryshme, cila është lidhja ndërmjet tyre; si caktohen përgjegjësitë dhe prioritetet për grumbullimin e informatave të zbulimit në kuadër të sektorit të zbulimit.

4. Ekspertiza teknologjike – të kuptuarit e çështjeve teknike dhe evulimi i tyre i shpejtë dhe më konkretisht në teknologjinë informatike dhe të komunikimit (TIK) dhe menaxhimi me të dhënat. Deputetët nuk mund të bëjnë vlerësime të sakta nëse bazohen në supozime të gabuara për atë se si funksionon teknologjia.

› **EKSPERTIZA E DISPONUESHME PËR TRUPAT MBIQYRËS NË MBRETËRINË E BASHKUAR**

Komisioni parlamentar për zbulim dhe siguri (KPZS) – i përbërë nga 9 deputetë, të zgjedhur nga lista e miratuar nga Kryeministri, me emërime të dakorduara me liderin e opozitës, duke përfshirë edhe kandidatë nga të dy dhomat e Kuvendit. Anëtarët e Komisionit në mënyrë ideale duhet të posedojnë një përvojë paraprake në punët e zbulimit, por nuk mund të jenë ministra në qeveri në përbërjen aktuale, siç është rasti me shumë sisteme parlamentare. Për mbështetjen administrative për udhëheqjen e komisioneve anketuese dhe përgatitjen e raporteve, anëtarët e KZS nga Britania e Madhe angazhojnë personelin e vazhdueshëm nga Sekretariati për sigurinë nacionale në shërbim.

Komisariati me autorizime hetuese (KAH) paraqet një amalgamë të zyrave të veçanta të komisarëve në një zyrë, me miratimin e Ligjit për autorizimet hetuese (LAH) në vitin 2016. KAH është më shumë në mbikqyrje se sa në pjesën e revizionit në sistem, me kompetencë që të mbikqyr aktivitetet ditore të zbulimit të të gjithë trupave dhe agjencive të cilat kanë autorizime hetuese (dmth autorizime për grumbullimin e të dhënave të zbulimit). Kjo përfshin grupin e gjykatësve (të quajtur komisarë gjyqësorë) të cilët sigurojnë “kontrollin e dyfishtë” të urdhërave për ndjekje, siç është rregulluar me mandatin e ri nga dispozitat e LAH nga viti 2016. Në tërësi, KAH përbëhet nga:

- **15 komisarë gjyqësorë;**
- Reth **50 personel administrativ-teknik** që ofron spektër të ekspertizës, duke përfshirë atë juridik dhe teknologjik;
- **Këshilla teknologjike këshillëdhënëse** ad hoc (TAB) që mund të thirret sipas nevojës që të komentojë fushat e caktuara të kompleksitetit teknik. Ky trup përfshin një numër të madh të personave qeveritarë, akademik dhe ekspert teknik nga industria, duke përfshirë edhe ata që punojnë në teknologjinë e informacionit dhe atë të komunikimit (TIK). Grupi nuk është i përhershëm, dhe thirret të paktën një herë në vjet, edhe më shpesh nëse ka nevojë.

Në këtë mënyrë, KAH siguron një mbikqyrje të përditshme mbi aktivitetet e zbulimit dhe ofron një ekspertizë më themelore për plotësimin e punës të deputetëve të KAH

Fitimi i njohurisë në këtë fushë është një proces i ngadalshëm, i cili kërkon përkushtim dhe këmbëngulje. Deputetët duhet të kenë pritshmëri reale dhe ambicje në proces. Konsiderohet se nevojiten vite (minimum 18-24 muaj) që të kuptohen funksionet dhe karakteristikat teknike të zbulimit, dhe kjo varet nga gatishmëria e shërbimeve për bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave. Duke patur parasysh ndryshimin e pashmangshëm të anëtarëve të komisionit për përzgjedhje, është i rëndësishëm thelbësorë që të ekzistojë zhvillimi i shërbimit të fortë profesional në Parlament. Në mungesë të personelit, mundësitë për hetim të komisionit janë të kufizuara, duke detyruar anëtarët që të mbështeten kryesisht në informacionet që siguron Qeveria dhe agjencitë e sigurimit, që janë pikërisht ato institucione, punën e të cilëve e mbikqyr komisioni.

Puna e rëndësishme e personelit parlamentar rrallëherë fiton vendin e merituar. **Personeli i komisionit** përgatit dhe organizon takime të komisionit, mban kontakte me shërbimet qeveritare, grumbullon informata dhe ndihmon që të interpretohen informacionet nga Qeveria. Anëtarët mbulojnë një spektër të gjërë të aktiviteteve, nga puna e sekretarit deri te ndihma juridike, përgatitja e ligjeve, planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve mbikqyrëse, mbajtja e evidencës, të shkruajturit e punimeve shkencore apo fjalimeve. Të punësuarit të cilët mbështesin komisionet për siguri dhe zbulim duhet të kenë qasje deri te informatat e klasifikuara, me qëllim që të kryejnë punën e tyre. E rëndësishme të veçantë është që të ekzistojë një kuadër profesional që të mundën komisionet të përmbushin përgjegjësitë e tyre. Ata sigurojnë vazhdimësi të profesionalizmit dhe kujtesës institucionale të komisioneve.

Dispozitat nga Ligji i ri për ndjekjen e komunikimeve (neni 39) tregojnë një njohje të fuqishme të nevojës për përforsimin e profesionalizmit në mbikqyrje gjatë çështjeve të komplikuara teknike, siç është përgjimi.⁷⁰ Zbatimi i këtyre dispozitave ligjore më së miri do të aftësojë komisionin përgjegjës që të përfshihet në dialogun e informuar dhe të realizojë diskutime më efikase dhe aktivitete anketuese të institucioneve të mbikqyrura. Dy pyetje praktike do të duhet të zgjidhen me zbatimin e ligjit:

⁷⁰ Neni 58 nga Ligji, gjithashtu, tregon në angazhimin e ekspertëve për mbështetje të trupave relevante gjyqësore të cilët kontrollojnë zbatimin e përgjimit.

- Si do të zgjidhen implikimet buxhetore të cilat dalin nga zbatimi i ligjit? Si Parlamenti do të financojë punësimin e ekspertizës shtesë (dy nëpunës të përhershëm për mbështetje, disa ekspertë të cilët do të angazhohen nga rasti në rast, personeli i emëruar nga institucionet tjera shtetërore) të paraparë në ligj?
- Si dy komisionet tjera (mbrojtja dhe siguria, mbikqyrja e zbulimit) dhe Këshilli për mbikqyrje civile do të rekrutojnë dhe zhvillojnë mbështetje të ekspertëve e cila u nevojitet? Ligji nuk udhëzon në mbështetje administrative dhe të ekspertëve që do të ishte e nevojshme për funksionimin e Këshillit. A do të mundën ata të thirren në ekspertizën konkrete teknike me të cilën disponon Komisioni për mbikqyrje mbi ndjekjen, nëse ka nevojë për një gjë të tillë?

› **BURIMET E AFTËSISË TË PËRFORCUAR TË KOMISIONEVE PËR MBIKQYRJE**

- Qasja deri te informatat
- Procedura të qarta dhe të hollësishme në komisione
- Shërbimi në Parlament: përdorimi i 4 cikleve të ekspertizës të brendshme
 1. Këshilltarët personal
 2. Personeli i grupit të deputetëve
 3. Anëtarët e komisionit
 4. Sektorë të specializuar (siç është qendra Parlamentare, sektori për legjislacion)
- Përdorimi i ekspertizës të jashtme: akademja, organizatat joqeveritare,
- Bashkëpunimi me trupat tjerë të cilët kryejnë mbikqyrje: Enti shtetëror për revizion, Avokati i popullit, Këshilli për mbikqyrje civile, Agjencia për mbrojtjen e të dhënave

3.4 QASJA DERI TE INFORMATAT

Numri më i madh i parlamenteve Europiane kanë qasje të privilegjuar deri te informatat e klasifikuara që të mund të mbikqyrin agjencitë e zbulimit. E drejta e parlamentit që të jetë i informuar nga ana e pushtetit ekzekutiv paraqet kushtin e parë për miratimin efektiv të ligjeve dhe kryerjen e mbikqyrjes.

Në punët e sigurisë dhe të zbulimit, qasja deri te informatat nxit sfidat në lidhje me nevojën për të bërë ekuilibrin ndërmjet imperativit dhe llogaridhënies demokratike dhe transparencën dhe nevojën për siguri dhe sekrete shtetërore. Besueshmëria e kufizon qarkullimin e informatave ndaj parlamentit dhe publikut. Megjithatë, mund të bëhet dallimi ndërmjet “nevojës për besueshmëri”, që është e kuptueshme dhe e menaxhueshme, dhe interpretimit ekstrem – “mungesa e mbikqyrjes publike” që është e papranueshme në demokraci.

› **QASJA DERI TE INFORMATAT E KLASIFIKUARA NGA ANA E TRUPAVE MBIQYRËSE ËSHTË NJË STANDARD NDËRKOMBËTAR QË ËSHTË GJËRËSISHT I PRANUAR.**

„Institucionet mbikqyrëse kanë pushtetin, resurset dhe ekspertizën për të inicuar dhe zbatuar hetimet e tyre, si dhe qasje të tërësishme të pandërprerë deri te informatat, nëpunësit dhe instalimet e nevojshme për përmbushjen e kompetencave të tyre. Institucionet mbikqyrëse fitojnë një bashkëpunim të tërësishëm të shërbimeve të zbulimit dhe organet për zbatimin e ligjit në dëgjimin e dëshmitarëve, si dhe për marrjen e dokumentacionit dhe dëshmime tjera.”⁷¹

Komisionet për mbikqyrje mbi zbulimin dhe sigurinë kanë qasje deri te informatat e klasifikuara. Rethanat dhe kushtet e kësaj qasjeje duhet të jenë të përkufizuara qartë me ligj dhe rregullore. Në përgjithësi, në vendet europiane ekzistojnë dy mënyra në të cilat mund t’u mundësohet qasje e fillë e deputetëve: (1) pa një certifikatë të sigurisë (si përjashtim nga rregullat ligjore për qasje deri te sekretet shtetërore), apo (2) pas marrjes të certifikatit të sigurisë.

(1) Në pjesën më të madhe të vendeve europiane supozohet se me përzgjedhjen dhe marrjen e mandatit parlamentar u mundësohet deputetëve qasje deri te informatat e klasifikuara, pa një kontroll të sigurisë⁷². Konsiderohet se procesi i kontrollit të sigurisë i deputetëve do të thoshte shkelje të ndarjes të degëve të pushtetit, se do të kufizojë anëtarësinë në komisionet për mbikqyrje dhe potencialisht do të sjellë deri te dëgjueshmëria ndaj pushtetit ekzekutiv. Dhënia e betimit për sekret është e domosdoshme dhe e mjaftueshme, në fillim të mandatit ligjvënës, pas përzgjedhjes në Komisionin për mbikqyrje mbi mbrojtjen, sigurinë apo zbulimin. Kjo qasje relative automatike deri te informatat e klasifikuara nuk do të thotë se deputetët janë të liruar nga sanksionet ligjore për shpalosjen e paautorizuar të informatave sekrete.

(2) Në parlamentet tjera, anëtarët e komisioneve fitojnë qasje deri te informatat e klasifikuara vetëm pas marrjes të certifikatës të sigurisë (disa shembuj janë Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Serbia, dhe Maqedonia). Certifikata e sigurisë lëshohet pasi që deputetët do të kalojnë kontrollat e sigurisë të cilat kryhen nga agjencia qeveritare (zakonisht shërbimi vendor i zbulimit apo policia). Kontrollat japin vlerësimin e rrezikut dhe i referohen lidhjes themelore, interesave apo pikave të rrezikuara të cilat mund të detyrojnë individët që të shpalosin informatat e besueshme për para, interesat politike apo afariste apo përmes kërcënimit. Proces i suksesshëm formal i kontrollit të sigurisë është mekanizim i ndërtimit të besimit. Ndërtimi i besimit në raportet ndërmjet trupave mbikqyrëse dhe agjencive të zbulimit është sidomos i nevojshëm për demokracitë e reja, ku agjencitë e zbulimit kryesisht pa vullnet shkëmbejnë informacione. I sqaron rregullat e lojës dhe i fuqizon deputetët në dialogun e tyre me funksionerët ekzekutiv.

Megjithatë, ka disa rrezeqe të cilat duhet të zbuten kur bëhet kontrolli i sigurisë të deputetëve:

- Dhënia e pushtetit për shërbimet e zbulimit që të vendosin dhe miratojnë se kush janë kontrollorët. Ekziston konflikti potencial i interesave nëse “i mbikqyruri” është gjithashtu “roja e hyrjes” të qasjes në informacionet për mbikqyrësit. Që të zbutet ky rrezik, agjencia e cila kryen kontrollin e sigurisë duhet të jap vetëm mendim, por ata nuk duhet të jenë marrësit e vendimeve për lëshimin e certifikatës të sigurisë. Vendimi përfundimtar duhet të miratohet nga Parlamenti dhe ligji duhet të sigurojë mekanizmat për të kontestuar dhe për t’u ankuar, në rastet kur refuzohet certifikata e sigurisë.

71 UN Human Rights Council, Compilation of good practices on legal and institutional frameworks and measures that ensure respect for human rights by intelligence agencies while countering terrorism, including on their oversight A/HRC/14/46 (2011), Practice 7, see: <https://fas.org/irp/eprint/unhrc.pdf>

72 Shihni shembullin me Kroacinë: <http://www.ennir.be/netherlands/intelligence-review-netherlands>

- Krijimi i dy klasave për deputetët në komisionet mbikqyrëse: atë me, dhe atë pa certifikat të sigurisë (sepse nuk kanë kaluar kontrollin, apo për shkak se kanë refuzuar të aplikojnë). Kjo mund të rrezikojë funksionimin e komisionit dhe kredibilitetin e parlamentit si trup për mbikqyrje. Që të zbutet ky rrezik, kontrolli mund të kryhet para se formalisht të formohet komisioni, që t'u jepet certifikatë të gjithë anëtarëve potencial. Vetëm deputetët të cilët do të marrin leje duhet të caktohen si anëtarë të komisionit..
- Dhënia e certifikatës të sigurisë për një person nuk do të thotë mosshpalljen e informatave të klasifikuara. Politikanët jo domosdoshmërisht kanë kulturë të fshehtësisë apo kuptimit të qartë të pasojave juridike dhe implikimeve operative nga shpallja jo e autorizuar. Megjithatë, dialogu konsistent ndërmjet parlamentit dhe shërbimeve e ndërton vetëdijen e nevojshme dhe përgjegjësinë. Në shumicën e shteteve, deputetët zakonisht nuk janë të mbrojtur me imunitet nga ndjekja penale në rast të shpalljes jo të autorizuar të informatave.

Me apo pa certifikat të sigurisë, deputetët duhet të dijnë se qasja e tërësishme deri te informatat e klasifikuara është e pamundur. Ka dy kufizime që janë të lidhura mes veti deri te qasja: mandati i komisionit dhe parimi i *shpalljes të informatave vetëm kur kjo është e nevojshme (need to know)*.

Disponueshmëria e të dhënave deri te komisioni duhet të jetë përkufizuar me **mandatin mbikqyrës**. Nevoja për informatat e atij komisioni i cili merret me çështjet e politikave dhe ligjshmërisë është e ndryshme nga ajo e komisionit që është përgjegjës për mbikqyrje mbi efikasitetin e operacioneve të zbulimit – për çfarë nevojiten më shumë informacione të hollësishme. Ky udhëzim i qartë është i rëndësishëm jo vetëm për sigurimin e informatave deri te komisionet e nevojshme për përmbushjen e mandatit të tyre, por edhe për parandalimin e përpjekjeve të deputetëve që të qasen në informata të cilat ndoshta nuk janë të lidhura me punën e tyre

Parimi shpalljes të informatave vetëm kur kjo është e nevojshme, i referohet të njëjtës pyetje: madje edhe nëse dikush i ka të gjithë autorizimet e nevojshme zyrtare dhe certifikatat e sigurisë, nuk duhet të ketë qasje deri te informatat e caktuara, *përveç nëse nuk është e nevojshme që të dijë ato informata*, nevoja që arsyetohet përmes kryerjes të detyrimeve zyrtare të atij personi. Parimi ka për qëllim që të dekurajojë “riradhitjen” e lirë të materialit të ndjeshëm apo keqpërdorimin e informatave të klasifikuara për interesat personale.

Këto kufizime të qasjes deri te informatat sërish dëshmojnë se mandati i komisionit duhet të jetë përkufizuar shumë mirë në ligj dhe në rregullore. Nëse parlamenti nuk e bën këtë, përgjegjësia (apo e drejta diskrecionale) të përkufizohet si *shpallja e informatave vetëm kur është e nevojshme* për anëtarët e komisionit parlamentar, tërësisht do të bie në pushtetin ekzekutiv. Më tutje, qasja deri te informatat nga parlamenti varet nga ajo se si ministri e interpreton ligjin, kurse parlamenti mbetet me mënyrë të kufizuar apo pa asnjë mënyrë të kontestimit të vendimit.

› SI ËSHTË RREGULLUAR QASJA NË INFORMATA PËR KOMISIONIN NË DISA VENDE?

- **Gjermania** – Paneli kontrollues parlamentar ka të drejtë të kërkojë informata, dokumente apo edhe dosje tjera me të dhëna nga qeveria federale dhe tre shërbimet e zbulimit. Në kërkesa duhet të përgjigjet menjëherë. Personeli i agjencive të zbulimit gjithashtu mund të merret në pyetje; anëtarët e Panelit kontrollues japin betim për fshehtësi (sekret), ata mundën publikisht të komentojnë për çështje të caktuara, derisa vendimin për këtë e marrin dy të tretat e anëtarëve. Paneli kontrollues mund të kërkojë ekspertë që të dorëzojnë vlerësime (Ligji për panelin kontrollues parlamentar)

- **Romania** – Komisioni për mbikqyrje mbi zbulimin (për shërbimin vendor SRI) kërkon raporte, njoftime, sqarime, dokumente, të dhëna dhe informata; ata mund të ftojnë në shqyrtim personelin ushtarak apo civil të shërbimit. SRI është i detyruar që të dorëzojë informatat e kërkuara deri te Komisioni në afat prej 7 ditëve të punës. Nëse nuk respektohet afati përfundimtar, SRI detyrohet që të sqarojë arsyet dhe të njoftojë për kohën e nevojshme për përgatitjen e informatave të kërkuara (Vendimi i Parlamentit nr. 85/2017)
- **Hungaria** – dy të tretat e Komisionit të sigurisë nacionale mund të votojnë që të kërkojnë nga pushteti ekzekutiv/agjencia që të shpalosë informacionet konkrete në lidhje me metodat e agjencisë për zbulim. (Akt CXXV / 1995)

Më së shpeshti, ligjet i përkufizojnë **përgjashtimet** nga qasja, dhe jo kategoritë e informatave të cilat shërbimi mund t'i ndajë me komisionin mbikqyrës. Kjo siguron një qasje më të madhe në informata nga ana e parlamentit, sepse të gjithë informatat të cilat nuk janë përgjashtim duhet të vendosen në dispozicion të komisionit. Përgjashtimet më të shpeshta nga qasja janë këto:

1. Informatat të cilat i referohet **informatave rrjedhëse**. Çdo zbulim i informatave të ndjeshme operative mund të rrezikojë punën dhe të rrezikojë nëpunësit të cilët e realizojnë. Megjithatë, deputetët duhet të jenë të vetëdijshëm se disa operacione mund të zgjasin me vite, janë të papërkueshme për mbikqyrjen; apo ndoshta është vështirë të përcaktohet se kur është përfunduar operacioni. Vlerësimi është i agjencisë dhe kjo e drejtë diskrecionale mund të përdoret që të fshihet pyetja e caktuar nga shikimi i komisionit. Krahës kësaj, ndonjëherë ekziston edhe fusha gri ndërmjet politikave dhe operacioneve (për shembull, skemat e synimit dhe orientimit të prioritetëve).
2. Informatat në lidhje me **burimet dhe metodat** të cilat përdoren⁷³. Identitetet dhe rolet e burimeve njerëzore janë në mes të aspekteve më të ndjeshme të punës të zbulimit. Zbulimi i identitetit të burimit mund të rrezikojë sigurinë personale, ndërsa përhapja e informatave për metodat mund të bëjë metodat joefektive, t'u jepet përparësi kundërshtarëve dhe të rrezikojnë burimet njerëzore. Megjithatë, ndonjëherë, kur komisioni ka mandat të hetojë kriminalitetin serioz të suspenduar (siç është korrupsioni apo shkelja e të drejtave të njeriut), nevojitet qasja deri te ky lloj i informatave.
3. Informatat nga **subjektet e huaja**. Kjo është si rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar të zbulimit (shkëmbimi i informatave dhe operacioneve të përbashkëta). Kufizimet janë bazuar në "rregullën e palës të tretë"⁷⁴: informatat e siguruar nga subjektet e huaja nuk mund të barten te palët e treta apo të përdoren për çfarëdo qëllimi që nuk është dakorduar paraprakisht, pa pëlqimin paraprak nga ana e subjektit nga i cili rrjedh. Ka shumë pak informata për atë se sa shpesh bëhen kërkesa të tilla dhe nëse janë të suksesshme. Ndarja e informatave ndërmjet agjencive të zbulimit është rritur eksponencialisht në dekadën e fundit, kurse bashkëpunimi ndërkombëtar është bërë një nga burimet kryesore të informatave të zbulimit.
4. Informatat për **procedurat gjyqësore apo hetimet penale** – zbatohen kufizimet me qëllim që të mbrohet e drejtat në gjykim të drejtë dhe aftësia e shtetit që të hetojë dhe ndjek kriminalitetin. Ata sigurojnë që trupat mbikqyrëse të hetojnë veprat të cilat janë lëndë e hetimeve penale apo gjyqësore derisa nuk kryhet hetimi.

⁷³ Kjo nuk është e lidhur me metodat e punës të shërbimeve të cilat janë publike dhe të njohura, por me metodat specifike të zbatuara në rastin relevant, shpalosja e tyre do të shkaktojë dëme për rastin konkret, puna e shërbimit dhe shkelja e mundshme e jetës të njeriut

⁷⁴ Ndonjëherë quhet "kontrolla e origjinatorit" - "originator control" (ORCON)

› CILI LLOJ I INFORMATAVE ËSHTË PËRJASHTIM GJATË QASJES TE ATO INFORMATA, NË LIGJE TË NDRYSHME NACIONALE?

- Operacionet vijuese apo të ardhshme të zbulimit, informatat të cilat do të mund të zbulojnë identitetin e nëpunësve të fshehur, burimeve, metodave apo mjeteve. Përfshirja nga qasja nuk zbatohet në situata kur gjykatat vërtetojnë shkeljet e lirive dhe të drejtave të njeriut (Romania)
- Dokumentet e shërbimeve të huaja apo dokumenteve të cilat do të ndikojnë në të drejtat personale të palës së tretë (Gjermania)
- Informata të cilat mund të rrezikojnë interesat nacionale apo sigurinë e personave (Austria)
- Informatat që do të mund të rrezikojnë sigurinë e Republikës (Italia)
- Informatat e ndjeshme (Britania e Madhe)
- Informatat operative-të ndjeshme (Franca)
- Informata që mund të zbulojnë identitetin e burimit apo të prish të drejtat e personave të tretë (Luksemburgu)

3.4.1 Qasja parlamentare dhe përdorimi i informatave të klasifikuara

Pa qasje deri te informatat përkatëse të klasifikuara, nuk mund të pritet që komisionet parlamentare të mbikqyrjes në pjesën e mbrojtjes, sigurisë dhe zbulimit të funksionojnë në mënyrë efektive. Por, qasja ligjore për informatat shumë të ndjeshme dhe të klasifikuara nuk duhet të rezultojë në zbulime të padëshiruara dhe të panevojshme, që mund të krijojë rreziqe për sigurinë nacionale dhe të kompromentojë zbuluesit dhe operacionet e sigurisë. Ekzistojnë arranzhime të ndryshme të cilat janë të dizajnuara të parandalojnë incidente të tilla të sigurisë.

- Qasja deri te informatat e klasifikuara rregullohet me parimin “është e nevojshme që të dihet”. Deputetët mund të kenë qasje në informata vetëm nëse kjo është rreptësisht e nevojshme për kryerjen e detyrimeve të tyre profesionale.
- Deputetët marrin certifikatë të sigurisë pasi që të kalojnë në procesin e **kontrollit të sigurisë** që përfshin kontrollimin e sigurisë dhe besueshmërisë të tyre. Mekanizmat për ankesë duhet të jenë parashikuar me ligj, në rastet kur është refuzuar certifikata e sigurisë; që këto të jenë efektive, shërbimi që bën kontrollin rezervë duhet të detyrohet të sqarojë pse nuk është dhënë certifikatë e sigurisë.
- Deputetët duhet të nënshkruajnë **marrëveshje për mosshpalljen e informatave** apo të japin betimin për fshehtësinë e fillimit të mandatit të tyre në komisionet e sigurisë dhe zbulimit.
- Zbulimi jo i autorizuar i informatave të klasifikuara mund të sjellë deri te **sanksionet** administrative dhe/ose ndëshkuese sipas ligjit, dhe nga kjo deputetët nuk janë përjashtim. Në shumicën e shteteve, deputetët nuk gëzojnë imunitet nga ndjekja në rast të zbulimit jo të autorizuar të informatave të klasifikuara.
- **Të punësuarit** të cilët mbështesin aktivitetin e komisioneve të sigurisë dhe zbulimit kontrollohen dhe fitohet certifikata e sigurisë.
- **Oficerët për siguri dhe informata të klasifikuara** emërohen në Parlament⁷⁵ (si edhe në institucionet tjera shtetërore të cilët përdorin informatat e klasifikuara) që të sigurojnë

⁷⁵ Neni 65, Ligji për informatat e klasifikuara, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 275/2019

realizimin efikas dhe të koordinuar të të drejtave dhe detyrimeve në lidhje me qasjen deri te informatat e klasifikuara dhe përdorimin e dokumenteve të klasifikuara. Ata janë përgjegjës për zbatimin e Ligjit për informatat e klasifikuara dhe marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me sigurinë e informatave të klasifikuara në institucione⁷⁶. Ata gjithashtu informojnë, udhëheqin dhe sigurojnë trajnime përkatëse për deputetët dhe të punësuarit për të gjithë masat e nevojshme për mbrojtjen e informatave të klasifikuara dhe mbrojtjen personale të përdoruesve.

Kushti kryesor për funksionimin e këtyre arranzhmaneve është sjellja profesionale e anëtarëve të parlamentit dhe të personelit për mbështetje të komisioneve.

› KONTROLLI I SIGURISË NË PARLAMENTIN MAQEDONAS

Të gjithë anëtarët e zgjedhur të parlamentit maqedonas mund të aplikojnë për lëshimin e certifikatës të sigurisë. Kjo i referohet anëtarëve të tre komisioneve të cilat kanë kompetenca për mbikqyrje mbi mbrojtjen dhe sigurinë, zbulimin dhe komunikimin; prej tyre nuk kërkohet që të aplikojnë dhe të marrin certifikat të sigurisë, por u nevojitet certifikat e sigurisë nëse dëshirojnë që të marrin pjesë në takimin e komisionit apo aktivitetet ku diskutohen dhe/ose përdoren informatat e klasifikuara.

Kontrollat i realizon ASN. Në bazë të mendimit të ASN, Drejtoria për siguri të informatave të klasifikuara merr vendimin nëse do të lëshojë certifikat të sigurisë apo nëse do të refuzojë kërkesën. Nëse refuzohet kërkesa për lëshimin e certifikatës të sigurisë, Drejtoria nuk ka detyrim ligjor që të arsyetojë shkaqet. Megjithatë, ligji parasheh mekanizmat e ankesës në rast të vendimit negativ⁷⁷.

Komisioni për mbikqyrje mbi ASN dhe AZ ka pushtet ligjor që të testojë se si kryhen kontrollat e sigurisë dhe mund të bëjë qqyrje në fakte dhe dëshmi me të cilat është vërtetuar vendimi i tillë negativ. Hetimi për mbikqyrje të kontrollave të sigurisë mundet:

- Të jetë kundërpeshë e monopolit të informatave që përdoren në kontrollin e sigurisë,
- Të parandalojë subjektivizmin e mundshëm, diskrecionin dhe keqpërdorimin,
- Të kontribuojë për një llogaridhënie të tërësishme të shërbimeve të sigurisë.

Ligji maqedonas për informatat e klasifikuara⁷⁸ siguron kornizën ligjore për klasifikimin e informatave, kushtet, kriteret dhe masat dhe aktivitetet që ndërmerren për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësinë e krijuesve dhe përdoruesve të informatave të klasifikuara, si dhe shkëmbimin nacional dhe ndërkombëtar të materialeve të klasifikuara. Kjo zgjidhje ligjore është përshtatur seriozisht sipas rregullativave europiane⁷⁹ megjithatë, më e rëndësishme është se garanton edhe nivel të lartë të pajtueshmërisë me standardet dhe parimet gjatë përdorimit të informatave të klasifikuara në Aleancën e NATO-s. Qëllimi i ligjit është sigurimi i përdorimit të ligjshëm të informatave të klasifikuara dhe pamundëson çfarëdo lloj të qasjes të kundërligjshme dhe jo të autorizuar, keqpërdorim dhe kompromitim të informatave. Detyrim për mbrojtjen e informatave të klasifikuara në pajtim me këtë ligj kanë të gjithë përdoruesit e informatave të klasifikuara që kanë patur qasje dhe/ose janë të njohur me

⁷⁶ Neni 68, Ligji për informatat e klasifikuara, Gazeta zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut nr. 275/2019

⁷⁷ Neni 57 dhe 58, Ligji për informatat e klasifikuara, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 275/2019

⁷⁸ Ligji për informatat e klasifikuara, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 275/2019

⁷⁹ Me këtë ligj kryhet harmonizimi me Vendimin e Këshillit nga 23 shtatori i vitit 2013 në lidhje me rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informatave të klasifikuara të BE, CELEX numër 32013D0488.

përmbajtjen e saj. Me klasifikimin e informatave përcaktohet shkalla e mbrojtjes të informatës që duhet të jetë përkatëse me shkallën e dëmit që do të shkaktonte për interesat nacionale me qasjen jo të autorizuar apo përdorimin jo të autorizuar të informatës.

› SHKALLËT E KLASIFIKIMIT TË INFORMATAVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT⁸⁰

- Informata e klasifikuar me shkallën **“SEKRET SHTETËROR”** është informatë, zbulimi jo i autorizuar i të cilës do të shkaktonte rrezikimin dhe shkaktimin e dëmeve të papërmirësueshme të interesave të përhershme të Republikës të Maqedonisë së Veriut.
- Informata e klasifikuar me shkallën **“RREPTËSISHT E BESUESHME”** është informatë, zbulimi jo i autorizuar i të cilës do të shkaktonte një dëm jashtëzakonisht serioz për interesat jetike të Republikës të Maqedonisë së Veriut.
- Informata e klasifikuar me shkallën **“E BESUESHME”** është informatë, zbulimi jo i autorizuar i të cilës do të shkaktonte një dëm serioz për interesat e rëndësishme të Republikës të Maqedonisë së Veriut.
- Informata e klasifikuar me shkallën **“INTERNE”** është informatë, zbulimi jo i autorizuar i të cilës do të shkaktonte dëm për punën e organeve të pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluar në pajtim me Kushtetutën e Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridik të themeluar nga Republika apo nga komunat, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit, të cilat janë të rëndësishme për sigurinë publike, mbrojtjen, punët e jashtme dhe aktivitetet e sigurisë dhe zbulimit në shtet.

Qasja deri te informatat ka edhe rreziqet e saj. Shërbimet mund të përdorin informatat e klasifikuara në përpjekje për të joshur apo për të ndikuar mbi politikanët, duke iu treguar informata selektive. Informatat e klasifikuara, gjithashtu, mund të përdoren si një instrument efikas për të heshtur parlamentin, sepse pasiqë të fitohen informatat e besueshme për një pyetje të caktuar, nuk do të mund t'i diskutojnë publikisht.

Komisionet parlamentare duhet të përkushtohen që të fitojnë informatat që përputhen me përgjegjësitë e tyre mbikqyrëse. Kjo do të thotë se ata duhet të hetojnë edhe më thellë se “gjurma në letër” dhe nga krahasimi i të dhënave statistikore të cilat i japin shërbimet e ndryshme dhe të zhvillojnë aftësi të mjaftueshme për zbulimin e fakteve për një testim efikas të punës dhe evidencës në pronësi të shërbimeve të zbulimit.

› SI MUND TË PËRMIRËSOHET QASJA NË INFORMATAT?

- Të miratohen rregulla dhe procedura të qarta për qasje, shqyrtim, magazinim dhe shpërndarje të informatave të klasifikuara, duke përfshirë edhe rregullat e brendshme të komisionit për atë se çfarë mund të njoftohet (1) në parlament dhe (2) në publik.
- Të miratohen procedura të qarta për marrjen dhe mbajtjen e certifikatës të sigurisë, edhe për deputetët edhe për personelin e komisionit.
- Të sigurohen hapësira të veçanta dhe kapacitete për përdorimin/leximin/

⁸⁰ Neni 9, Ligji për informatat e klasifikuara, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 275/2019

diskutimin e informatave të ndjeshme (siç është dhoma mbrojtëse për mbajtjen e takimeve private të komisioneve).

- Të angazhohet personeli i kualifikuar përgjegjës për përdorimin e dokumenteve të klasifikuara (dhe organizimin e trajnimeve të shpeshta për to).
- Të organizohen takime të mbyllura për temat e ndjeshme, të cilat nuk do të jenë të hapura për publikun, as edhe për deputetët të cilët nuk janë anëtarë të komisionit mbikqyrës.
- Të lidhet çdo kërkim i informatave me mandatin mbikqyrës të komisionit (të bëhet udhëzimi i saktë deri te nenet e kushtetutës, ligjeve, rregullores)
- Të parandalohet klasifikimi i tepërt, përmes ligjeve të cilat në mënyrë të qartë dhe restriktive i përkufizojnë llojet e informatave të cilat mund të klasifikohen edhe përmes shërbimit të pavarur për mbikqyrje të sistemit të klasifikimit.
- Të vendoset kusht i ri për shërbimet e zbulimit dhe qeveritë që në mënyrë proaktive të shpalosin lloje të caktuara të informatave deri te komisioni, pa u kërkuar prej tyre një gjë e tillë.

3.4.2 Qasja në ndarjen dhe shkëmbimin e informatave

Shërbimet e zbulimit kanë nevojë të dukshme që të ndajnë informata⁸¹ me partnerët vendas dhe të huaj. Duke patur parasysh atë se kërcënimet momentale të sigurisë kanë natyrë transnacionale, shërbimi që thjeshtë grumbullon informata pa i ndarë, nuk përmbush detyrimin e tij që të paralajmërojë të tjerët për kërcënimet e sigurisë të cilat i zbulon.

Ndarja dhe shkëmbimi i informatave, si dhe bashkëpunimi me shërbimet e jashtme është një ndër fushat më të ndjeshme dhe më të fshehta në punën e shërbimeve të zbulimit. Prandaj, është e kuptueshme se shërbimet me kujdes i ruajnë informatat të cilat i referohen atyre apo rrjedhin nga ato marrëdhënie. Dëmi i mundshëm respektivisht potencial që mund të shkaktohet nga zbulimi jo i autorizuar apo jo i qëllimshëm i informatave nga partneri i huaj, nuk duhet të hidhet poshtë lehtësisht. Krahës implikimeve të dukshme për privatësinë dhe sigurinë personale për shkak të zbulimit të llojit të caktuar të informatave, ekziston edhe dëmtimi i besimit të shërbimeve të huaja që mund të sjellë deri te tërheqja e bashkëpunimit dhe përfitimet të cilat i sjell. Sipas kësaj, është thelbësore që trupat mbikqyrëse të miratojnë procedura përkatëse të sigurisë dhe të veprojnë me profesionalizmin më të madh gjatë përdorimit të informatave të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet apo të cilat i referohen marrëdhënieve me partnerët e huaj.⁸²

Edhe pse ekziston një pajtueshmëri e gjërë se ndarja dhe shkëmbimi i informatave është e nevojshme për një siguri më të madhe, zgjerimi i fundit i shkëmbimit të informatave ndërmjet shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit në shtet, si dhe jashtë kufijve, ka ngritur një numër të madh të problemeve të mundshme dhe rreziqeve të cilat kërkojnë menaxhimin e përkushtuar dhe mbikqyrjen. Këto janë disa shembuj:

- Shërbimet për zbatimin e ligjit mund të ndërmarrin aktivitetet operative në bazë të informatave të ndara që nuk janë kontrolluar, që mund të sjellë deri te ndarja e dobët e resurseve të kufizuara dhe një mospërvojë operative,

⁸¹ Hans Born, Aidan Wills (2012): *Overseeing Intelligence Services, A Toolkit*, The Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF), Geneva, 129-147.

⁸² Hans Born, Ian Leigh, Aidan Wills (2015): *Making International Intelligence Cooperation Accountable*, Norwegian Parliamentary Oversight Committee, DCAF Centre for Security, Development and the Rule of Law, Geneva, 151.

- Informatat e ndara mund të zbulohen në procedurat e mëtutjeshme juridike,
- Shpërndarja e informatave të grumbulluara në mënyrë jo të sigurtë dhe/ose jo të rregullt mund të sjellë deri te dëmtimi i kredibilitetit dhe imazhit të shërbimit,
- Individët janë gjithashtu të ekspozuar në rrezik më të madh të shkeljes të të drejtave të tyre, sidomos të drejtën e tyre të privatësisë. Ata nuk mund të kontestojnë saktësinë e informatave të ndara sepse shpeshherë ata nuk janë të vetëdijshëm se informatat për to janë ndarë përgjatë shërbimeve dhe me shtetet,
- Rreziqet e organeve të mbikqyrjes përfshijnë kufizimet e reja kryesore të mundësive të tyre që të kuptojnë se cilat informata ndahen dhe si zhvillohet ky shkëmbim.

Si përfundim, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave të zbulimit u bën aq të rëndësishme sot, saqë pa informata për ato, komisionet mbikqyrëse parlamentare kanë një shikim jo të plotë të aktiviteteve në të cilat janë përfshirë shërbimet e tyre. Marrja e më shumë informatave për bashkëpunimin ndërkombëtarë (apo madje edhe përjashtimi nga rregulla e palëve të treta) është përpjekje e shumë trupave mbikqyrëse në Europë.

► REKOMANDIMET PËR ZBUTJEN E PENGESAVE PËR QASJE NË SHKËMBIMIN E INFORMATAVE⁸³

- Trupat mbikqyrëse mund të identifikojnë aspektet më të rëndësishme të bashkëpunimit ndërmjet shërbimeve nacionale të zbulimit dhe partnerëve të huaj.
- Duhet të ketë të paktën një trup të huaj mbikqyrës që ka qasje të tërësishme në informatat që posedojnë shërbimet e zbulimit, duke përfshirë edhe informatat nga bashkëpunimi ndërkombëtarë i zbulimit, apo të cilat i referohen bashkëpunimit ndërkombëtarë të zbulimit, për të cilat konsideron se janë relevante për përmbushjen e kompetencës të tij.
- Rregulli i palës të tretë (apo parimi kontrollues) nuk duhet të lejojë që të tejkalohen dispozitat ligjore me të cilat u mundësohet shërbimeve mbikqyrëse qasje në informatat e nevojshme për përmbushjen e kompetencave të tyre. Deputetët duhet të shqyrtojnë opsionin që legjislacioni të jetë ekspllicit në lidhje me atë se qasja në informatat e trupave mbikqyrëse nuk është e kufizuar apo i nënshtrohet rregullës të palës të tretë.
- Duhet të mendohet dhe të kërkohet nga shërbimet e zbulimit që në marrëveshjet e tyre me partnerët e huaj të përfshijnë klauzolën në të cilën thuhet se bashkëpunimi mundet të jetë objekt i mbikqyrjes nga ana e trupit të caktuar mbikqyrës.
- Legjislacioni duhet t'u mundësojë trupave mbikqyrëse që të angazhojnë ekspertë teknik (të kontrolluar në aspekt të sigurisë), që t'u ndihmojnë në të kuptuarit dhe vlerësimin e çështjeve të zbulimit, duke përfshirë edhe bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave me partnerët e huaj; resurset shtesë duhet t'u shpërndahen pushteteve mbikqyrëse

Krahas promovimit të transparencës më të madhe nga ana e shërbimeve, trupat mbikqyrëse duhet të insistojnë që të shpallin informata për punën e tyre në mbikqyrjen e bashkëpunimit

⁸³ Hans Born, Ian Leigh, Aidan Wills (2015): Making International Intelligence Cooperation Accountable, Norwegian Parliamentary Oversight Committee, DCAF Centre for Security, Development and the Rule of Law, Geneva, 152-155.

ndërkombëtarë ndërmjet shërbimeve të zbulimit. Shpallja e informatave të tilla është e rëndësishme për edukimin e qytetarëve për atë se si është rregulluar bashkëpunimi ndërkombëtarë i zbulimit, si dhe t'i tregohet qytetarëve se po shqyrtohen marrëdhëniet e shërbimeve të zbulimit me partnerët e huaj. Në vendet në të cilat aspektet e bashkëpunimit ndërkombëtar të zbulimit kanë shkaktuar pretendime për një vepër serioze, ky rol i trupave mbikqyrës bëhet edhe më i rëndësishëm. Gjatë përgatitjes të raporteve për hetimet tematike apo hetimet për rastet specifike/incidentet e lidhura me bashkëpunimin ndërkombëtarë të zbulimit, trupat mbikqyrëse duhet të përpiqen që të zhvillojnë një verzion të qartë të raportit, me ruajtjen e fshehtësisë të verzionit më të gjërë që përmban gjetje të klasifikuara dhe rekomandime.⁸⁴

3.4.3 Përdorimi, menaxhimi dhe ruajtja e të dhënave personale

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë informatike në mënyrë dramatike ka rritur kapacitetin e shërbimeve shtetërore që të grumbullojnë të dhënat personale. Kjo ka krijuar sfidën e rëndësishme: si të mbrohen subjektet e të dhënave personale⁸⁵, dhe minimizimin e rreziqeve nga qasja e rastësishme apo e kundërligjshme, shkatërrimi, humbja, ndryshimi i të dhënave të tyre personale. Shërbimet e zbulimit duhet të zbatojnë teknikat specifike dhe masat organizative me qëllim që të sigurojnë (dhe gjithashtu të dëshmojnë gjatë kohës të mbikqyrjes) se përpunimi i të dhënave personale realizohet në pajtim me ligjin, se sasia e tyre, apo vëllimi mbahet në nivelet minimale dhe janë masa mbrojtëse nga shkeljet dhe keqpërdorimet e inkorporuara në proces. Ruajtja e të dhënave personale duhet të sigurohet sipas dizajnit dhe në mënyrë standarde në kuadër të procesit të përpunimit.

Teknikat dhe masat organizative për përpunimin e të dhënave personale në veçanti (por duke mos u kufizuar vetëm te ato) duhet të përfshijë:

- Zbatimin e pseudonimizimit dhe kriptimitin e të dhënave personale;
- Sigurimin e besueshmërisë të vazhdueshme, kontrolli i qasjes, integriteti, disponueshmëria dhe rezistenca e sistemit të përpunimit;
- Aftësia për vendosjen në kohë, dhe të sërishme të disponueshmërisë të të dhënave personale dhe qasja deri te ato në rast të incidentit fizik apo teknik;
- Procesi i testimit të rregullt, vlerësimit dhe evaluimit të efektivitetit të teknikave dhe masave organizative me qëllim që të garantojë sigurinë e përpunimit të të dhënave personale.

Përvojat e vendeve të ndryshme tregojnë se lidhja më e dobët në sigurinë e informatave e cila i referohet përpunimit të të dhënave personale është aspekti njerëzorë. Që të zbuten rreziqet, shërbimet e zbulimit duhet të kufizojnë numrin e të punësuarve të cilët kanë qasje në të dhënat personale dhe personat e trajnuar në mënyrë përkatëse për këtë.

Siguria e informatave dhe siguria e të dhënave personale përbëhet nga pesë elemente dhe atë: besueshmëria (confidentiality), integriteti apo saktësia (integrity), disponueshmëria (availability), autenticiteti (authenticity) dhe parevokueshmëria (non repudiation).

- **Besueshmëria** nënkupton se qasje në informatat të cilat përmbajnë të dhëna personale mund të kenë vetëm personat të cilët kanë autorizim për këtë nga ana e kontrollorit (në

⁸⁴ Hans Born, Ian Leigh, Aidan Wills (2015): Making International Intelligence Cooperation Accountable, Norwegian Parliamentary Oversight Committee, DCAF Centre for Security, Development and the Rule of Law, Geneva, 156.

⁸⁵ Subjekti i të dhënave personale është personi fizik i identifikuar apo personi fizik që mund të identifikohet përmes informatës të caktuar, kurse personi fizik që mund të identifikohet është personi, identiteti i të cilit mund të përcaktohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo jo të drejtëpërdrejtë, sidomos në bazë të identifikatorit siç është emri dhe mbiemri, numri amë i qytetarit, të dhënat për lokacionin, identifikatori përmes internetit, apo në bazë të një apo më shumë shenjave specifike për identitetin e tij fizik, fiziologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor apo social të atij personi.

rastin konkret shërbimet e zbulimit). Ndërkohë, autorizimi lëshohet nga ana e personit përgjegjës te kontrollori, sipas parimit “nevojitet që ta dijë” (need to know). Njëkohësisht, që të sigurohet ndarja e tërësishme dhe e qartë e detyrimeve dhe përgjegjësiëve duhet të mbahet evidencë për personat të cilët janë të autorizuar për kryerjen e përpunimit të informatave që në vete përmbajnë të dhëna personale.

- **Integriteti** apo saktësia nënkupton se informatat të cilat përmbajnë të dhëna personale, kurse me të cilat disponojnë shërbimet e sigurisë – zbulimit, janë të sakta, të tërësishme dhe të përditësuar
- **Disponueshmëria** nënkupton se sistemet dhe pajisjet në të cilat kryhet përpunimi i të dhënave personale duhet të dizajnohen në mënyrë të tillë, që kur do të duhet, të njëjtat do të mund të kryejnë funksionin e tyre për të cilin janë furnizuar apo dizajnuar.
- **Autenticiteti** i sigurisë të informatave është masë e cila siguron se vetëm personat e autorizuar mund të paraqiten dhe të qasen në sistemet të cilat përmbajnë informata me të dhëna personale. Përmes këtij elementi të sigurisë të informatave mundësohen supozimet përkatëse për vendosjen e ndarjes të qartë të detyrimeve dhe përgjegjësiëve në kuadër të shërbimeve të zbulimit që mundëson vendosjen e gjurmës revizore të informatës përmes evidentimit të çdo qasjeje dhe vendosjen e shënimeve (log management system).
- **Parevokueshmëria** e sigurisë të informatave arrihet në procesin e certifikimit digjital. Përmes këtij elementi sigurohet niveli më i lartë i sigurisë të informatave. Te ky element i sigurisë të informatave kryhet kriptimi i informatave me ndihmën e mjeteve të enkriptimit të veçantë dhe në të njëjtën kohë komunikimi që realizohet përmes internetit, në mënyrë digjitale nënshkruhet nga ana e dërguesit të informatës.

› FUNKSIONET E SIGURISË TË INFORMATAVE NË PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Parandalimi i sigurisë të informatave në vete përfshin aktivitetet të cilat shërbimet e zbulimit duhet të ndërmarrin paraprakisht, respektivisht para vendosjes të proceseve të caktuara, apo sistemeve me të cilat, respektivisht në të cilat do të kryhet përpunimi i të dhënave personale. Në ndërkohë ky element përfshin të paktën:


- Miratimin dhe zbatimin e dokumentacionit me përshkrimin e masave teknike dhe organizative të sigurisë të fshehtësisë (sekretit) dhe mbrojtjes respektivisht ruajtjes të përpunimit të të dhënave personale;
- Përshkrimi i kategorive të subjekteve të të dhënave personale dhe kategorive të të dhënave personale;
- Sjellja e autorizimeve për personat të cilët kryejnë përpunimin e të dhënave personale;
- Vendosja dhe mbajtja e evidencës për personat e autorizuar për kryerjen e përpunimit të të dhënave personale;
- Afatet për fshirjen e kategorive të ndryshme të të dhënave personale; dhe
- Përcaktimi i oficerit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Mirëmbajtja: si elementi i dytë i sigurisë të informatave në vete përfshin aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren pasiqë tashmë janë ndërmarrë elementet e parandalimit dhe si mbështetje e masave të parandalimit, kurse në vete përfshijnë:

- Përditësimin vijues të dokumentacionit me përshkrim të teknikave dhe masave organizative për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale;
- Përditësimi në lidhje me zbatimin e masave teknike dhe organizative;
- Kontrollat periodike nga ana e oficerit për mbrojtje të të dhënave personale, për shkak të ndjekjes të harmonizimit të punës me rregullat për ruajtjen e të dhënave personale;
- Mbajtja e trajnimeve të të punësuarve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale;
- Testimi i sistemit të informatave pas ndryshimeve të kryera me qëllim të kontrollimit nëse sistemi siguron fshehtësi dhe mbrojtje të përpunimit të të dhënave personale; dhe
- Kontrolli i brendshëm i sistemit të informatave dhe infrastruktura e informatave.

Reagimi si elementi i tretë i sigurisë të informatave në vete përfshin aktivitetet të cilat duhet të ndërmerren në rast të incidentit të sigurisë si anomali e cila ndikon apo mund të ndikojë në fshehtësinë dhe ruajtjen e të dhënave personale, respektivisht që mund të kompromentojë informatatat të cilat përmbajnë të dhënat personale, kurse në vete përfshin:

- Paraqitjen, raportimin dhe sanimin e incidentit;
- Evidentimin e incidentit dhe masat që janë ndërmarrë për sanimin e tij; dhe
- Masat të cilat janë ndërmarrë për mos përsëritjen e incidentit.



KOMISIONI NË VEPRIM: MJETET PËR MBIKQYRJE

Mjetet për mbikqyrje që janë të disponueshme për komisionet parlamentare janë të shumëllojshme, por baza qëndron në **autorizimin ligjor të parlamentit që të marr informacione** nga pushteti ekzekutiv dhe, rrjedhmisht, të kërkojë dokumente dhe raporte apo të ftojë funksionerë ekzekutiv në takime të komisioneve dhe të kërkojë prej tyre që të zbulojnë, sqarojnë dhe arsyetojnë veprimet e tyre.

Aktivitetet për mbikqyrje të komisioneve janë të pavarura nga seanca plenare apo nga orari ligjvënës. Komisionet e bëjnë programin e tyre dhe agjendën mbikqyrëse, vendosin se cilin do të ftojnë në shqyrtime (seanca) apo në takime të komisioneve, të cilat mund të jenë të hapura apo të mbyllura për publikun, në varësi nga vendimi i anëtarëve.

Ekzistojnë dy **strategji të ndryshme për mbikqyrje**, por megjithatë plotësuese:

PROAKTIVE:

kur komisionet realizojnë aktivitete të quajtuara **“patrullime policore”**, të cilat janë të rregullta dhe të planifikuara (gjatë kohës dhe bashkarisht me agjencinë e mbikqyrjes). Takimet janë të rregullta dhe diskutohet për legjislacionin apo politikën e fundit zhvillimore, raportet për aktivitetet e rregullta dorëzohen deri te komisioni, vizitat në terren kryhen në selinë apo në hapësirat rajonale dhe zyrat etj. Shpesh bazohet në planin vjetor të punës të komisionit, që është shpërndarë deri te institucionet e sigurisë dhe partnerët e interesuar. Plani vjetor i punës ndërton besimin dhe ofron transparencën në lidhje me pushtetin ekzekutiv dhe publikun. Gjithashtu siguron stabilitet dhe u jep mundësinë anëtarëve të komisionit që të planifikojnë aktivitetet e tyre për vitin që vijon.

REAKTIVE:

Kur komisionet veprojnë vetëm pas sinjalit të **“alarmit të zjarrit”**, dhe organizojnë diskutime dhe aktivitete anketuese që të shqyrtojnë veprat e shënuara në debatet parlamentare, mediat dhe kundërshtimet e pranura. Komisionet kanë autorizim që të ftojnë ministra, nëpunës ushtarak apo shtetëror, drejtorë të agjencisë apo ekspertë të pavarur, me qëllim që të përgjigjen në pyetjet e komisionit apo madje të dëshmojnë nën betim:



Që të arrihen rezultate të mira, është e rëndësishme që komisioni të kuptojë dhe të planifikojë mbikqyrjen si proces dhe jo si aktivitete të pavarura, të izoluara. Mjetet e ndryshme të mbikqyrjes janë përshtatur më së miri në fazat e ndryshme të procesit të mbikqyrjes.

1. Marrja e informatave për të kuptuarit e mirë të sektorit të zbulimit arrihet përmes raporteve, shqyrtimeve konsultative, vizitave në terren.
2. Shqyrtime mbikqyrëse, vizitat në terren, aktivitetet anketuese u mundësojnë anëtarëve të komisionit që të zhvillojnë sigurinë e tyre në pyetjet e sigurisë dhe të përfshihen në dialogun e informuar me funksionerët ekzekutiv, të kërkojnë sqarime dhe detaje konkrete dhe të zhvillojnë kapacitetet për analizë të pavarur.
3. Pas përfitimit të informatave dhe ekspertizës, komisioni është pajisur më së miri që të vlerësojë punën e sektorit të sigurisë, të identifikojë dobësitë dhe të formulojë zgjidhje në formë të ligjeve, ndryshimeve të ligjeve apo rekomandime për institucionet e sektorit të sigurisë.

4.1 RAPORTET

Raportet janë një nga mjetet më të fuqishme dhe më së shpeshti të përdorura për mbikqyrje. Sipas parimeve të sundimit të së drejtës dhe ndarjes të pushtetit, në një shtet demokratik të gjithë institucionet qeveritare janë të detyruara që të njoftojnë parlamentin dhe publikun e gjërë⁸⁶. Ky është parakusht për llogaridhënien demokratike. Raportet u mundësojnë trupave parlamentare dhe trupave tjera mbikqyrëse që të analizojnë nëse respektohet politika qeveritare dhe korniza ligjore, dhe nëse vlerësohen mjetet e investuara të obliguesve tatimorë. Shërbimet e zbulimit nuk janë të përjashtuara nga kjo praktikë.⁸⁷

Në thelb, ekzistojnë dy kategori të raporteve: raportet e rregullta për aktivitetet të cilat shërbimet në mënyrë proaktive i dorëzojnë deri te komisioni/parlamenti, dhe raportet e veçanta për pyetjet e caktuara, të cilat përgatiten me kërkesë të parlamentit.

Raportet e rregullta⁸⁸ për aktivitetet e shërbimeve të zbulimit janë lloji më i shpeshtë i njoftimit. Ekzistojnë shumë shembuj të shërbimeve të zbulimit të cilat rregullisht, më së shpeshti në nivel vjetor, publikojnë raporte⁸⁹ për aktivitetet të cilat kanë informata gjithëpërfshirëse dhe të dobishme për mbikqyrjen, pa rrezikuar në të njëjtën kohë sigurinë nacionale. Ndojnëherë, përmbajtja e cila është publikisht e disponueshme, nuk duhet të përmbajë të gjithë informatat që në fillim janë dorëzuar deri te parlamenti, disa informata largohen nga versioni që plasohet në publik.

Raportet e rregullta për aktivitetet mundën në masë të madhe të variojnë në lidhje me gjatësinë dhe përmbajtjen në varësi nga praktika lokale dhe përkufizimi juridik për kompetencat e organit mbikqyrës deri te i cili dërgohet raporti. Edhe krahas të gjithë dallimeve, raportet në përgjithësi e ndjekin logjikën e ngjajshme dhe përmbajnë informata të ngjajshme në tre fusha të gjëra: dispozita për vetë agjencinë e zbulimit dhe punën e saj, për kërcënimet për sigurinë nacionale dhe globale dhe dispozita (thelbësore dhe financiare) për mbikqyrjen.

⁸⁶ Britania e madhe është përjashtim sepse sipas ligjit shërbimet kryesore MI5 dhe MI6 përgatisin raportin vjetor për kryeministrin dhe ministrin e punëve të brendshme, por ata nuk publikohen për arsye të sigurisë dhe asnjë version nuk është i disponueshëm për publikun. Megjithatë, komisarët e pavarur për mbikëqyrje dhe Komiteti i zbulimit dhe sigurisë publikojnë raportet e tyre për punën e shërbimeve të sigurisë.

⁸⁷ Hans Born, Aidan Wills(2012): Mbikqyrja mbi shërbimet e zbulimit: Doracak, fq. 57 https://dcaf.ch/sites/default/files/publications/documents/Born_Wills_Intelligence_oversight_TK_EN_O.pdf

⁸⁸ Nëpunës i lartë për mbikëqyrjen e zbulimit pranë Ministrisë të mbrojtjes të SHBA-së raporton si person i zgjedhur për kontakt në sektorin e mbrojtjes deri te trupi mbikqyrës në bazë kuartale (tre mujore)

⁸⁹ Shihni linqet deri te raportet e fundit të shërbimeve kryesore të zbulimit të Australisë, Kanadës, Kroacisë, Çekisë dhe Hollandës: Raporti vjetor i ASIO 2019-20: <https://www.asio.gov.au/asio-report-parliament.html>; Raporti publik CSIS 2019: <https://www.canada.ca/en/security-intelligence-service/corporate/publications/2019-public-report.html>; Agjencia për siguri dhe zbulim 2019: <https://www.soa.hr/hr/dokumenti/javni-dokumenti-soa-e/>; Shërbimi i sigurisë – informativ 2018 <https://www.bis.cz/annual-reports/>; Raporti vjetor i AIVD 2019: <https://english.aivd.nl/publications/annual-report/2020/09/03/aivd-annual-report-2019>

- Gjatësia mund të variojë nga 20 deri në 30 faqe (në Hollandë, Çeki apo Kroaci) deri te një raport shumë i detajuar themelor (Raporti vjetor australian ASIO 2019-20: 160 faqe).
- Përmbajtja⁹⁰ mund të përfshijë, pa zbuluar detajet e ndjeshme: qëllimet vjetore dhe prioritetet e shërbimit; vlerësimin e shërbimit për kërcënimet kryesore të sigurisë; reformat e caktuara të mëdha në politikat e zbulimit, sistemet dhe operacionet; përmbushjen e funksioneve të raportimit dhe llogaridhënies në shërbim; si dhe përgjigjen e shërbimit për kërkesat për informata sipas legjislacionit për lirinë e informatave.

Raportet e veçanta plotësojnë raportet e përgjithshme vjetore, dhe ata zakonisht kërkohen nga trupi mbikqyrës, për temat/pyetjet e caktuara të identifikuara si problematike apo të interesit të veçantë. Baza e kërkesave të tilla të veçanta për raportet mund të rrjedh nga dispozitat ligjore apo nga shqyrtimet dhe anketat e synuara të organeve mbikqyrëse. Raportet e veçanta i përgatit shërbimi i zbulimit apo bazohen në hetimin e kryer nga ana e personelit juridik apo hetues në dosjet e shërbimit, me mandat për mbikqyrje të dhënë nga ana e trupit/komisionit mbikqyrës.

Raportet e veçanta kërkojnë nga komisioni që të parashtrojë pyetje të sakta dhe pyetje të drejtuara drejtë qëllimit të caktuar. Raportimi duhet të jetë mjaftë shterues që të jap përgjigje në pyetjen e parashtuar në raport, por jo edhe i tepruar, që të shmanget sasia shumë e madhe e informacioneve të parëndësishme. Në atë kuptim, shumë informata mund të paraqesin gjithashtu një hendikep si edhe shumë pak informata për realizimin e mbikqyrjes efektive.

› ÇFARË LLOJ TË RAPORTEVE TË VEÇANTA MUND TË FITOJNË KOMISONET PËR MBIKQYRJE MBI ZBULIMIN?

Në bazë të kërkesave ligjore:

- Ligji për mbikqyrjen parlamentare sllovene mbi shërbimet e zbulimit dhe sigurisë (neni 19) parasheh se në çdo katër muaj dhe në mënyrë plotësuese nëse është e nevojshme, shërbimi do të dorëzojë raport deri te komisioni parlamentar për zbatimin e masave ndërhyrëse (si për sigurinë nacionale ashtu edhe për hetimet penale). Raportet do të përfshijnë rastet për të cilat janë urdhëruar masat, numrin e personave kundër të cilëve janë urdhëruar, dhe masat e zbatuara, numri i propozimeve të refuzuara, baza juridike për miratimin e masave në rastet individuale, numri dhe lloji i mjeteve të komunikimit të cilat kontrollohen në rastet individuale, periudha kohore për të cilën janë urdhëruar masat individuale, të dhënat për parregullsitë e vërtetuara në zbatimin e masave në rastet individuale. Raportet, gjithashtu, do të përmbajnë të dhëna për masat të cilat ende nuk janë përfunduar dhe janë në rrjedhë e sipër. Komisioni mund të kërkojë një raport të detajuar për masat konkrete.
- Neni 195 nga Kodi penal në Kanadë, si masë të llogaridhënies, kërkon nga ministri për sigurinë publike dhe gatishmërinë në rastet urgjente të parashtrojë raporte deri te Parlamenti për përdorimin e ndjekjes elektronike të veprave penale të cilat mund të jenë objekt i ndjekjes penale nga ana e Prokurorit publik.

Në bazë të komisioneve të fokusuara anketuese:

- Komisioni për zbulim dhe siguri i Parlamentit në Britaninë e Madhe (ISC, që është kompetent për mbikqyrje mbi të gjithë shërbimet e zbulimit në Mbretërinë e Bashkuar) inicon raporte të tilla në mënyrë të pavarur, nëse

⁹⁰ Shihni shtojcën 4 për shembujt e informatave që përmbajnë këto raporte

kjo është e nevojshme. Një shembull është Raporti special i vitit 2017 për sulmet vdekjeprurëse me fluturaket pa pilot të MB në Siri, që ishte realizuar që të vlerësohet baza e zbulimit për sulmet vdekjeprurëse me fluturaket pa pilot mbi qytetarët e Britanisë të Madhe. ISC mbante seancë për paraqitjen e dëshmive me gojë dhe pranonte material të shkruar dhe raporte origjinale të zbulimit nga agjencitë e zbulimit. Në bazë të kësaj, raporti ishte përgatitur dhe dorëzuar, si dhe në të shumtën e rasteve, deri te Kryeministri (në formë të klasifikuar) edhe deri te Parlamenti (me pjesë të ndjeshme të redaktuara nga materiali)⁹¹.

Si kusht që të bëhet mbikqyrja efektive në bazë të raporteve, duhet që parlamenti të vendos korniza të qarta dhe të rrepta kohore për dorëzimin e raporteve dhe shqyrtimin e tyre në komisione apo në seanca plenare, nëse është e nevojshme.

Raportet të cilat vijnë nga sektorët qeveritarë, e sidomos nga agjencitë e zbulimit janë të shkruara me vështrim edhe ndaj “marrëdhënieve me publikun” dhe prandaj ka gjasa që të mos paraqesin të gjithë fotografjinë. Ata janë të rëndësishme sepse sigurojnë **pikën fillestare** për organet mbikqyrëse që të formulojnë pyetjet dhe strategjitë hetuese, duke përdorur njëkohësisht, mjete më të zhvilluara të mbikqyrjes.

4.2 SHQYRTIMET

Shqyrtimet mund të jenë instrumenti më efikas për mbikqyrje, nëse në mënyrë të drejtë përdoren nga ana e parlamentit. Agjenda për dëgjimet në parlament mund të reflektojë pyetjet më të rëndësishme në atë ditë dhe që tërheq vëmendjen e parlamentit. Në bazë të të drejtës kushtetuese të parlamentit që të marrë informata nga pushteti ekzekutiv në takimet e tyre, aq shpesh sa dëshirojnë, me qëllim që të sigurohen informatat si shtesë e raporteve të rregullta qeveritare. Disa parlamente bëjnë dallim (në ligj, procedurë apo praktikë) ndërmjet shqyrtimeve konsultative dhe shqyrtimet mbikqyrëse.

Shqyrtimet konsultative shpesh organizohen për çështjet politike dhe ligjvënëse, për rregullimin dhe konsultimet me përfaqësues qeveritarë, ekspertët e pavarur dhe/ose palët tjera të përfshira. Dëgjimet konsultative i mundësojnë parlamentit që më së mirë të përmbush funksionin e tij ligjvënës; ata u mundësojnë komisioneve që të grumbullojnë informata që të shqyrtojnë legjislacionin e kaluar, të mendojnë për legjislacionin që pret miratimin apo të hetojnë dhe kuptojnë më së miri pyetjet për të cilat mund të jetë i nevojshëm legjislacioni në të ardhmen. Informatat e detajuara dhe atë të marra nga dora e parë që janë fituar gjatë kohës të shqyrtimeve, pretendohet se do i ndihmojnë komisionit të bëjë analiza që janë më së miri të informuara dhe vendime për këtë pyetje.

- Ndonjëherë shqyrtimet konsultative thirren në mënyrë joformale dhe nuk bëhet shënim tekstual për takimet.
- Shpesheherë shqyrtimet publike konsultative e përmirësojnë transparencën e komisionit dhe informojnë publikun për çështjet e caktuara në lidhje me politikën⁹².

⁹¹ Komisionet parlamentare të zbulimit dhe sigurisë (2017): Sulmet vdekjeprurëse me dron nga OK në Siri, fq 1-4

⁹² Shihni për shembull debatet publike në Ligjin për ndjekjen e komunikimeve në Maqedoni – nga viti 2002 (në organizim të Komisionit për çështje europiane) dhe në vitin 2018 (në organizim të Komisionit të sigurisë dhe mbrojtjes).

Shqyrtimet mbikqyrëse kanë për qëllim që të sigurojnë dëshmi apo sqarim të detajuar për pyetjen e caktuar. Ata janë mjet efektiv për zbulimin e kundërvajtjeve të mundshme, punës jo përkatëse, korrupsionit apo keqpërdorimit të pushtetit dhe për përcaktimin nëse ekzistojnë për revokimin e nëpunësve qeveritarë. Nëpunësit qeveritarë thirren që të japin informata dhe të përgjigjen në pyetjet nga fushëveprimi i tyre. Në shumicën e shteteve, ligjet dhe rregulloret e përshkruajnë detyrimin e nëpunësve të thirrur që të paraqiten para komisionit dhe të sigurojnë dokumentet dhe informatat e kërkuara (ndonjëherë dokumentet mund të dërgohen para mbajtjes të shqyrtimit). Ekspertë të tjerë nga shoqëria civile, akademia apo institucionet e pavarura mund të ftohen që të sigurojnë dëshmi. Shqyrtimet mbikqyrëse zakonisht përfundojnë me raport që mund të përfshijë rekomandime për Qeverinë apo për shërbimet e zbulimit.

- Shqyrtimet mbikqyrëse shpeshherë mbahen *pas dyerve të mbyllura*, që të inkurajohen nëpunësit me rang të lartë në shërbime që të ndajnë informata.
- Në raste të rralla, nëse tema e shqyrtimit është shumë e ndjeshme për sigurinë nacionale, ekziston komunikimi i kufizuar apo aspak nuk informohet shtypi dhe publiku për përmbajtjen e diskutimeve apo për mbajtjen e ngjarjes.
- Dëshmitë me shkrim dhe me gojë të marra gjatë kohës të shqyrtimit janë të përfshira në procesverbalin e komisionit. Në numër të madh të parlamenteve mund të nxirren vetëm dëshmitë vetëm pas vendimit të seancës plenare, kurse në të tjerat, komisionet e përhershme kanë autorizimin që të pranojnë dëshmitë vetëm gjatë kohës të komisionit parlamentar anketues.

Megjithatë, shumica e parlamenteve nuk bëjnë dallimet formale, sepse duket se në shumicën e degjimeve përzihen qëllimet e legjislacionit, mbikqyrjes dhe impiçmentit (revokimit). Efektiviteti i shqyrtimeve si mjet mbikqyrës varet nga disa faktorë.

1. Faktori i parë është pavarësia e komisionit gjatë vendosjes për agjendën e shqyrtimit

- Vendimi për mbajtjen e shqyrtimit zakonisht merret me shumicë të thjeshtë nga anëtarët e komisionit, pa asnjë kusht për miratim në seancën plenare parlamentare apo nga ana e trupave qeverisëse.
- Komisionet gjithashtu kanë kompetenca të zgjeruara në përcaktimin e temës të shqyrtimit dhe funksionerëve ekzekutiv të cilët janë të ftuar që të japin informacione.
- Vendimi nëse shqyrtimi do të jetë publik apo privat zakonisht merret nga shumica e anëtarëve.

2. Faktori i dytë është autorizimi i komisionit anketues

- Në disa parlamente, autorizimi i komisionit që të thërrasë persona në shqyrtim është kufizuar vetëm në ministrat dhe përfaqësuesit qeveritarë, por në të tjerë, komisionet munden që të kërkojnë praninë e ekspertëve jashtë prej qeverisë, me qëllim që të fitojnë një perspektivë tjetër për pyetjet e diskutuara dhe të ndërpresin monopolin që mban qeveria për informatat e sigurisë dhe zbulimit. Duhet të ftohet një spektër i gjërë i njerëzve që të japin qëndrimet e tyre dhe ekspertizën, me gojë dhe/ose në formë të shkruar: përfaqësuesit qeveritarë, duke përfshirë edhe ministrat, grupet e interesuara (shoqatat profesionale, sindikatat), akademikët, specialistët, organizatat joqeveritare, anëtarët e publikut, organizatat e femrave etj.
- Anëtarët e komisionit duhet të koordinohen, të përgatiten në mënyrë themelore dhe të planifikojnë para shqyrtimit, ashtuqë pyetjet e tyre të jenë relevante, të përfshijnë tema të ndryshme dhe nuk do të përsëriten njëra me tjetrën.

3. Faktori i tretë është aftësia e komisionit që të sigurojë ndjekjen e shqyrtimit

- Angazhimi i gjërë i personave zyrtarë dhe kontributet profesionale i mundësojnë komisionit që të përpunojë vlerësime të shëndosha, të bazuara në dëshmi dhe rekomandime relevante.
- Nëse shqyrtimet nuk i japin komisionit dëshmi të mjaftueshme dhe informata për lëndën e hetimit, apo nëse tregohet se për ndonjë pyetje nevojitet hetimi i mëtutjeshëm dhe plotësues, komisioni mund të propozojë në seancën plenare formimin e komisionit anketues me një mandat specifik. Në rastet e rralla, komisionet e përhershme mundën që vet të inicojnë pyetje, pa mbështetje dhe votim në seancën parlamentare (Gjermani, Mal të Zi). Në shumicën e parlamenteve, komisionet anketuese kanë kompetenca që të ftojnë persona në shqyrtime.
- Shqyrtimet publike japin shikueshmërinë (vizibilitetin) e punës të parlamentit, duke i ndihmuar që të tregojë rëndësinë dhe legjitimitetin e tij para publikut të gjërë. Ata i ndihmojnë publikut që të kuptojë se çfarë bën parlamenti dhe cili është efikasiteti i tyre në zbatimin e përgjegjësisë të qeverisë; ata gjithashtu mund të shtojnë një presion publik drejtë zbatimit të rekomandimeve të parlamentit.

› LIGJI I MALIT TË ZI PËR MBIQYRJEN PARLAMENTARE NË FUSHËN E MBROJTJES - VITI 2010

Article 8. Consultative hearings

Dëgjimi konsultativ organizohet dhe realizohet me qëllim që të grumbullohen informatat dhe mendimet profesionale të nevojshme për punën e Komisionit, sidomos kur bëhet fjalë për propozime për zgjidhje (përgatitje të ligjeve dhe akteve nënligjore apo përzgjedhje të kandidatëve) kurse për këtë qëllim, krahas përfaqësuesve të organeve shtetërore, ekspertët nga fushat e caktuara dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare mund të ftohen që të lehtësojnë përgatitjen e anëtarëve të Komisionit për mbikqyrje parlamentare.

Komisioni mund të angazhojë ekspertë në rolin e konsulentëve.

Shpenzimet e bëra me angazhimin e ekspertëve, si dhe pagesat e tyre për punën e tyre paguhen në pajtim me ligjin dhe vlerën e përcaktuar nga Komisioni administrativ.

Komisioni dorëzon deri te Parlamenti raportin për rezultatet nga dëgjimi konsultativ.

Neni 9. Dëgjimet (shqyrtimet) kontrolluese

Dëgjimi kontrollues organizohet dhe realizohet me qëllim që të fitohet mendim dhe që të grumbullohen informatat në pajtim me kompetencën e Komisionit dhe në rast se ka nevojë që të eliminohet paqartësia e caktuar, dilemat, kontestet parimore dhe të sqarohen pyetjet aktuale kontestuese në realizimin e politikave dhe ligjeve apo aktiviteteve tjera të Qeverisë dhe organeve të administratës shtetërore në këtë fushë të sigurisë dhe mbrojtjes.

Vendimi për dëgjimin kontrollues merret nga Komisioni me shumicë të votave nga të gjithë anëtarët.

Në seancë janë ftuar përfaqësuesit përgjegjës të Qeverisë apo organeve tjera të administratës shtetërore, si dhe personat tjerë, prania e të cilëve është e nevojshme që të sqarohen çështjet e lëndës.

Gjatë kohëzgjatjes të dëgjimit kontrollues, anëtarët e Komisionit mund të shtrojnë pyetje personit të ftuar në dëgjim me qëllim që të sqarojnë pyetjet konkrete.

Për shkak të sqarimit profesional të dilemave të caktuara konkrete dhe paqartësive mund të ftohen eksepertët nga fushat e caktuara në dëgjimin kontrollues, me qëllim që të lehtësohet përgatitja cilësore e anëtarëve të Komisionit për realizimin e mbikqyrjes parlamentare.

Pas realizimit të dëgjimit kontrollues, Komisioni përgatit dhe dorëzon te Parlamenti raportin që mund të përmbajë përmbledhjen, dhe të propozojë masat relevante apo përfundimet.

Neni 10. Komisioni parlamentar anketues

Komisioni do të iniciojë anketën parlamentare nëse:

- 1) gjetjet dhe përfundimet nga konsultimet apo dëgjimi kontrollues tregojnë se është e nevojshme që të shqyrtohet gjendja në lidhje me pyetjet konkrete;
- 2) nevojitet që të shqyrtohen çështjet konkrete të interesit publik apo të grumbullohen informata dhe fakte për dukuritë dhe ngjarjet konkrete në lidhje me politikat dhe punën e agjencive të sigurisë dhe mbrojtjes;
- 3) gjetjet dhe përfundimet do të mund të ishin baza që Parlamenti të vendos për përgjegjësinë politike të titullarëve të funksioneve publike apo për ndërmarrjen e veprimeve tjera të kompetencës të tij.

Neni 11. Procedura për dëgjimin konsultativ dhe kontrollues dhe komisionin parlamentar anketues rregullohet me Rregulloren për punën e Parlamentit.

4.3 VIZITAT NË TERREN

Vizitat në terren janë mjete të fuqishme të mbikqyrjes, sepse u ofrojnë mundësinë deputetëve për qasje në informata të dorës të parë për punën e shërbimeve, mundësinë që të angazhohet numër më i madh të personelit të zbulimit sesa në shqyrtimet parlamentare dhe kanë mundësinë që të kontrollojnë hapësirat, pajisjen teknike dhe dosjet.

Për dallim nga shqyrtimet, të cilat bazohen në bashkëveprim dhe dialog me funksionerët të cilët vijnë në Parlament, në territorin e komisionit, gjatë kohës të vizitës në terren, komisioni del në mision hetues të cilin nuk e njeh, kupton apo kontrollon në tërësi. Rreziku i humbjes të fokusit dhe devijimit nga qëllimi mbikqyrës është i madh. Prandaj, nevoja që të mbështetemi në mbështetjen e ekspertëve nga personeli është më e dukshme gjatë kohës të vizitave në terren sesa në aktivitetet tjera mbikqyrëse.

Parakusht tjetër për vizitat e suksesshme në terren është ekzistimi i procedurave të qarta. Rregullorja e punës të komisionit duhet që të theksojë qartë përgjegjësitë dhe hapat në realizimin e vizitës në terren, duke mundësuar miratimin e pandërprerë dhe efikas të vendimeve në të gjithë fazat.

Vizitat në terren mund të analizohen në pajtim me tre fazat kryesore: përgatitjen, realizimin dhe hapat e mëtutjeshme. Çdo fazë e këtij procesi është e ndryshme – në varësi prej asaj nëse vizita është organizuar si aktivitet proaktiv për mbikqyrje (kryesisht paraprakisht të paralajmëruar, ndoshta e përfshirë në programin vjetor të komisionit), apo, nëse është vizitë reaktive që të hetohen pretendimet e caktuara apo incidentet.

Megjithatë, disa parime të përgjithshme nxisin organizimin e vizitave në terren në të gjithë rethanat.

4.3.1 Përgatitja

Përgatitja e mirë dhe planifikimi i duhur janë të rëndësishë thelbësore që të zvogëlohen rreziqet e mos arritjes të suksesit, të cilat shtrihen nga shkaktimi i konflikteve me shërbimet, humbja e përfshirjes të vizitës deri te konfliktet në ekipin e vizitës. “Planifikimi i përsosur parandalon rezultatet e këqija»⁹³. Përgatitja e mirë e vizitës ka disa hapa të caktuar:

Përkufizimi i vizitës, qëllimet konkrete dhe prioritetet

Komisioni duhet të diskutojë dhe të ndërtojë një bazë të përbashkët për atë se cilat duhet të jenë qëllimet dhe prioritetet e vizitës (psh të kuptuarit e mirë të funksionimit të shërbimeve, kontaktet me funksionarët e lartë dhe personelin ekzekutiv, kontrolli i ligjshmërisë të aktiviteteve, ndërtimi i besimit të ndërsjellë, shqyrtimi i pretendimeve në media kundër shërbimeve apo ankesat e qytetarëve etj.).

- Qëllimi konkret dhe prioritetet e vizitës duhet të jenë kompatible me mandatin e komisionit. Ata duhet të përkufizohen me kujdes, me mbështetje të personelit të komisionit nga shërbimi juridik.
- Rekomandohet që të përfshihet personeli ndihmës që në fazën e hershme.
- Jo të gjithë vizitat mund të planifikohen në aspekt afatgjatë paraprakisht dhe me një qëllim të përgjithshëm si përmirësimi i të kuptuarit të proceseve të zbulimit. Ndonjëherë vizita është e jashtëzakonshme dhe e organizuar pas incidentëve më të mëdha, ankesave apo pretendimeve nga qytetarët, politikanët apo mediat. Këto vizita në terren kërkojnë edhe përgatitje më të mirë, me qëllim që të shmangen dështimet në mbikqyrje dhe të zbutet rreziku nga politizimi i tepërt i mbikqyrjes apo rrezikimi i hetimeve të mundshme gjyqësore.

Diskutimet e mëparshme

Hapi tjetër në fazën e përgatitjes përbëhet nga fillimi i komunikimit me ministrat dhe shefat e shërbimeve për qëllimin e komisionit që të organizojë vizita në terren, qëllimi i i tij konkret dhe konteksti konkret për të cilin komisioni është vendosur që të realizojë vizitën. Diskutimet do të përfshijnë lokacionin, kohën dhe lëndën e vizitës të planifikuar.

- Ky hap i paraprin planifikimit real të vizitës dhe është i rëndësishëm për zbulimin e pengesave të mundshme dhe eliminimin e armiqësive të mundshme.
- Shefat e shërbimeve munden në këtë moment tashmë të dorëzojnë informacione dhe dokumente deri te komisioni për informimin e tij rreth aspekteve relevante të vizitës.
- Për arsye të sigurisë nevojitet që të sqarohet dhe harmonizohet mënyra në të cilën anëtarët e komisionit fitojnë qasje në objektet e shërbimeve.
- Pyetjet të cilat diskutohen dhe për të cilat ka marrëveshje duhet të shënohen që të shmangen diskutimet e mëvonshme dhe keqkuptimet gjatë kohës të vizitave

Përzgjedhja e lokacioneve dhe objektet të cilat duhet të vizitohen

Komisioni vendos për lokacionin e vizitës (selinë e shërbimit, instalimet lokale apo teknike etj) dhe objektet konkrete të cilat duhet të vizitohen apo konsultohen (si hapësirat operative, arkivat, TI dhe bazat e të dhënave, kontakti me të punësuarit).

- Përzgjedhja më së miri mund të bëhet në njoftimet e përgjithshme të dhëna nga shërbimet të cilat duhet të përfshijnë lokalizimin e objekteve, madje edhe nëse disa informata janë të klasifikuara.

⁹³ Komisioni belg për kontrollimin e zbulimit

- Duhet të jepet regjim i veçantë për objektet specifike, siç janë shtëpitë e sigurta (strehimoret) për të cilat sekreti apo fshehtësia është arsyeja e ekzistimit të tyre. Zakonisht, komisioni nuk ka nevojë që të dijë këto lokacione, por mund të bëjë marrëveshje me shërbimin se të gjithë kapacitetet e tilla duhet të regjistrohen në një datotekë të veçantë, e cila mund të kontrollohet nga komisioni në rast të incidenteve më të mëdha.

Planifikimi dhe organizimi i vizitës në terren

- Ky hap i referohet të gjithë praktikave dhe përgatitjeve logjistike (orari, koha e kryerjes, etj.).
- Komisioni duhet të bëjë ndarjen e detyrave dhe përshkrimin e roleve për pjesëmarrësit (udhëheqës të ekipeve për vizitën në terren, njoftuesit etj.).
- Komisioni duhet të vendos se cili lloj i raportit duhet të përgatitet (formal apo joformal), cilat dokumentet tjera formale do të duhet të plotësojë apo dorëzojë shërbimi.
- Gjithmonë rekomandohet që të përgatitet një numër i madh i pyetjeve, të përgjithshme dhe specifike për lokacionin që vizitohet. Pyetjet e shtruara shpesh duhet t'i referohen asaj se si aktivitetet në objekt planifikohen, ndiqen dhe dokumentohen.
- Njohja e funksionimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe personat përgjegjës për kontrollin e brendshëm janë shumë e rëndësishme për secilën vizitë në terren e cila ka të bëjë me respektimin e normave ligjore dhe regjistrimin e aktiviteteve.
- Është e dobishme që të diskutohen skenaret për vizitën dhe reagimin e komisioneve deri te ato. Sidomos “skenaret më të këqija” duhet të shqyrtohen dhe zbuten. Për shembull mund të ndodh që të refuzohet qasja, të refuzohen informatat e caktuara, të fillojnë diskutimet e forta me përfaqësuesit e shërbimit, anëtarët e komisioneve të mos pajtohen mes veti, procedurat për vizitë të shkilen etj.).
- Në disa raste, nëse komisioni ka numër të madh të anëtarëve apo nëse qëllimi konkret i vizitës është më i ngushtë, ndoshta është praktike që të dakordojë një ekip të vogël për vizitë i i cili do të marrë mandatin nga komisioni dhe do të dorëzojë raportin. Detajet procedurale për arranzhimin e tillë duhet të jenë të shënuara në mënyrë shumë të qartë në Rregulloren për punë të komisionit. Është me rëndësi që të ketë përfaqësim politik nga të gjithë partitë mëdha, me qëllim që të sigurohet legjitimiteti i nënkomisionit të tillë.
- Komisioni duhet të dakordojë me shërbim një person zyrtar për kontakt, dmth personin përgjegjës të lokacionit.

4.3.2 Zbatimi

Qasja deri te lokacioni i vizituar dhe fillimi i vizitës

- Anëtarët e ekipit për vizitën në terren duhet të identifikohen, dhe, nëse është e nevojshme, të bashkangjisin certifikatat e sigurisë. Bërja e kopjeve të dokumenteve është shumë e rekomanduar.
- Nevojitet që të sqarohet mandati dhe qëllimi i vizitës të personelit që vizitohet nga ana e komisionit. Duhet të njoftohen zërat/objektet e kërkuara të vizitës, qasja deri te datotekat dhe personeli dhe orari në të cilin do të punojë komisioni.
- Vizita që nuk është e lajmëruar kërkon një pëlqim paraprak të përgjithshëm nga ana e ministrit përgjegjës (sepse për shumë parlamente “vizita e papalajmëruar” në fakt do

të thotë se ministri është informuar 24-48 orë paraprakisht. Me pëlqim me shkrim nga ministri apo shefi i shërbimit jepet urdhrë formal deri te të punësuarit në shërbim se duhet të pranohen dhe të bashkëpunojnë me komisionin gjatë kohës të vizitës. Mund të jetë në formë të lejes.

Gjatë kohës të vizitës

- Pas prezantimit, zakonisht thirret personi përgjegjës që të sqarojë misionet dhe aktivitetet e personelit të lokacionit. Anëtarët e ekipit për vizitën në terren fillojnë me shtruarjen e pyetjeve të përgatitura.
- Gjatë kohës të përgatitjes të vizitës duhet të përmenden mjetet kontrolluese (të brendshme dhe të jashtme) të cilat janë të parapara me ligj apo me rregulla tjera, që të mundësohet kontrollimi i pyetjeve të cilat hetohen nga ana e komisionit (si shënime, mëditje, lista të njoftimit të TIK, lista e të punësuarve, certifikatat). Komisioni mund të kërkojë që të shohë këto të dhëna dhe regjistra, dhe të përfshihet në bisedë me ata të cilët janë përgjegjës për situatën dhe sfidat me të cilat përballlet kontrolli i brendshëm.
- Anëtarët nuk duhet vetëm të kërkojnë sqarime, por edhe të kërkojnë nga personi udhëheqës që t'u tregojë shembuj të datotekave, të dhëna dhe raporte dhe nëse është e mundur, të kërkojë të dhëna sipas përzgjedhjes rastësore.
- Kur është lejuar nga ana e personit përgjegjës, anëtarët e ekipit mundën që personelit ekzekutiv t'i shtojnë pyetje për aktivitetet konkrete të cilat i kryejnë.
- Duhet të kihet kujdes se diskutimet apo gjetjet sistematike shënohen/evidentohen nga ana e njoftuesve.
- Të mbeturit objektiv. Mbikqyrja e paanshme, madje edhe në situata të ndërlikuara dhe potencialisht konfliktuese, duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojë edhe gjetjet negative edhe ato pozitive. Madje edhe kur duket e qartë se shërbimet respektojnë standardet ligjore, nevojitet që të shënohet në raporte, që të shërbejë si pikë referente dhe krahasim për aktivitetet e ardhshme mbikqyrëse. Do të ishte e dobishme të përmendet citati, pozitiv apo negativ, për çdo element të listës të kontrollit apo listës të pyetjeve sipas të cilave zhvillohet diskutimi.

Qëndrimi gjatë kohës të vizitës

- Zakonisht është më produktive nëse anëtarët e komisionit përmbahen nga të shprehurit e gjykimit/gjyqit për situatën në formë të deklaratës. Madje edhe nëse kanë qëndrim/mendim të fuqishëm, më mirë është që të formulohet si pyetje sepse ashtu hapet hapësira për diskutim të mëtutjeshëm
- Nuk rekomandohet hyrja në diskutimet politike apo strategjike, gjithsesi jo nga ana e vetë anëtarëve të ekipit të vizitës. Më mirë është të fokusohen në aktivitetet e shërbimit: si janë procedurat, rezultatet dhe epilogjet, si gjenerohet zbulimi, cilat janë aktgjykimet konkrete, si regjistrohen, kontrollohen dhe arkivohen informatat.

Fundi i vizitës

Sqarohen hapat e ardhshme të vizitës të personit udhëheqës apo të personelit (raportet, pikëpamjet kthyes, etj.) përmbledhen të gjithë marrëveshjet e bëra gjatë kohës të vizitës, psh reth njoftimit apo se do të dërgohen informacione/dokumente shtesë deri te ekipi i vizitës.

Dibrifing

Shkurt pas vizitës, në kushte ideale dhe të njëjtën ditë, rekomandohet që të organizohet dibrifing për anëtarët e ekipit të vizitës dhe/ose për të gjithë përbërjen e komisionit.

4.3.3 Hapat e ardhshme të vizitës në terren

Njoftimi

Njoftuesit duhet të dorëzojnë projekt-raportin deri te ekipi i vizitës dhe/ose deri te komisioni sa më shpejtë që është e mundur. Duhet të kushtohet kujdes i veçantë për nivelet e klasifikimit dhe përhapjes të raportit jashtë komisionit. Raporti duhet të përmbajë mendimin e shumicës të anëtarëve, por gjithashtu edhe të nxjerr në pah mendime të ndryshme të anëtarëve individual.

- Është e dobishme që të bëhet dallim ndërmjet gjetjeve: pyetjet për të cilat nevojitet hetimi i mëtutjeshëm, pasojat dhe rekomandimet e mundshme, implikimet për politikat/legjislacionet/buxheti i ardhshëm.
- Rekomandimet duhet të ndahen në afatshkurta, afatmesme, dhe afatgjata. Ata, gjithashtu, mund të dallohen sipas organeve të cilave u referohen, si për shembull në tabelën më poshtë.

LËNDA	NDJEKJA E GRUPEVE RADIKALE	AKTIVITETE TË CILAT DUHET TË NDËRMERREN/ORGANI PËRGJEGJËS	KORNIZA KOHORE
Surveillance of radical groups	1. Sipas mandatit ligjor	Nuk ka/Parlamenti	–
	2. Mungesa e planit operativ për grumbullim	Të përgatitet plani për grumbullim/drejtori i shërbimit të miratuar për ministër	6 muaj
	3. Instruksionet minimale të personelit	Përgatitja e instruksioneve formale/drejtori i shërbimit	1 vjet
	4. Nuk ka gjetje për punën e kundërligjshme nga ana e personelit operativ	Nuk ka/	–

Shqyrtime kthyese

Ministri përgjegjës dhe drejtori i shërbimit të vizituar duhet të marrin shqyrtime përkatëse kthyese, duke përfshirë përfundimet dhe rekomandimet, si dhe kërkesë që të raportojnë për atë se si zbatohen rekomandimet. Tabela e theksuar më sipër mund të plotësohet edhe me një kolonë për hapat e mëtutjeshme, për atë se çfarë është realizuar dhe çfarë nuk është realizuar.

Vlerësimi

Pas një vizite në terren apo pas disa vizitave në terren, komisioni (apo eksperti i jashtëm/trupi parlamentar) mund të bëjë një vlerësim me qëllim që të përshtas procedurën dhe metodologjinë, nëse kjo është e nevojshme.

Njoftimi më i përgjithshëm

Në momentin e caktuar – e ndoshta edhe në nivel tjetër të klasifikimit – mund të përgatitet një raport më i përgjithshëm deri te i gjithë Parlamenti dhe/ose publiku.

› SI TË FITOHET PËRVOJA DHE TË ZHVILLOHET PRAKTIKA E KOMISIONIT PËR ORGANIZIMIN E VIZITAVE NË TERREN?

- Në mënyrë ideale, Rregullorja për punë e Komisionit në mënyrë të detajuar dhe të qartë përshkruan se si organizohen vizitat në terren. Nëse jo rregullorja e punës, protokolli i tërësishëm duhet të dakordohet në fillim të mandatit të komisionit, i cili përfshin vizitat e lajmëruara dhe jo të lajmëruara.
- Komisioni i ri duhet të fillojë me vizita të cilat janë lajmëruar shumë paraprakisht për temat e përgjithshme dhe detyrat, që ta kuptojë më së mirë organizatën, funksionet dhe aktivitetet e zbulimit. Vizita në selinë e organizatës është fillimi më i mirë që të merret shqyrtimi i operacioneve, administratës etj., që më tutje të vazhdohet me hapësirat më specifike funksionale/rajonale.
- Në këtë mënyrë i jepet mundësi edhe komisioneve edhe shërbimeve që të njihen mes veti dhe të mësojnë për qëllimet e tyre në mjedisin që nuk është konfliktuos.
- Është e dobishme që të planifikohet periudha e vizitave të lajmëruara dhe të dakordohet pika fillestare nga e cila do të mund të realizohen edhe vizitat jo të lajmëruara. Duhet të parashihet se edhe gjatë kohës të “periudhës të lajmëruar të vizitës” vizitat mund të realizohen edhe pas njoftimit të shkurtër në situatat e jashtëzakonshme.
- Kur anëtarët e komisionit kanë certifikatë të sigurisë, duhet të kontrollohet niveli i miratimit me certifikatin e sigurisë dhe ai i personelit shoqëruar (në varësi nga qëllimi dhe tema e vizitës në terren) dhe nëse me të njëjtat miratohet qasja fizike në lokacione dhe objekte.
- Duhet të tregohet kujdes sepse shërbimet i kuptojnë parimet e “shpalosjes të informatave vetëm kur kjo është e nevojshme” për mandatin konkret të mbikqyrjes të komisionit, duke përfshirë edhe autorizimin ligjor të komisionit dhe bazën ligjore për mandatin për mbikqyrje të komisionit.
- Lokacionet më të ndjeshme (si objektet e përgjimit) duhet lënë për ndonjë fazë të mëtutjeshme, kur komisioni është njohur mirë me të gjithë fotografimin, ashtuqë dijnë më mirë se çfarë të kërkojnë dhe si ta kërkojnë.
- Përgatitja e mirë është themelore për suksesin e vizitës; mungesa e njohjes të mirë të legjislacionit dhe mënyra në të cilën funksionojnë shërbimet mund të jap rezultat të dobëta për komisionin, por gjithashtu paraqet një mundësi të humbur që të vendoset dhe avancohet mbikqyrja.

4.4 AKTIVITETET ANKETUESE

Aktivitetet anketuese janë një instrument shumë i fuqishëm për mbikqyrje dhe ata kanë një potencial shumë të rëndësishëm që të zbulojnë faktet e mbuluara nga qeveria. Aktivitetet anketuese gjithmonë realizohen në kuadër të një mandati specifik dhe të ngushtë, përmes përkufizimit të temës, vëllimit dhe kornizës kohore të aktivitetit anketues.

Aktivitetet parlamentare anketuese kanë autorizime të veçanta për hetimin, të cilat gjithashtu quhen **autorizime për thirrje për të dhënë dëshmi**. Kjo do të thotë se rregullat e procedurës penale zbatohen *mutatis mutandis* në marrjen e dëshmive. Komisionet anketuese kanë autorizim

të njëjtë si edhe gjykatësit hetues: ata mund të thirrin dëshmitarë, të kërkojnë dokumente dhe lëndë tjera, e shpeshherë shfrytëzojnë mjetet ligjore që të realizojnë kërkesat e tyre. Ajo që i dallon hetimet nga format tjera të hetimit parlamentar është se autorizimet e tyre nuk i referohen vetëm anëtarëve të qeverisë dhe nëpunësve publik, por edhe publikut. Në shumicën e shteteve europiane, komisionet anketuese mund të thërrasin cilindo nëpunës apo qytetarë të thjeshtë pa përjashtim apo kufizim (ky është dallim shumë i madh nga dëgjimi). Qytetarët e ftuar mund të paraqiten, të japin sqarime, të përgjigjen në pyetje dhe të japin dokumente dhe informacione deri te komisioni nën betim, ngjajshëm me dhënien e dëshmisë në gjykatë dhe me të njëjtat pasoja për dhënien e deklaratës të rrejshme. Megjithatë, këto autorizime hetuese mund të përdoren **vetëm** në lidhje me pyetjen e drejtëpërdrejtë në shqyrtimin anketues dhe kohëzgjatjen e kufizuar, në pajtim me mandatin e komisionit anketues.

Rregullorja e parlamentit duhet të jap instruksione të qarta për kushtet në të cilat mund të inicohet aktiviteti anketues duke mundësuar përfaqësim të drejtë të opozitës dhe grupeve të pakicave në vendimin për organizatën dhe mandatin e komisionit anketues. Shumë pak komisione të përhershme kanë autorizime që të jenë komisione anketuese, e kur kjo do të mundësohet, ata duhet të fitojnë leje dhe mandat nga seanca plenare⁹⁴ (përjashtim ka në Gjermani, Belgjikë, Hollandë, Kanadë dhe Mal të Zi).

Më së shpeshti, aktivitetet parlamentare anketuese i udhëhiqen **ad-hok komisionet anketuese** ndërpartiake. Ata janë themeluar me vendim/rezolutë të Parlamentit në seancën parlamentare, me mandat që të grumbullojnë informacione për incidentet e caktuara apo epizodet e interesit të ndezur politik. Komisionet anketuese inician pas ngjarjes të ndezur, por në afatin e arsyeshëm kohor, që të mund të nxirren menjëherë porositë. Ata fitojnë afatin e caktuar kohor për realizimin e hetimeve të tyre. Pas parashtrimit të raportit të tyre përfundimtar, komisioni anketues shpërbëhet.

Edhe krahas ngjajshmërive ndërmjet tyre edhe atyre të procedurave gjyqësore, komisionet hetuese nuk duhet të përzihen me hetimet penale, sepse ata nuk vlerësojnë dhe nuk japin përgjegjësi penale. Raportet nga hetimi janë të natyrës politike. Përfundimet e tyre apo rezultat nuk janë juridikisht të detyrueshme në vete. Për këto arsye, hetimet duhet të zbatohen me një vëmendje të detyrueshme. **Komisioni i Venedikut** ka formuluar **rekomandime** për rastet në të cilat komisioni hetues zbulon elemente që sygjerojnë se është kryer vepër penale.

1. Informoni prokurorin publik dhe dorëzoni informatat relevante dhe dokumentacionin e organeve të ndjekjes, deri në shkallën në të cilën kjo është lejuar sipas legjislacionit nacional.
2. Zbulimi i veprave penale të mundshme nuk duhet në vete të ndalojë procesin legjitim parlamentar të hetimit. Hetimi duhet të vazhdojë dhe komisioni duhet të vazhdojë që të shqyrtojë rastin dhe të jap vlerësimet e tij (politike). Sidomos, ai duhet të mundet të vazhdojë që të shqyrtojë faktet e rastet, madje edhe nëse këto fakte gjithashtu mund të jenë të rëndësishme për procedurën penale.
3. Vendosni procedura përkatëse për bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave dhe dëshmime ndërmjet komisionit dhe prokurorit publik, në të njëjtën kohë duke respektuar dallimet ndërmjet të dy proceseve, si dhe të drejtat procedurale të personit për të cilin ekziston dyshimi se ka kryer vepër penale dhe të personave tjerë të cilët paraqiten para komisionit.
4. Në mënyrë të drejtë merrni parasysh hetimet kriminale apo procedurat që presin dhe të jeni të kujdesshëm që të mos bëni vlerësime apo deklarata për çështjen e fajit apo të dëmtoni parimin e fajit të supozuar në mënyra tjera. Komisioni duhet të tregojë kujdes të madh që

⁹⁴ Në vitin 2007, pasqyra e mjeteve parlamentare të mbikëqyrjes në 88 parlamente, realizuar nga BIP, ka zbuluar se vetëm në 13 parlamente, komisionet e përhershme mund të zhvillojnë hefim, gjithmonë me leje të marrë në seancën plenare.

të sigurohet se hetimet e tij nuk do të pengojnë apo në çfarëdo mënyre nuk përzihen në mënyrë të panevojshme në hetimet penale apo procedurat.

5. Gjatë formulimit të raportit të tij, komisioni parlamentar duhet të ketë shumë kujdes që të mos bëjë vlerësime nga natyra juridike penale apo të jepet përgjegjësi penale për secilin prej palëve të përfshira. Megjithatë, duhet të mbes i lirë që të përshkruhen dhe analizohen të gjithë faktet e rastit dhe të vlerësohen nga perspektiva politike.
6. Fakti se janë përfshirë persona të cilët nuk posedojnë autorizime publike nuk duhet të kufizojë komisionin parlamentar të hetojë për sjelljen e personave të tillë për atë që është e rëndësishme. Prandaj, nëse shqyrtohet skandali publik, fakti se ndonjë person është privat dhe nuk ndërmerr asnjë rol publik, nuk duhet të përjashtojë personin e tillë të thirret që të paraqitet para Komisionit.

› ÇFARË AUTORIZIME SPECIALE HETUESE MUND TË KENË KOMISIONET?

Komisioni i mbrojtjes në Bundestagun gjerman ka një pozitë të jashtëzakonshme, sepse themelimi i tij është paraparë me Kushtetutë dhe është komisioni i vetëm që mund të shpallet si komision anketues (Neni 45a, paragrafi (2) nga Ligji themelor). Në rastet e të gjithë komisioneve tjera, Parlamenti duhet që të marrë vendim për to. Komisioni anketues është arma më efektive e Parlamentit për mbikqyrje mbi sjelljen e Qeverisë, me të drejta të ngjajshme si dhe Prokuroria publike.

- Takimet në të cilat paraqiten dëshmitë janë të hapura për publikun, përveç nëse nuk kërkohet sekreti ushtarak. Takimet në të cilat vlerësohen dëshmitë nuk janë të hapura për publikun.
- Dënimi administrativ deri në 10.000 euro mund të shqiptohet për dëshmitarët që mungojnë apo atyre të cilët refuzojnë të dorëzojnë objektin që është kërkuar nga komisioni anketues si dëshmi⁹⁵. Në rastet e mosrespektimit të sërishëm, dënimi administrativ mund të arkëtohet sërish.
- Dëshmitari që refuzon të dëshmojë, mund të detyrohet që të marrë pjesë nga ana e gjykatësitet hetues në Gjykatën federale të drejtësisë, pas pranimit të kërkesës të komisionit anketues të mbështetur nga një e katërta e anëtarëve të tij. Dëshmitari mund të mbahet në paraburgim me qëllim që të detyrohet që të dëshmojë⁹⁶. Gjykatësi gjithashtu mund të urdhërojë bastisjen për marrjen e objekteve që i kërkon komisioni hetues si dëshmi⁹⁷.
- Nga qeveria federale kërkohet që të jap autorizimin e nevojshëm për të testuar titullarët e funksioneve.⁹⁸

Në Francë, refuzimi që të paraqitet para komisionit anketues dhe që të përgjigjet në pyetjet e parashtruara mund të dënohet me 2 vite burg dhe dënim në të holla prej 7.500 euro.⁹⁹

Komitetet e kongresit në SHBA posedojnë autorizime për thirrje për të dëshmuar. Refuzimi që të dëshmojë para komisionit apo mossigurimi i dokumentit të kërkuar konsiderohet mosrespektim i Kongresit, dhe shqiptohet dënim me burg deri në 1 vit

⁹⁵ Ligji për komisionet hetuese, seksioni 21, 27 dhe 29

⁹⁶ Po aty, seksioni 27 (2)

⁹⁷ Po aty, seksioni 29(3)

⁹⁸ Seksioni 23 nga Ligji për komisionet anketuese. Shihni gjithashtu seksionin 54 (4) nga LPP në Gjermani për ekzaminimin e nëpunësve publik të cilët nuk janë më në punë. https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_stpo/englisch_stpo.html Nevojitet një analizë shtesë e legjislacionit special që të sqarohet nëse nëpunësit e mëparshëm shtetëror janë të detyruar që të dëshmojnë, por duket se nuk është ashtu.

⁹⁹ Neni 6 nga Ligji për funksionimin e parlamentit nga viti 1958

dhe gjobë prej 1.000 dollarëve amerikan.

Ligji i Malit të Zi për mbikqyrjen parlamentare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes parasheh dënim për mospërgjegjësi në ftesat e komisionit apo për mossigurimin e informatave të nevojshme (neni 22), me parashikimin e gjobës deri në 2.000 euro për të punësuarit dhe deri në 20.000 euro për subjektet juridike.

Megjithatë, në praktikë, **aktivitetet anketuese** janë mjet mbikqyrës që është përdorur rrallëherë, mjaft shpesh përdoret si mjet i fundit¹⁰⁰. **Pak aktivitete parlamentare anketuese kanë dorëzuar rezultate** të mjaftueshme, të paktën në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Shpesh kjo është rezultat i resurseve jo të mjaftueshme hetuese dhe aftësitë të cilat janë vendosur në dispozicion të komisioneve anketuese. Kjo tregon në atë se në të shumtën e shteteve, informacionet të cilat i fiton parlamenti janë në fund informacionet të cilat shërbimet e zbulimit vendosin që t'i ndajnë.

Më poshtë janë dhënë disa shembuj të hetimeve parlamentare në fushën e sigurisë dhe zbulimit:

- “Hetimi gjerman i NSA” (Untersuchungsausschuss „HCA“) i filluar në Bundestag në mars të vitit 2014 është formuar që të shqyrtojë shkallën e spiunimit të shërbimeve të huaja sekrete në Gjermani. Komisioni është takuar për të 131-tën herë në periudhën prej tre vitesh: 66 herë në takimet publike. Janë dëgjuar nëpunësit publik të nivelit të lartë, duke përfshirë edhe kancelaren Angela Merkel. Fillimisht i shkaktuar nga zbulimet e Eduard Snouden, hetimi është transformuar për të shqyrtuar ligjshmërinë e zbulimit gjerman dhe identifikojë deficite të rëndësishme të mbikqyrjes, duke përgatitur rrugën për reforma të mëdha në zbulim. Në vitin 2016, Uikiliks ka publikuar mbi 2.400 dokumente për të cilat thuhet se janë nga hetimi.
- Në Francë dhe Belgjikë, parlamentet përkatëse nacionale kanë krijuar komisionin e veçantë anketues pas sulmeve terroriste në vitet 2015 dhe 2016.
- Në vitin 2006, Senat i Romanisë formoi komisionin hetues ad hoc i cili gjatë dy viteve, ka hetuar ekzistimin e vendeve të fshehta për paraburim të CIA-s në territorin nacional. Raporti ruhej në fshehtësi, përveç përfundimeve të tij, të cilat kategorikisht mohojnë mundësinë që entet e fshehta të paraburgimit të vendosen në territorin e Romanisë. Megjithatë, këto përfundime ishin kundërtënëse me “Hetimin e Favas” në Parlamentin Europian (viti 2007) dhe nga rasti para GJEDNJ, Al Nashiri kundër Romanisë (viti 2018).
- Në Bosnjë dhe Hercegovinë, në vitin 2011, Komisioni i përbashkët për mbrojtje dhe siguri, me miratim të Kuvendit nacional, formohej si komision anketues për shqyrtimin e ligjshmërisë të procesit të shkatërrimit të municionit, minave dhe mjeteve eksplozive, armëve dhe pajisjes ushtarake të udhëhequr nga Ministria e mbrojtjes ndërmjet viteve 2006 dhe 2009. Të gjithë informatat e grumbulluara i janë dhënë prokurorit publik, me kërkesë që të fillojë hetimi. Por, hetimi nuk ka ndodhur asnjëherë.
- Në vitin 1994, parlamenti hollandez ka krijuar komisionin parlamentar hetues për metodat e hetimit penal që përdoren në Hollandë dhe kontrolli që zbatohet mbi metodat e tilla. Komisioni ka realizuar intervistat preliminare me mbi 300 persona, të pasuara me “bisedat e besueshme” me 130 persona dhe 39 shqyrtime publike që janë emituar drejtpërdrejtë në televizionin nacional. Raporti prej 6.700 faqesh i shpallur në vitin 1996, kishte ndikim të konsideruar mbi organizimin e hetimeve penale në Hollandë, që kan sjellur deri te reformat e mëdha ligjore.


¹⁰⁰ Shumica e parlamenteve krijojnë komisione anketuese vetëm disa herë gjatë kohës të mandatit ligjvënës. Për shembull, Dhoma përfaqësuese në Hollandë ka krijuar vetëm 10 komisione anketuese në 3 dekadat e fundit. <https://www.houseofrepresentantss.nl/how-parlament-works/parliamentary-inquiry>

- Komisioni për zbulim dhe siguri i parlamentit të Mbretërisë të Bashkuar, gjatë tetë muajve, ka realizuar hetimin për kërcënimin nga Rusia dhe Britania e Madhe (sajber, dezinformata, dhe ndikim) dhe përgjigja e qeverisë të Britanisë të Madhe ndaj kërcënimit të tillë. Raporti është shpallur në korrik të vitit 2020¹⁰¹.

Inquiries receive more public attention than regular parliamentary activities. Therefore, they bring a spotlight to issues under scrutiny and shape the public agenda. Inquiries bring visibility to the work of parliament and thus may enhance public trust in this institution and build upon parliament's credibility and legitimacy within the democratic system.

¹⁰¹ <https://docs.google.com/a/independent.gov.uk/viewer?a=v&pid=sites&srcid=aW5kZXBlbmRlbnQuZ292LnVrfGZlY3xneDo1Y2RhMGEyN2Y3NjM0OWFI>

5



**JASHTË NGA CIKLI I FSHEHTËSISË:
MBIKQYRJA MBI ZBULIMIN DHE
QYTETARËT**

Llogaridhënia është zinxhir i marrëdhënieve të cilat në fund udhëheqin te qytetarët. Përmes zgjedhjeve, qytetarët delegojnë pushtetin te përfaqësuesit, por e mbajnë *të drejtën të dijnë* se si organet shtetërore mbrojnë interesat nacionale dhe shpenzojnë mjetet publike. Vlera e mekanizmave të mbikqyrjes nuk mbështetet vetëm në atë se si kanë sukses që të mbështesin llogaridhënien e zbulimit, por edhe në transparencën e tyre personale dhe të qëniet të hapur ndaj qytetarëve.

Formimi i komisioneve të specializuara për mbikqyrje mbi zbulimin në shumicën e parlamenteve demokratike nuk duhet patjetër që të shpie në një llogaridhënie të rritur publike dhe transparencë të sektorëve të zbulimit. Në vend të kësaj, trupat e mbikqyrjes mbi zbulimin janë ata të cilat janë thellësisht nën ndikim të normave të fshehtësisë të cilat dalin nga shërbimet e sigurisë dhe zbulimit. Një numër i madh i studimeve tregojnë trendin që shpie drejtë “fshehtësisë” të mbikqyrjes, sepse kujdesi për fshehtësinë dominon mbi përgjegjësinë që të informohet publiku për llogaridhënien e zbulimit. Në shumë parlamente takimet e komisioneve sipas rregullit janë të mbyllura, takimet e tyre, agjenda dhe përfundimet ruhen në fshehtësi dhe asnjë raport nuk shpallet në publik.

Për publikun, mbikqyrja e bërë në fshehtësi është mbikqyrje që nuk është bërë. Mungesa e shënimit të hapur për dënimin e gabimeve, keqpërdorimeve, problemeve individuale dhe sistematike në zbulim, do të përfundojë me rrënimin e kredibilitetit të parlamentit si një supervisor kompetent të interesit publik dhe si mbrojtës i zgjuar i të drejtave individuale. Qetësia e vazhduar për çështjet e zbulimit do të bëjë që komisionet dhe parlamenti në përgjithësi, të duken joefikase, e madje edhe jorezistente ndaj informatave të zbulimit.

Për shkak të këtyre arsyeve, komisionet e mbikqyrjes mbi zbulimin duhet të informojnë publikun për punën e tyre. Ata duhet t’u japin dorën mediave, shoqërisë civile dhe trupave tjerë të pavarur mbikqyrës, që të ndërtojnë aleanca dhe partneritete të përkushtuara në përmirësimin e llogaridhënies demokratike. Ndoshta do të jenë të nevojshme strategji specifike që të përfshihen bashkësitë e marginalizuara, të cilat ndoshta janë lëndë e shkëljes dhe keqpërdorimit të të drejtave të njeriut gjatë kryerjes të autorizimeve speciale të shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit.

5.1 NJOFTIMI PUBLIK

Parlamentarët (deputetët) përfaqësojnë trupin e tyre votues dhe janë llogaridhënës para publikut për aktivitetin e tyre parlamentar. Është e pamundur që publiku të ndjek punën e përfaqësueve të tij, nëse puna e tyre zhvillohet ekskluzivisht pas dyerve të mbyllura .

Duke patur parasysh natyrën e teknikës dhe operacioneve të zbulimit, pa dyshim se një transparencë e tërësishme e mbikqyrjes nuk është as e mundshme as e dëshirueshme. Komisionet duhet të harmonizojnë kushtin demokratik për transparencë me kufizimin që është njësoj i rëndësishëm për mbrojtjen e informatave të klasifikuara. Nëse ligjet janë të qarta në përkufizimin e asaj që prezanton informata e klasifikuar dhe cilat janë informata të interesit publik dhe nëse komunikimi ndërmejt shërbimeve dhe komunikimit është efektiv në bazë të besimit të ndërsjellë dhe respektimit të procedurave, komisioni mundet lehtësisht të dallojë se çfarë mund të publikohet dhe çfarë duhet të ruhet në rethin e fshehtësisë.

Komisionet kanë disa mënyra për të njoftuar publikun, më shpesh të përdorura janë:

- Njoftimet për mediat – zakonisht të përgatitura nga personeli i komisionit dhe të

miratuara nga kryetari i komisionit apo nga të gjithë anëtarët (nëse tema është politikisht e ndjeshme),

- Zyra parlamentare për marrëdhëniet me publikun – mban komunikimin me gazetarët të cilët janë të akredituar në parlamente. Ata zakonisht punësojnë komunikologë të cilët mund t'u ndihmojnë komisioneve në përgatitjen e njoftimeve për shtypin apo madje në veprimin e strategjisë të komunikimit
- Raportet e komisionit të legjislacionit dhe mbikqyrjes (verzionet jo të klasifikuara) publikohen në ueb-faqen e parlamentit.
- Intervistat për shtyp nga ana e anëtarëve individual.

Si pasojë e zbulimeve të Snowden nga viti 2013 për programet e ndjekjes masive të realizuara nga disa qeveri, kishte përpjekje domethënëse të agjencive të zbulimit që të përmirësojnë komunikimin, shkëmbimin dhe bashkëpunimin me trupat mbikqyrëse, e sidomos me publikun e gjërë. Në numër më të madh të vendeve, shërbimet e zbulimit, sot, publikojnë raporte vjetore për aktivitetet e tyre. Kjo është shenjë se bashkësia e zbulimit është e vetëdijshme se sa është e rëndësishme mbështetja publike, legjitimiteti dhe kredibiliteti në një shoqëri demokratike. Shpeshherë, këto raporte për aktivitetet japin informacione tepër të detajuara për atë se si mbikqyret shërbimi nga parlamenti¹⁰².

Raporti vjetor për aktivitetet e shërbimeve të zbulimit zakonisht dorëzohet deri te Parlamenti para se të publikohet. Komisionet për mbikqyrje mbi zbulimin e analizojnë raportin dhe bisedojnë me shërbimin për çështjet eventuale të cilat duhet të sqarohen. Më pas, raporti prezantohet në seancën plenare dhe para publikut. Diskutimi plenar për raportin vjetor për aktivitetet e shërbimit është një përpjekje e përbashkët për transparencë të komisioneve për mbikqyrje – në disa parlamente është rruga e vetme kur komisionet për mbikqyrje mbi zbulimin publikisht tregojnë vlerësimet e tyre të përgjithshme të aktiviteteve të zbulimit.

Komisionet e zbulimit lëshojnë raportet e tyre vjetore të aktiviteteve. Më shpesh kanë detyrim ligjor që të dorëzojnë këtë raport deri te trupi udhëheqës në Kuvend, i cili ka të drejtë diskreionale që të shpall raportin, pasi që teksti do të redaktohet që të nxirren informacionet e ndjeshme. Procedura e njëjtë zbatohet për raportet ad-hok për mbikqyrje të komisionit. Ekzistojnë procedura formale dhe joformale me të cilat agjencitë duhet të konsultohen për materiale për të cilat konsiderojnë se nuk duhet të shpallen.

› CILAT JANË PRAKTIKAT E NDRYSHME TË NJOFTIMIT NË PARLAMENTET E NDRYSHME?

Si pranim se kredibiliteti i mbikqyrjes mbështetet në komunikimin me qytetarët, korniza juridike për mandatin dhe autorizimet e Komisionit rumun për mbikqyrje mbi zbulimin është ndryshuar në vitin 2017. Dispozita e mëparshme me të cilën është theksuar se “të gjithë informatat për punën e Komisionit janë informata të klasifikuara” është zëvendësuar me afirmimin e sërishëm të përgjegjësisë të Komisionit që të mbrojë informatat e klasifikuara, në pajtim me ligjet relevante.¹⁰³ Në frymën e këtyre ndryshimeve rregullatore, Komisioni është bërë më aktiv dhe ka filluar që të publikojë informata për aktivitetet e tij në ueb-faqen e Parlamentit. Përderisa aspak nuk kanë ekzistuar çfarëdo informata për aktivitetet e Komisionit për dekadën e fundit, në vitin 2017, Komisioni ka mbajtur 45 seanca, të pasuara me 30 seanca në vitin 2018, ka filluar me hetime dhe shqyrtime dhe ka organizuar njoftime të shpeshta për mediat. Në Mbretërinë e Bashkuar, Komisari për autorizimet hetuese dhe Komisioni për

¹⁰² Mund të ndodh që shërbimi i zbulimit të njoftojë për aktivitetet mbikqyrëse ndërsa komisioni i mbikqyrjes mbi zbulimin të jetë tërësisht jotransparent për publikun. Kjo nuk e vendos parlamentin në dritë të favorshme.

¹⁰³ HP nr 85/Tetor 2017, Neni I(5).

zbulimin dhe sigurinë në Parlament (ISC) duhet të parashtrojë raportin, në kohën e fundit pas përfundimit të secilit vit kalendarik. Kryeministri mund të largojë materialin nga raporti nëse shpalosja do të ishte e dëmshme për kryerjen e vazhdueshme të funksioneve të agjencisë.

Komisionet për mbikqyrje mbi zbulimin nga parlamentet e Italisë, Francës, Gjermanisë, Suedisë dhe Britanisë të Madhe kanë detyrimin ligjor që të publikojnë raportet vjetore për aktivitetet. Gjatësia respektivisht madhësia e këtyre raporteve varion prej 93 faqeve (Francë) deri në 14 faqe (Gjermani) dhe i referohen të dhënave statistikore për aktivitetet e komisionit (siç janë numri i seancave dhe orët e punës), metodat e mbikqyrjes, dialogu ndërinstitutional, rekomandimet¹⁰⁴

5.2 VLERËSIMI I MBIKQYRJES

Problemi kryesor në vlerësimin e kontributit të komisioneve mbikqyrëse është fakti se ka pak informata për aktivitetet e tyre. Sfida e dytë ka lidhje me mungesën e kriterëve evidente për kontributin. Faktori më i rëndësishëm që duhet të ndiqet është ndikimi i mbikqyrjes mbi aktivitetet e shërbimeve. Komisionet e mbikqyrjes duhet të mbajnë evidencë për gjetjet e tyre dhe rekomandimet dhe të prezantojnë sistemin e ndjekjes të aktiviteteve të mëtutjeshme, me një theks të veçantë të ndodhitë ligjore të shkaktuara nga mbikqyrja.

Vetëvlerësimi është zgjidhja e parë dhe më e lehtë e komisionit që dëshiron të vlerësojë ndikimin e punës të tij mbi institucionin e mbikqyrur. Vetëvlerësimi ofron disa përparësi në krahasim me vlerësimin e kryer nga ekspertët e jashtëm dhe atë:

- Megjënëse bëhet fjalë për aktivitet në bazë vullnetare, që realizohet në mungesë të vëzhguesve të jashtëm, kontribuon drejtë një debati të papërmbajtur për përparësitë dhe mungesat në punën e komisionit;
- Shmang problemet e lidhura me qasjen në informatat e klasifikuara dhe besueshmërinë e punës të kryer (që do të ishte e pakapërcueshme për një person të jashtëm)
- Ky është një ushtrim i mirë për mësimin, rritjen e vetëdijes dhe ekspertizën e parimeve, mjeteve dhe praktikave të mira të mbikqyrjes;
- Maksimizohet mundësia për përdorimin dhe lidhjen e gjetjeve me reformat nacionale.

Marrë në përgjithësi, vetëvlerësimi ka më shumë potencial sesa vlerësimi i jashtëm kur bëhet fjalë për dhënien e kontributit drejtë konsolidimit institucional. Megjithatë, do të duhet mbështetja nga kuadri profesional për konceptualizimin dhe lehtësimin e aktivitetit të tillë (përgatitja e pyetësorëve, intervistat gjysëm të strukturuar, me palë të ndryshme të përfshira, diskutimet e grupeve të fokusit etj.).

Në vend të vetëvlerësimit, mund të kërkohet ekspert i jashtëm apo grup ekspertësh që të realizojnë revizionin për kontributin e komisionit. Krahas asaj që ndoshta është më e shtrenjtë, ekipi i jashtëm për vlerësim do të duhet të ketë/apo të fitojë certifikat të sigurisë dhe legjitimitet nga mandati i miratuar nga parlamenti.

Vetëvlerësimi apo vlerësimi i jashtëm i punës të parlamentit në mbikqyrjen mbi zbulimin duhet t'i referohet:

¹⁰⁴ Agjencia për të drejtat fundamentale e Bashkimit Europian (FRA) (2017): mbikqyrja mbi shërbimet e zbulimit: mbrojtja e të drejtave themelore dhe mjeteve juridike në BE, tom II: perspektivat e terrenit dhe përditësimi ligjor, fq. 87 dhe 164

- Momentit fillestar (bazës) në të cilin grumbullohen informatat (treguesit),
- Përkufizimi i situatës të dëshiruar (qëllimi/targeti) dhe,
- Krahasimi i rregullt i të dhënave gjatë kohës të periudhës të caktuar të mbikqyrjes.

Shumica e treguesve mund të ndiqen në mënyrë cilësore, por madje edhe treguesit sasiorë, të cilët mund të shprehen përmes numrave, duhet që të vendosen me kujdes në kontekst.

Treguesit sasiorë mund t'i referohen numrit të: takimeve të komisionit, pyetjeve të rendit të ditës, raportet e rregullta të cilat fitohen dhe debatohen, raportet e veçanta të kërkuara, shqyrtimet, vizitat në terren, raportet e komisioneve të cilat dorëzohen në plenare, aktivitetet mbikqyrëse të inicuar nga grupet e pakicave, kundërshtimet kundër shërbimeve, mandatet për përgjimet të cilat janë realizuar/refuzuar etj.

Disponueshmëria e vlerave statistikore të përmendura më sipër në burimet e hapura në vete paraqesin një tregues të rëndësishëm për transparencën e parlamentit drejtë publikut. Duhet të analizohet mosdisponueshmëria e të dhënave të tilla për punën e parlamentit.

Treguesit sasiorë – pasqyrojnë notat, qëndrimet dhe mendimet e njerëzve për situatën apo temën e caktuar. Ata janë më të rëndësishme në ndjekjen e trendit në punën e parlamentit, sepse mbikqyrja ka natyrë komplekse, politike dhe cilësore. Këtu ka disa shembuj:

- Niveli i besimit të ndërsjellë, dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet komisionit, ministrive relevante dhe shërbimeve të zbulimit
- Zbatimi i rekomandimeve parlamentare nga ana e pushtetit ekzekutiv dhe agjencitë e sigurisë
- Përgjigja e ministrisë/shërbimit në kërkesat për informata dhe në ftesat për shqyrtime.
- Të kuptuarit e rolit dhe funksionit të parlamentit (në parlament dhe në sektorin e zbulimit)
- Vetëdija parlamentare dhe të kuptuarit e ligjeve dhe procedurave relevante
- Qëndrimi parlamentar ndaj mbikqyrjes dhe vullneti politik që qeveria dhe shërbimet të mbahen llogaridhënëse për punën
- Marrëdhënia të cilën e zhvillon komisioni me trupat e pavarur të cilët kanë mandat të luajnë rol në qeverisjen demokratike (Këshilli për mbikqyrje civile, Enti shtetëror për revizion, Avokati i popullit, Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale.)
- Përdorimi i mediave nga ana e deputetëve për përcjelljen e mendimeve dhe qëndrimeve
- Përdorimi i ekspertizës të pavarur të cilën e jep shoqëria civile për punën e komisionit
- Fokusi mbi të drejtat e njeriut në aktivitetet mbikqyrëse
- Përfaqësimi i trupave parlamentare dhe përdorimi i strategjive që të jenë inkluzive (përfshirëse)
- Fotografia e parlamentit/dhe komisionit në media
- Fotografia e shërbimeve në media apo mendimi publik
- Transparenca e shërbimeve (raportet publike, informatat e siguruar në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informatat e karakterit publik, ekzistimi i zyrës për marrëdhënie me publikun etj.)

› CILAT JANË KËRKESAT E MBIKQYRJES EFEKTIVE?

Qasja: mbikqyrja dhe qasja në informata duhet të përfshijë personelin, lokacionet dhe informatat e klasifikuara të cilat janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për ata të cilët kryejnë mbikqyrje që të realizojnë mandatin e tyre.

Besimi: sistemet për mbikqyrje duhet të dizajnohen dhe të mbajnë fshehtësinë dhe integritetin e procesit të zbulimit. Nevojitet besueshmëri/siguri që të fitohet besimi i shërbimeve të zbulimit dhe të mbrohen interesat nacionale.

Pavarësia: mbikqyrja duhet të jetë e pavarur nga interesat partiake dhe nga ndikimet jo të duhura mbi shërbimet e zbulimit.

Autorizimi: mbikqyrja efektive varet nga autorizimet diskrecionale për hetimin, duke përfshirë edhe autorizimin që të detyrohen njërezit të dëshmojnë nën betim.

Bashkëpunimi: anëtarët e komisioneve të kuvendit duhet të zhvillojnë marrëdhënie të punës me trupat tjerë të mbikqyrjes, dhe në kuadër të Kuvendit dhe jashtë prej tij – me Avokatin e popullit, Këshillin civil për mbikqyrje, Drejtorinë për siguri të informatave të klasifikuara, Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Entin shtetëror për revizion.

5.3 ROLI I SHOQËRISË CIVILE NË MBËSHTETJE TË MBIKQYRJES DEMOKRATIKE MBI ZBULIMIN

Mediat, institucionet akademike dhe organizatat (tink-tanket), si dhe spektri i gjërë i organizatave të shoqërisë civile të fokusuar në sektorin e sigurisë dhe/ose çështjet e të drejtave të njeriut, sigurojnë mbikqyrje publike mbi çështjet e zbulimit. Në vitet e fundit, pas zbulimeve të Snowden, qytetarët e interesuar janë bërë të vetëdijshëm për punët të cilat janë të njohura mirë në politikën ndërkombëtare: shërbimet sekrete kanë kapacitet që të sulmojnë hapësirën informative në mënyrë joselektive dhe masovike. Kjo vetëdije e sapo-fituar ka sjellur deri te mobilizimi i organizatave të shoqërisë civile të cilat janë angazhuar në mënyrë gjithnjë e më të interesuar dhe më të zëshme në mbikqyrjen mbi zbulimin dhe sigurinë, aktivitete që në mënyrë të shkallëzuar zhvillon ekspertizën dhe kredibilitetin e tyre.

Qytetarët respektivisht publiku mund të kryejë presion të drejtëpërdrejtë politik mbi parlamentin dhe qeverinë, ndërsa mediat luajnë rol themelor në rritjen e vetëdijes publike, duke drejtuar vetëdijen e qeverisë në temat e rëndësishme dhe duke ekspozuar keqpërdorimin në zbulim. Skandalet mund të sjellin deri te hetimi dhe të rezultojnë me reforma të cilat përmirësojnë llogaridhënien dhe efektivitetin e zbulimit. Deputetët kanë mundësinë që të ngrejë vetëdijen përmes mediave dhe të kryejnë presion mbi qeverinë për ndryshimin e politikave dhe praktikës. Fuqia e presionit nga mediat sot është shumë e madhe, kjo është mënyra më e shpejtë dhe më efikase për të kryer presion mbi qeverinë.

Mbikqyrja publike duhet të përballlet me dilemën se ata që dijnë nuk flasin dhe atë të cilët flasin nuk dijnë. Me të vërtetë, sundimi i fshehtësisë është një problem i madh për ata që janë jashtë rrethit të fshehtësisë të japin vërejtje përkatëse për shërbimet e sigurisë, por ka shumë shembuj në të cilat vula, institucionet akademike, OJQ-të, luajnë rol të rëndësishëm në debatin publik për sigurinë. Është më lehtë në vendet në të cilat ekziston tradita të kulturës të sigurisë, por gjithashtu edhe kulturës të të drejtave të njeriut e cila mirëmban qëndrimet në ekuilibër.

Në demokracitë më të reja, përgjegjësia është e komisioneve për mbikqyrje që të kontribuojnë

për zhvillimin e kulturës politike dhe qytetare dhe të luajnë rolin e portalit ndërmjet botës të mbyllur të shërbimeve dhe publikut. Duhet të ndihmojnë që të tejkalohet dyshimi tradicional, i përbashkët ndërmjet shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore, sidomos për ata të cilat punojnë në fshehtësi.


Organizatrat civile mund të sigurojnë një analizë të pavarur të legjislacionit, politikave dhe praktikave në lidhje me punën e shërbimeve të zbulimit. Ata mund të prezantojnë opsione të ndryshme për politikën, që të identifikojnë zbrazëtirat në legjislacionin ekzistues dhe/ose të prezantojnë një analizë krahasuese të aspekteve të caktuara të zbulimit. Anëtarët e SHC zakonisht shqyrtojnë legjislacionin dhe politikën në mënyrë jopartiake, nga aspekti i mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare për qeverisjen e mirë. Ata, gjithashtu, mund të nxisin shqyrtimin publik të prioritetëve, politikave dhe nevojave për ndryshimin e legjislacionit. SHC mund të avokojnë përfshirjen e pakicave në punën e shërbimeve të zbulimit apo shërbimet me ndjeshmëri gjinore.

› CILAT JANË KUSHTET PËR MBIQYRJE PUBLIKE EFEKTIVE?

Efektiviteti i mbikqyrjes publike varet nga qasja në informatat e sigurta. Rregullat ligjore për klasifikimin e informatave duhet të pajtojnë llogaridhënien dhe transparencën me nivelin e arsyeshëm të fshehtësisë, për shembull përmes:

- **Ligjeve për liritë e informimit** të cilat i mundësojnë publikut qasje deri te të dhënat të cilat i ruan Qeveria;
- **Orari për klasifikim** i cili në mënyrë të qartë përcakton se cili, në cilin rast dhe sa gjatë informatat mund të ruhet në fshehtësi, duke përfshirë edhe kornizën kohore të caktuar për deklasifikimin e saj;
- **Mbrojtja e lajmëtarëve** me të çrast i mundësohet personelit të zbulimit që të zbulojë informata të cilat tregojnë parregullsi në punën e trupave të caktuar të brendshëm dhe të jashtëm pa frikë nga dënimi se shkelin detyrimin për respektimin e besueshmërisë dhe dëgjueshmërisë.

6



SHTOJCAT

6.1. SHTOJCA A: FJALORI I NOCIONEVE

Hulumtimet anketuese – hetimi i thellë për çështje të interesit të veçantë. Hetimet gjithmonë realizohen në kuadër të mandatit specifik dhe të ngushtë që e përkufizon temën, vëllimin dhe kornizën kohore; më së shpeshti ata zbatohen nga komisionet speciale ad-hok. Hetimet anketuese janë mjeti më agresiv dhe më efikas për hetimet, që është në dispozicion të parlamentit: komisionet hetuese kanë autorizime hetuese të ngjajshme me ato të gjykatave dhe prokurorëve publik (autorizim të thirrur individë). Autorizimet e tyre për thirrje i referohen personave zyrtarë, qytetarëve, subjekteve publike dhe private; ata shpesh kanë pushtet që të zbatojnë ftesat e tyre dhe të sanksionojnë ata që nuk do të paraqiten. Hetimet anketuese shpesh shqyrtojnë keqpërdorimet qeveritare, qeverisjen e keqe, jo aktivitetin apo veprimin jo të drejtë apo sjelljen e keqe nga ana e politikanëve dhe nëpunësve shtetëror.

Vetingu – vetingu ka për qëllim që të bind trupat qeveritare se individ nuk është përfshirë në spiunazh, terrorizëm, sabotazh apo aktivitete të parapara për të rrëzuar apo minuar demokracinë parlamentare me mjete politike, industriale apo të dhunshme. Gjithashtu, e bind departamentin se individ nuk ka qënë anëtar apo i lidhur me organizatën që ka bërë konspiracion për aktivitete të tilla apo se nuk ka treguar mungesë të sigurisë përmes pandershmërisë, mungesës **të integriteti apo sjelljes. Përfundimisht, procesi e bind departamentin se individ nuk do i nënshtrohet presionit apo ndikimit jo të drejtë përmes sjelljes të kaluar apo rethanave personale.**¹⁰⁵

Kontrolli i brendshëm – rregulla, procese, dhe struktura organizative në kuadër të shërbimit të zbulimit të cilat sigurojnë që personeli të punojë në mënyrë profesionale dhe efektive në kuadër të autorizimeve të tyre, në pajtim me ligjin dhe me respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe barazinë gjinore. Kontrolli i brendshëm është funksioni i përgjegjësisë të qeverisjes.

Sistemi elektronik i regjistrimit – regjistri që automatikisht ruan shënimin/logot (në teksin e mëposhtëm log), që përsërit aktivitetet e kryera në komunikimin e inçizuar, në pajtim me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve. Inçizimi automatik paraqet një inçizim sistematik të logove, me intervenim më të vogël njerëzorë. Logot duhet të jenë të disponueshme dhe të lexueshme për shkak të mbikqyrjes dhe kontrollit.

Kontrolli ekzekutiv – në demokraci, pushteti ekzekutiv zakonisht ka dy përgjegjësi kryesore kontrolluese mbi zbulimin: (1) mundësimi i efektivitetit operativ të shërbimeve – përmes përkufizimit të politikave, prioritetëve, dhe buxheteve gjithëpërfshirëse, miratimi i operacioneve të ndjeshme, hetimi i rasteve të dyshimit për zbatimin e keq dhe (2) përgjegjësia politike para parlamentit dhe qytetarëve **për të siguruar një sjellje efektive, llogaridhënëse dhe ligjore të shërbimeve të zbulimit. Puna autonome e shërbimeve të zbulimit, shpeshherë është nën kontrollin e drejtëpërdrejtë të pushtetit ekzekutiv, përmes zyrës të kryetarit apo kryerministrit apo trupit të përbashkët ekzekutiv, siç është këshilli këshilldhënës për sigurinë nacionale. Funksionet e zbulimit të vendosura në institucionet siç janë ushtria apo agjencitë për zbatimin e ligjit zakonisht mbikqyren nga ana e ministrive resore apo njërive, siç janë mbrojtja, drejtësia apo punët e brendshme.**

Metodat ndërhyrëse për grumbullimin e informatave – masat për grumbullimin e informatave që shkelin deri në një shkallë të caktuar të drejtat e njeriut të garantuar me ligj dhe

¹⁰⁵ Politika për veting e Qeverisë të Britanisë të Madhe <https://publications.parliament.uk/pa/cm199495/cmhansrd/1994-12-15/Writtens-4.html>

kushtetutë, sidomos të drejtën e privatësisë. Ata përdoren për grumbullimin e dëshmive në hetimet penale nga policia dhe prokuroria (të bazuara në ligjin për procedurën penale) apo për parandalimin e kërcënimit për sigurinë nacionale nga ana e shërbimeve të zbulimit (të bazuara në ligjin për shërbimet e zbulimit, sigurinë nacionale apo ligjet tjera të veçanta siç janë ligjet për ndjekjen e komunikimeve).

Informatat – info-përmbajtja komplekse (njohuria) dhe koleksioni i të dhënave në mënyrë logjike.

Klasifikimi (nivelet e klasifikimit) – nivelet e klasifikimit përdoren për të caktuar se sa të ndjeshme janë informatat e caktuara. Institucionet europiane, NATO dhe shumica e shteteve europiane kanë katër nivele: sekret shtetëror, rreptësisht e besueshme, e besueshme, interne. Qeveria e SHBA-së përdor tre nivele të komunikimit: e besueshme, rreptësisht e besueshme dhe sekret shtetëror. Nivelet e klasifikimit dhe mbrojtja e tyre janë proporcionale me dëmin e shkaktuar për interesat nacionale me qasjen jo të autorizuar apo përdorimin jo të autorizuar të informatave.

Informatat e klasifikuara – materiali për të cilin trupi qeveritar konsideron se është informatë e ndjeshme që duhet të mbrohet. Qasja është e kufizuar me ligj apo rregullativë për grupet e caktuara të njerëzve me certifikat të nevojshëm të sigurisë dhe sipas nevojës që të dijë, kurse përdorimi i keq me materialin mund të tërheq dënime penale.

Komunikimi – dhënia apo shkëmbimi i informatave ndërmjet njerëzve përmes të shprehurit, zërit, dritës, tekstit të shkruar, vizatimit, fotografisë, lëndës apo gjesteve, si dhe procesi teknik i dërgimit, përcjelljes dhe pranimit të çfarëdo lloji të shprehjes, të dhënave, zërat, sinjalet, teksti i shkruar, fotografia statike dhe e lëvizshme, të cilat shërbejnë për shkëmbimin e informatave ndërmjet njerëzve dhe objekteve, ndërmjet objekteve apo menaxhimi me cilindo objekt me ndihmën e sistemit të telekomunikimit, protokoli nga Interneti, protokoli nga interneti përmes zërit, ueb faqja dhe e-posta.

Kontrolli i sektorit të zbulimit – pushteti për menaxhimin dhe zhvillimin e shërbimit të zbulimit; e realizon shërbimi i zbulimit mbi veten (e zbaton në mënyrë hierarkike udhëheqësia dhe mekanizmat për kontrollin e brendshëm) dhe/ose ministria e autorizuar dhe personeli i tij (kontrolli ekzekutiv). Mund të përfshijë kontrollin e brendshëm, por nuk përfshin dhe nuk mund të zëvendësojë mbikqyrjen e jashtme.

Logot – datoteka apo datotekat që krijohen në mënyrë automatike, inçizojnë apo ruajnë serverin në regjistrin elektronik, përmbajnë të dhënat për të gjithë aktivitetet e kryera, subjektin që i ka krijuar, numrin telefonik, IP adresën apo identifikimin tjetër teknik, fillimin dhe fundin e aktivitetit.

Masat për ndjekjen e komunikimeve – mbikqyrja dhe inçizimi i telefonit dhe komunikimeve tjera elektronike; mbikqyrja dhe inçizimi i enterierëve, hapësirave të mbyllura dhe objektetve; hyrja në objekte, hapësirat e mbyllura dhe objekte me qëllim të krijimit të kushteve për zbatimin e masës; mbikqyrje dhe inçizim vizual i personave të hapësirës të hapur dhe në vende publike; mbikqyrje dhe audio inçizim të përmbajtjes të komunikimeve të personave në hapësirë të hapur dhe në vende publike.

Mbikqyrja – nocioni gjithëpërfshirës që përfshin kontrollin ex ante, ndjekja vijuese dhe pasqyra ex post, si dhe vlerësimi i hetimit.

Organet kompetente për zbatimin e masave të ndjekjes të komunikimeve për shkak të mbrojtjes të interesave të sigurisë nacionale dhe mbrojtjes: Agjencia e sigurisë nacionale, Shërbimi ushtarak për siguri dhe zbulim (në kuadër të Ministrisë të mbrojtjes), Qendra për vëzhgimin elektronik (për radio valët HF, VHF, dhe UHF).

Organet kompetente për zbatimin e masës të posaçme hetuese – prokurori publik dhe policia gjyqësore.

Llogaridhënia – koncepti sipas të cilit një subjekt ka të drejtë që të konsiderojë subjektin tjetër përgjegjës për përmbushjen e koleksionit të standardeve, të gjykojë për përmbushjen e përgjegjësi të tij dhe të përcaktojë dënimin nëse ato përgjegjësi nuk janë përmbushur.

Oficeri për mbrojtjen e informatave të klasifikuara – për kryerjen efikase dhe të koordinuar të të drejtave dhe detyrimeve të cilat i referohen informatave të klasifikuara, në organet e pushtetit shtetëror dhe lokal të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës të Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, personat juridik të themeluar nga Republika apo nga komunat, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe personat tjerë juridik, dhe përcakton një apo më shumë oficerë për siguri të informatave të klasifikuara.

Mbikqyrja parlamentare – i referohet ndjekjes vijuese, kontrollimit, vlerësimit dhe hetimit të aktiviteteve të agjencive qeveritare dhe publike, duke përfshirë edhe zbatimin e politikës, legjislacionit, dhe shpenzimeve nga buxheti shtetëror. Mbikqyrja parlamentare është një nga manifestimet më të rëndësishme të ndarjes të pushtetit në demokraci.

E dhëna – të thjeshta, info-përmbajtje e papërpunuar që ka kuptim të caktuar. Ajo është krijuar dhe bartur në formë të kuptueshme për ndonjë personalitet (tekst, fotografi, zë etj.).

Masat/teknikat e veçanta të hetimit – masat për grumbullimin e informatave që shkelin të drejtën e privatësisë, të marra në mënyrë të fshehtë nga ana e organeve të ndjekjes penale për grumbullimin e dëshmive në hetimet penale dhe të themeluara në Kodin penal/Ligjin për procedurë penale. Në Maqedoninë e Veriut, llojet e veçanta të masave hetimore janë të përshkruara në nenin 252 në Ligjin për procedurë penale.

Përgjimi dhe inçizimi telefonik dhe komunikimet elektronike – marrja e fshehtë e përmbajtjes të procesit teknik të dërgimit, bartjes dhe pranimit të çfarëdo lloji të shprehjes, të dhënave, zërit, sinjalit, tekstit të shkruar, fotografia statike dhe e lëvizshme, të cilat shërbejnë për shkëmbimin e informatave ndërmjet njerëzve, ndërmjet njerëzve dhe objekteve, ndërmjet objekteve apo menaxhimit me cilindo objekt me ndihmën e sistemit të telekomunikimit, protokollit të internetit, zëri përmes protokollit të internetit, ueb faqja dhe e-posta, me qasjen në pajisjen teknike të operatorëve dhe krijimin paralel të shënimit teknik për përmbajtjen e komunikimit, me mundësi për riprodhim.

Parimi “nevojitet që të dijë” – qasja deri te informatat e klasifikuara zakonisht rregullohet përmes parimit “nevojitet që ta dijë”, që do të thotë se deputetët kanë qasje deri te informatat e klasifikuara që janë rreptësisht të nevojshme vetëm në kuadër të detyrimeve të tyre profesionale. Madje edhe nëse deputeti, i ka të gjithë miratimet e nevojshme zyrtare, ai apo ajo nuk duhet të fitojë qasje deri te informatat specifike përveç nëse përdor privilegjet e tij për shfrytëzimin e parimit “nevojitet që të dijë”. Ky parim ka për qëllim që të dekurajojë “shfletimin” e panevojshëm të materialit të ndjeshëm apo keqpërdorimin e informatave të klasifikuara për përdorim personal.

Zbulimi – procesi i përbërë nga masat, aktivitetet dhe procedurat e ndërmarra për: grumbullimin, dokumentimin, përpunimin analitik të të dhënave dhe informatave dhe përdorimin e tyre për qëllimin e caktuar.

Bashkësia e zbulimit – përfshin të gjithë shërbimet shtetërore dhe njësitë të cilat kryejnë aktivitete të zbulimit dhe punojnë në mënyrë të ndarë dhe bashkarisht për mbështetjen e sigurisë nacionale dhe parandalimin e kërcënimeve për sigurinë nacionale në një vend. Në shumë vende, shërbimi i zbulimit nuk është vetëm koncept, por edhe strukturë organizative me detyrën që të sigurojë bashkëpunimin funksional ndërmjet shërbimeve

të zbulimit, duke përfshirë edhe koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta operative dhe informative; ata mund të integrojnë informata të prodhuara nga shërbimet e ndryshme që të gjenerojnë një prodhim koherent, të vazhdueshëm të zbulimit, me të cilin kontrollohet shkalla e përplasjes në zbulim dhe sigurohet plotësimi, vërtetimi apo jovaliditeti i informatave. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, bashkësia e zbulimit është përbërë nga: Agjencia e sigurisë nacionale, Agjencia e zbulimit dhe njësi kompetente e zbulimit për sigurinë ushtarake dhe zbulimi në kuadër të Ministrisë të mbrojtjes, respektivisht shërbimi ushtarak për siguri dhe zbulim (SHUSZ).

Sektori i zbulimit – të gjithë shërbimet e sigurisë-zbulimit (bashkësia e zbulimit-sigurisë), subjektet speciale shtetërore dhe njësitë në kuadër të ministrive të cilat merren me aktivitete të zbulimit.

Shërbimet e zbulimit – organizatat shtetërore të cilat grumbullojnë, përpunojnë dhe analizojnë informata të lidhura me kërcënimet për sigurinë nacionale, me qëllim që të prodhojnë dhe shpërndajnë raporte “të zbulimit” të cilat informojnë bartësit e vendimeve. Ata shpesh realizojnë misione dhe detyra të fshehta dhe kanë mandatin ligjor të përdorin metoda ndërhyrëse për grumbullimin e informatave. Ata mund të jenë një agjenci tërësisht e pavarur apo njësi në ministri (siç është mbrojtja, punët e brendshme, drejtësia). Ata kanë emra të ndryshëm: shërbimi i sigurisë, shërbimi i zbulimit, agjencia e zbulimit, shërbimi i zbulimit dhe sigurisë.

Revizioni – vlerësimi i pavarur i raporteve financiare apo raporteve të konsoliduara dhe informatat financiare, me qëllim të shprehjes të mendimit në lidhje me kredibilitetin dhe anshmërinë e tyre, dhe harmonizimin e tyre me kornizën e pranuar për njoftimin financiar.

Afati i klasifikimit – përkufizoni se çfarë, kur dhe sa kohë informatat mund të ruhen në fshehtësi, duke përfshirë edhe kornizën e caktuar kohore për deklasifikimin e tyre.

Dëgjimi – dëgjimi është procedura para gjykatës apo trupit tjetër për marrjen e vendimeve, siç është komisioni parlamentar. Dëgjimet kanë për qëllim që të grumbullojnë informatat, dëshmitë, mendimet profesionale apo arsyetimin e hollësishëm që nevojitet që komisioni parlamentar të marrë vendime të informuara për legjislacionin dhe çështje tjera; nëpunësit qeveritarë, ekspertët e pavarur, e madje edhe qytetarët privat mund të thirren në dëgimin e kuvendit. Në disa vende, ligjet apo rregullorja bën dallim ndërmjet shqyrtimeve konsultative (apo ligjvënëse) dhe shqyrtimeve mbikqyrëse.

Autorizimet speciale – funksione të autorizuar me të cilat shërbimet e zbulimit duhet të grumbullojnë informata, siç është fuqia për përgjimin e komunikimeve, të kryejnë mbikqyrje të fshehtë, të përdorin informata të fshehta dhe agjentë të fshehtë, fuqia për të hyrë në mënyrë të fshehtë nëpër shtëpi, etj. Disa shërbime të zbulimit mund të kenë (në rethana të përkufizuara qartë me ligj dhe për pengimin e kërcënimeve të caktura për sigurinë nacionale) forma të autorizimit policor që u mundësojnë të kërkojnë, arrestojnë apo paraburgosin njerëz.

Mjetet për ndjekjen e komunikimeve – mjetet elektronike, mekanike apo mjetet tjera teknike që përdoren për të njohur (kuptuar) apo inçizuar përmbajtjen e cilitdo komunikim.

Supervizioni – mbikqyrja apo ndjekja e punës në segmentin e caktuar në funksion të institucionit apo personit juridik (psh. Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale, kryen supervizion në pjesën e mbrojtjes të të dhënave personale).

Mbikqyrja e fshehtë – ndjekja dhe vëzhgimi/dëgjimi i personave, lëvizjet e tyre, komunikimet

(fizike apo elektronike) dhe aktivitetet tjera të inçizimit të aktiviteteve të tilla pa njohjen e tyre.

Telekomunikimi – secili transmetim i shenjave, sinjaleve, fotografive, zërave, të dhënave të çfarëdo natyre, të transmetuara në tërësi apo pjesërisht përmes telave, në formë elektromagnetike, fotoelektrike apo sistemit foto-optik.

6.2. SHTOJCA B: PASQYRA E LEGJISLACIONIT MAQEDONAS PËR MBIKQYRJEN PARLAMENTARE

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS TË MAQEDONISË SË VERIUT

Neni 68

Kuvendi i Republikës të Maqedonisë së Veriut:

[...]

- bën zgjedhjen, emërimin, dhe shkarkimin edhe të bartësve të tjerë të funksioneve publike dhe funksioneve tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj;
- ushtron kontroll dhe mbikëqyrje politike mbi Qeverinë dhe mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike të cilët përgjigjen para Kuvendit.

[...]

Neni 76

Kuvendi themelon trupa punuse të përhershme dhe të përkohshme. Kuvendi mund të themelojë komisione anketuese për të gjitha fushat dhe për çdo çështje me interes publik. Propozimin për themelimin e komisionit anketues mund të paraqesin së paku 20 deputetë. Kuvendi themelon komision të përhershëm anketues për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit. Të dhënat e komisioneve anketuese janë bazë për iniciimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë për bartësit e funksioneve publike.

LIGJI PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS TË MAQEDONISË SË VERIUT

Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 104/2009

V. MBIKQYRJA PARLAMENTARE

Debatet mbikqyrëse

Neni 20

(1) Debati mbikqyrës mbahet me qëllim që të merren informata dhe mendime profesionale për çështjet nga fushëveprimi i trupit punues në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës, zbatimin e ligjeve dhe aktiviteteve të tjera të Qeverisë dhe të organeve të administratës shtetërore.

(2) Debatin mbikqyrës e zbaton trupi punues amë i Kuvendit i cili në mbledhje mund të ftojë përfaqësues të autorizuar të Qeverisë ose të organeve të administratës shtetërore dhe të kërkojë prej tyre informata dhe sqarime të cilat janë objekt i debatit mbikqyrës.

(3) Në debatin mbikqyrës mund të ftohen edhe persona të tjerë të cilët mund të japin informata për çështjet të cilat janë objekt i debatit mbikqyrës.

(4) Përfaqësuesit e autorizuar të ftuar janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje në të cilën do të mbahet debati mbikëqyrës.

(5) Për mbajtjen e debatit mbikëqyrës, kryetari i trupit punues e njofton Kryetarin e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit për mbajtjen e debatit mbikëqyrës e njofton me shkrim Qeverinë. Me njoftim Kryetari i Kuvendit do të kërkojë që Qeveria të caktojë një ose disa përfaqësues të autorizuar për çështjet të cilat janë objekt i debatit mbikëqyrës.

(6) Kryetari i trupit punues amë përfaqësuesin e autorizuar të Qeverisë ose të organeve të administratës shtetërore i fton me shkrim në mbledhjen e trupit punues në të cilën do të mbahet debati mbikëqyrës dhe e njofton për çështjen e cila është temë e debatit dhe mund të kërkojë nga ai që informatat, mendimet dhe qëndrimet t'i paraqesë edhe në formë të shkruar më së voni tri ditë para mbajtjes së mbledhjes të trupit.

(7) Mjetet për mbajtjen e debateve mbikqyrëse sigurohen nga mjetet e Kuvendit të parapara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë.

(8) Për mbajtjen e debatit mbikqyrës opinioni informohet nëpërmjet ueb-faqes së Kuvendit dhe Kanalit të Kuvendit.

Neni 21

(1) Iniciativë për mbajtjen e debatit mbikëqyrës mund të ngrejë një anëtar i trupit punues amë.

(2) Për mbajtjen e debatit mbikëqyrës trupi i punës vendos me shumicë votash nga numri i pranishëm i anëtarëve, ndërsa së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

(3) Nëse 15 deputetë në formë të shkruar kërkojnë mbajtjen e debatit mbikëqyrës, nëpërmjet Kryetarit të Kuvendit kryetari të trupit punues, atëherë kryetari i trupit punues është i obliguar që menjëherë të thërrasë mbajtjen e tij.

(4) Kryetari i Kuvendit me nënkryetarët dhe koordinatorët e grupeve të deputetëve, kryetari dhe anëtarëve të trupit punues mund t'u japë rekomandim për mbajtjen e debateve mbikëqyrëse të caktuara.

Neni 22

(1) Gjatë debatit mbikëqyrës, anëtarët e trupit punues amë dhe deputetët të cilët nuk janë anëtarë të trupit punues amë mund t'u parashtrojnë pyetje përfaqësuesve të autorizuar të Qeverisë ose të organeve të administratës shtetërore të ftuar në debat, vetëm në lidhje me çështjen e cila është objekt i debatit.

(2) Gjatë debatit mbikëqyrës, me personat e ftuar të cilët i sigurojnë informatat mund të mbahet diskutim vetëm nëse është e domosdoshme që të harmonizohen ose të qartësohen çështje dhe fakte konkrete.

(3) Trupi punues amë vendos për kohëzgjatjen e debatit me çrast sigurohet pjesëmarrja e çdo anëtari të trupit punues amë në debat.

Neni 23

(1) Debati mbikëqyrës, sipas rregullit, inçizohet në mënyrë fonografike dhe për të njëtin mbahet procesverbal, ndërsa përmirësimet teknike dhe të tjera mund të bëhen në marrëveshje dhe në pajtim me personin, deklarata e të cilit është në pyetje.

(2) Trupi punues i paraqet Kuvendit raport për debatin e mbajtur mbikëqyrës në të cilin është përfshirë esenca e diskutimeve, ndërsa mund të propozojë edhe konkluzione të cilat i dorëzohen edhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(3) Konkluzionet nga debati publik publikohen në ueb-faqen e Kuvendit.

LIGJI PËR AGJENCINË PËR ZBULIM

Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 19/1995

II MBIKQYRJA MBI PUNËN E AGJENCISË

Neni 9

Kuvendi i Republikës të Maqedonisë së Veriut bën mbikqyrje mbi punën e Agjencisë përmes Komisionit përkatës (në tekstin e mëposhtëm: Komisioni).

Neni 10

Komisioni dorëzon deri te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut raportin për punën e kryer më së shumti një herë në vjet. Para dorëzimit të raportit nga paragrafi 1 i këtij neni, Komisioni është i detyruar që të dorëzojë raportin deri te drejtori i Agjencisë për marrjen e mendimit të tij, dhe sidomos nga aspekti i mbrojtjes të fshehtësisë të pjesëve të caktuara të tij.

Neni 11

Drejtori është i detyruar që të mundësojë këqyrje dhe të jap të gjithë njoftimet dhe të dhënat nga fushëveprimi i punës të Komisionit. Njoftimet dhe të dhënat e paraqitura në seancën e Komisionit konsiderohen sekret shtetëror.

Neni 12

Konkluzionet në lidhje me raportin e punës të Komisionit, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut i dorëzon deri te presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

LIGJI PËR MBROJTJE

Teksti i spastruar jozyrtar

Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 42/2001, 05/2003, 58/2006, 110/2008, 51/2011, 151/2011, 215/2015, 42/2020, Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës të Maqedonisë V.nr.37/2002 (Gazeta zyrtare nr. 73/2002) dhe V.nr.135/2002 dhe 155/2001 (Gazeta zyrtare nr. 78/2002)

KREU III: KOMPETENCAT E ORGANEVE TË PUSHTETIT SHTETËROR

Neni 17

Në realizimin e mbrojtjes Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut:

1) bën mbikqyrje mbi realizimin e kompetencave të Qeverisë në mbrojtje dhe e ndjek gatishmërinë për mbrojtjen e Republikës;

2) përcakton ekzistimin e rrezikut të drejtëpërdrejtë të luftës nga sulmi mbi Republikën;

3) shpall paraqitjen dhe përfundimin e gjendjes të luftës;

4) vendos për lartësinë e mjeteve të nevojshme për mbrojtje;

5) miraton buxhetin e Republikës për gjendjen e luftës;

6) miraton vendim për anëtarësim dhe për tërheqje të anëtarësimit të Republikës nga sistemet kolektive të sigurisë dhe mbrojtjes;

7) ratifikon marrëveshje ndërkombëtare të cilat i referohen hyrjes, kalimit apo qëndrimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës për ushtrime, trajnime, pjesëmarrje në operacione ndërkombëtare, në misione dhe operacione të NATO-s dhe në zbatimin e të drejtës në vetëmbrojtje individuale apo kolektive dhe operacione për menaxhimin e krizës dhe sigurisë bashkëpunuese, si dhe pjesëmarrje në ato aktivitete dhe operacione të anëtarëve të Armatës dhe të punësuarve në Ministrinë e mbrojtjes jashtë vendit;

7-a) ratifikon marrëveshje ndërkombëtare të cilat i referohen vendosjes dhe qëndrimit të komandave, shtabeve, njësive luftarake të organizatave ndërkombëtare në territorin e Republikës;

7-b) miraton vendim për dërgimin e kërkesës deri te NATO për ndihmë për mbrojtjen e Republikës;

7-c) vendos për dërgimin e anëtarëve të Armatës dhe të punësuarit në Ministrinë e mbrojtjes jashtë territorit të Republikës për pjesëmarrje në operacionet ndërkombëtare;

8) miraton Strategjinë nacionale të sigurisë;

8-a) miraton Plan afatgjatë për zhvillimin e aftësive mbrojtëse;

8-b) miraton dokumente për funksionimin e Kuvendit në gjendje të luftës;

9) shpall ditën e Armatës dhe

10) miraton përfundime dhe rezoluta në lidhje me realizimin e sistemit të mbrojtjes, planet për zhvillim të mbrojtjes, pajisjes dhe gatishmërisë luftarake të Armatës.

Raportin sipas akteve të përmendura në pikën 10 të këtij neni e dorëzon Qeveria pas kërkesës të Kuvendit apo të paktën në dy vite.

Për shkak të njohjes me aktivitetet e Armatës, deputeti në Kuvend mund të kërkojë nga Ministria e mbrojtjes të organizojë vizitën e tij të njësive, komandave dhe shtabeve të Armatës.

LIGJI PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE

Gazeta zyrtare e Republikës të Maqedonisë nr. 71/2018

IV. MBIKQYRJA DHE KONTROLI MBI ZBATIMIN E MASAVE PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE

1. Trupat mbikqyrëse për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve

Trupat mbikqyrëse

Art. 35

(1) Mbikqyrje mbi masat për ndjekjen e komunikimeve që zbatohen nga organet e autorizuar, si dhe mbikqyrje mbi operatorët e ATO kryhet nga:

- Kuvendi i Republikës të Maqedonisë së Veriut,
- Drejtoria për sigurim të informatave të klasifikuara,
- Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale dhe
- Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Mbikqyrje mbi masat për ndjekjen e komunikimeve që zbatohen nga organet e autorizuar, si dhe mbikqyrje mbi ATO kryen Këshilli për mbikqyrje civile.

(3) Me kërkesë të trupave të mbikqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni ATO ndihmon në zbatimin e mbikqyrjes mbi operatorët.

(4) ATO në pajtim me Ligjin për agjencinë teknike-operative në mënyrë të pavarur apo me kërkesë nga organet e autorizuar kryen mbikqyrje profesionale mbi operatorin.

Detyrimi për ruajtjen e sekretit shtetëror

Neni 36

(1) Personat në trupat mbikqyrës nga neni 35 i këtij ligji dhe ekspertët nga neni 39 i këtij ligji janë të detyruar që të ruajnë si sekret zyrtar informatat e klasifikuara duke përfshirë edhe të dhënat personale të cilat kanë ardhur gjatë mbikqyrjes ekzekutive në pajtim me ligj.

(2) Detyrimi nga paragrafi (1) i këtij neni zgjat edhe pas përfundimit të funksionit të tyre në trupat mbikqyrës, respektivisht edhe pas përfundimit të angazhimit të tyre si ekspert për periudhën prej pesë vitesh.

Detyrimet për certifikatën e sigurisë

Neni 37

(1) Personat nga neni 36 paragrafi (1) i këtij ligji janë të detyruar të posedojnë certifikatë të sigurisë me shkallën përkatëse për qasje në informatat e klasifikuara.

(2) Certifikatat e sigurisë nga paragrafi (1) i këtij neni lëshohen në afat jo më të gjatë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të kërkesës, nën kushte dhe procedurë të përcaktuar me ligj.

1.1 Mbikqyrja nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Përbërja e komisionit

Neni 38

(1) Për kryerje të mbikqyrjes nga neni 35 i këtij ligji Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut nga rradha e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, formon Komision për mbikqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimeve (në tekstin e mëposhtëm: Komisioni).

(2) Komisioni përbëhet nga kryetari, katër anëtarë, zëvendës kryetar dhe katër zëvendës anëtar.

(3) Kryetari i Komisionit, respektivisht zëvendësi i tij është nga rradha e partisë politike në Kuvendin e Republikës të Maqedonisë së Veriut në opozitë, e cila në zgjedhjet e fundit parlamentare për deputetë ka marrë më së shumti vota, dy anëtarë të Komisionit, respektivisht anëtarët e tyre janë nga rradhët e partive politike në pushtet dhe dy anëtarë, respektivisht zëvendësit e tyre janë nga rradhët e partive politike në opozitë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Akreditimi i ekspertëve teknik

Neni 39

(1) Komisioni nga neni 38 i këtij ligji për shkak të kryerjes efektive të mbikqyrjes angazhon ekspertë teknik nacional dhe ndërkombëtar, me njohjen e njohurive profesionale përkatëse, të cilët në bazë të akreditimit të tyre, munden që në mënyrë aktive të marrin pjesë në mbikqyrje, si pjesë e Komisionit.

(2) Menjëherë pas formimit të tij dhe jo më vonë se 50 ditë, Komisioni përzgjedh dy ekspertë për mbështetje të përhershme, kurse në afat prej gjashtë muajve përgatit listën e ekspertëve shtesë nacional dhe ndërkombëtar të cilët mund të jenë të akredituar si ekspert për çdo rast individual për periudhën e cila është e nevojshme për përgatitjen, realizimin dhe njoftimin e rezultatit teknik nga mbikqyrja ekzekutive.

(3) Me kërkesë të Komisionit, Agjencia për komunikimet elektronike, Drejtoria për sigurinë e informatave të klasifikuara dhe Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale, organi i autorizuar që nuk është lëndë e mbikqyrjes dhe cildo institucion tjetër shtetëror jep mbështetje ekspertësh për Komisionin për pyetje nga kompetenca e tyre të përcaktuara me ligj, gjatë kohës të kryerjes të mbikqyrjes, në pajtim me këtë ligj.

Qëllimi dhe procedura për kryerjen e mbikqyrjes

Neni 40

(1) Komisioni e kryen mbikqyrjen nga neni 35 i këtij ligji me qëllim që të përcaktohet ligjshmëria e zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve nga neni 7 dhe 18 nga ky ligj, si dhe efektiviteti për zbatimin e masave të posaçme hetimore.

(2) Komisioni dhe ekspertët teknik të akredituar si pjesë e Komisionit, gjatë kryerjes të mbikqyrjes, për shkak të përcaktimit të ligjshmërisë të masave nga paragrafi (1) i këtij neni bëjnë krahasimin e të dhënave nga nenet 41, 42 dhe 43 të këtij neni, të cilat organet e autorizuar, ATO dhe operatorët i kanë në pronësi, i posedojnë apo gjenerojnë.

(3) Komisioni për shkak të përcaktimit të efektivitetit nga paragrafi (1) i këtij neni, në seancë

e shqyrton raportin vjetor të Prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për masat e posaçme hetimore, të cilin Prokurori publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut e dorëzon në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me ligj.

Të dhënat të cilat gjatë kryerjes të mbikqyrjes kërkohen nga operatori

Neni 41

Të dhënat të cilat janë në pronësi, i posedon apo gjeneron operatori dhe të cilat janë në dispozicion me kërkesë të Komisionit apo të cilat drejtëpërdrejtë ndërmerren nga ana e ekspertëve të akredituar teknik si pjesë e Komisionit gjatë kohës të kryerjes të mbikqyrjes janë:

- Logot gjatë kohës dhe datës të fillimit të masës për ndjekjen e komunikimeve,
- Logot gjatë kohës dhe datës të përfundimit të masës për ndjekjen e komunikimeve,
- Logot për konfirmim të aktivizimit,
- Logot për numrin e përgjithshëm të konfirmimeve pozitive të kryera në periudhën e caktuar kohore.

Të dhënat të cilat gjatë kryerjes të mbikqyrjes kërkohen nga ATO

Neni 42

Të dhënat të cilat janë në pronësi, i posedon apo gjeneron ATO, e të cilat janë në dispozicion me kërkesë të Komisionit apo të cilat drejtëpërdrejtë ndërmerren nga ana e ekspertëve të akredituar teknik si pjesë e Komisionit gjatë kohës të kryerjes të mbikqyrjes janë:

- Urdhëri i anonimizuar gjyqësorë dhe urdhëri i anonimizuar i përkohshëm me shkrim,
- Logot për numrin e urdhërit të anonimizuar gjyqësorë,
- Logot gjatë kohës të fillimit dhe mbarimit të zbatimit të masës për ndjekjen e komunikimit,
- Logot për numrin e përgjithshëm të masave të zbatuara për ndjekjen e komunikimeve për periudhën e caktuar kohore.

Të dhënat të cilat gjatë kryerjes të mbikqyrjes kërkohen nga organet e autorizuar

Neni 43

Të dhënat të cilat janë në pronësi, i posedojnë apo gjenerojnë organet e autorizuar, dhe të cilat janë të disponueshme me kërkesë të Komisionit gjatë kohës të mbikqyrjes janë:

- Urdhëri i anonimizuar gjyqësorë dhe urdhëri i anonimizuar i përkohshëm me shkrim dhe
- Dokumentet të cilat i referohen fillimit dhe fundit të zbatimit të masës për ndjekjen e komunikimeve.

Mënyra e kryerjes të mbikqyrjes

Neni 44

(1) Komisioni e kryen mbikqyrjen pa njoftim paraprak, sipas nevojës, dhe të paktën një herë në tre muaj madje edhe në mungesë të shumicës të votave

(2) Pas mbikqyrjes të kryer, Komisioni përgatit raportin për mbikqyrjen e kryer në të cilin shënohet nëse është konstatuar veprimi ligjor apo i kundërligjshëm, respektivisht nëse ekziston keqpërdorimi në veprim.

(3) Në rastet kur në raportin nga paragrafi (2) i këtij neni përcaktohet veprimi i kundërligjshëm, i njëjti dorëzohet në Kuvend të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e për këtë Komisioni e informon publikun.

(4) Në rastet kur gjatë mbikqyrjes të kryer do të vërtetohen parregullsi apo keqpërdorime në procedurën për zbatimin e masave për ndjekjen e komunikimit të përcaktuar me dispozitat e Ligjit për procedurën penale dhe dispozitat e këtij ligji, si dhe shkelja e cilësdo marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën e Republikës të Maqedonisë së Veriut, Komisioni është i detyruar:

- Në afat prej 24 orësh të njoftojë prokurorin publik kompetent,
- Në rast të shkeljes të të dhënave personale apo të drejtave të njeriut i njofton organet kompetente përkatëse,
- Nëse ka mundësi dhe pa përmendur të dhënat konkrete informon Kuvendin e Republikës të Maqedonisë së Veriut,
- Nëse është e mundur dhe pa paraqitjen e të dhënave konkrete e informon publikun.

Raportet e Komisionit

Neni 45

(1) Komisioni dorëzon raportin vjetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin paraprak kalendarik, më së voni deri në fund të shkurtit të vitit rrjedhës.

(2) Raportin nga paragrafi (1) i këtij neni, Kuvendi e shqyrton dhe miraton me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve dhe jep rekomandime për punën e Komisionit.

(3) Sipas nevojës dhe në bazë të kërkesës të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komisioni dorëzon raporte shtesë.

(4) Për raportin nga paragrafi (2) i këtij neni, publiku njoftohet në mënyrë përkatëse.

Rregullorja e punës

Neni 46

Komisioni miraton Rregulloren për punën e tij, me të cilën rregullohen **çështjet për mënyrën e punës të Komisionit**, si dhe mënyra e angazhimit të ekspertëve teknik.

1.2. Këshilli për mbikqyrje civile

Përcaktimi i Këshillit

Neni 47

(1) Me qëllim të kryerjes të mbikqyrjes civile të ligjshmërisë të zbatimit mbi masat e ndjekjes të komunikimeve përcaktohet Këshilli për mbikqyrje civile (në tekstin e mëposhtëm: Këshilli).

Përbërja e Këshillit

Neni 48

(1) Këshilli përbëhet nga kryetari dhe gjashtë anëtarë të cilët i përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhë prej tri vitesh, pa të drejtën e rizgjedhjes.

(2) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs publik për përcaktimin e kryetarit dhe gjashtë anëtarëve prej të cilëve tre janë ekspert dhe tre janë përfaqësues të organizatave joqeveritare (shoqatat) nga fusha e mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sigurisë dhe mbrojtjes.

(3) Kryetari dhe anëtari i Këshillit mund të jetë personi i cili përmbush këto kushte:

- Të jetë shtetas i Republikës të Maqedonisë së Veriut,
- Në momentin e shpalljes të konkursit publik me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësorë nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
- Të ketë fituar të paktën 240 kredi sipas ECTS apo të ketë përfunduar shkallën e VII të arsimit
- Të ketë përvojë pune të paktën shtatë vite në fushën e drejtësisë, telekomunikimit dhe teknologjive informative apo pesë vite përvojë pune në organizata joqeveritare nga fusha e të drejtave të njeriut, sigurisë dhe mbrojtjes.

Ndërprerja e mandatit

Neni 49

(1) Kryetarit dhe anëtarit të Këshillit mund t'i ndërpritet mandati në Këshill për këto arsye:

- Me kërkesë të tij,
- Nëse përgjithmonë e humb aftësinë për kryerjen e funksionit,
- Nëse është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm për veprën penale me dënim me burg pa kusht në kohëzgjatje prej të paktën gjashtë muajsh.

(2) Bazat për shkarkimin e kryetarit dhe anëtarit të Këshillit para përfundimit të mandatit janë:

- Puna jo profesionale dhe jo e përgjegjshme,
- Shkelja e sigurisë të informatave të klasifikuara,
- Keqpërdorimi i të dhënave personale,
- Nëse nuk vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit

Raporti i Këshillit

Neni 50

(1) Këshilli dorëzon në Kuvend të Republikës së Maqedonisë të Veriut raport vjetor për punën e Këshillit për vitin paraprak kalendarik më së voni deri në fund të shkurtit në vitin rrjedhës.

(2) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni shqyrtohet në seancën e Kuvendit të Republikës të Maqedonisë së Veriut.

(3) Sipas nevojës dhe me kërkesë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshilli dorëzon raporte shtesë.

(4) Për raportin nga paragrafi (1) i të këtij neni publiku njoftohet në mënyrë përkatëse.

Acting of the Council

Article 51

Veprimi i Këshillit

Neni 51

(1) Këshilli vepron sipas iniciativës personale apo parashtresës të dorëzuar nga qytetari.

(2) Në bazë të parashtresës të dorëzuar nga qytetari Këshilli është i detyruar:

- menjëherë të dorëzojë kërkesë në Komisionin nga neni 38 i të këtij ligji, të kryejë mbikqyrjen në pajtim me nenin 40 nga ky ligj me qëllim që të sigurohet nëse numri telefonik i qytetarit është apo ka qënë i ndjekur në mënyrë të kundërligjshme në tri muajt e fundit dhe
- të kryejë mbikqyrje në ATO dhe organet e autorizuara.

(3) Komisioni në bazë të mbikqyrjes të kryer nga paragrafi (2) alinea 1 e të këtij neni dorëzon njoftimin në Kuvend në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës.

(4) Për shkak të ruajtjes të besueshmërisë të masave për ndjekjen e komunikimeve, në njoftimin nga paragrafi (3) i këtij neni është përmendur vetëm nëse në rastin konkret është:

- a) konstatuar keqpërdorim apo
- b) nuk është konstatuar keqpërdorim.

(5) Mbikqyrjen nga paragrafi (2) alinea 2 e këtij neni, Këshilli e kryen me njoftimin paraprak në ATO dhe në organet e autorizuara, për të bërë krahasimin e të dhënave nga ekzemplarët e urdhërave për nevojat e mbikqyrjes dhe kontrollit, për periudhën e tre muajve të fundit.

(6) Këshilli në pajtim me njoftimin nga paragrafi (3) i këtij neni dhe mbikqyrja ekzekutive e paragrafit (5) të këtij neni menjëherë e njofton qytetarin nga paragrafi (2) i këtij neni, e nëse në atë rast është konstatuar keqpërdorim, Këshilli i menjëherë e njofton prokurorin publik kompetent.

(7) Kur Këshilli vepron me iniciativë personale, mbikqyrja kryhet në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni.

(8) Për mbikqyrjen e kryer nga paragrafi (7) i këtij neni, Këshilli e njofton publikun.

Rregullorja e punës të Këshillit

Neni 52

Këshilli miraton Rregulloren për punën e tij, me të cilën rregullohen çështjet për mënyrën e punës të Këshillit.

Kushtet e punës të Këshillit

Neni 53

(1) Kushtet hapësinore për punë të Këshillit i siguron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Mjetet financiare për punë të Këshillit sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

1.3. Mbikqyrja nga ana e Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale

Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale

Neni 54

Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale kryen mbikqyrje mbi ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra gjatë përpunimit të të dhënave personale, si dhe mbi zbatimin e masave për mbrojtjen e tyre të përcaktuar me ligj

1.4. Mbikqyrja nga ana e Drejtorisë për sigurinë e informatave të klasifikuara

Drejtoria për sigurinë e informatave të klasifikuara

Neni 55

Drejtoria për sigurinë e informatave të klasifikuara kryen mbikqyrje mbi ligjshmërinë e përdorimit të informatave të klasifikuara të përcaktuar me ligj dhe dispozitat e miratuara në bazë të atij ligji

1.5 Mbikqyrja nga ana e Avokatit të popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Neni 56

Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut kryen mbikqyrje mbi ligjshmërinë e aktiviteteve të ndërmarra gjatë zbatimit të masave për ndjekjen e komunikimeve nga aspekti i mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të njeriut.

LIGJI PËR INFORMATAT TË KLASIFIKUARA

Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 275/2019

Neni 52

Me kërkesë të drejtorisë, kontrollet operative për ekzistim të pengesave të sigurisë për qasje dhe menaxhim me informata të klasifikuara i kryejnë:

- Agjencia për siguri nacionale për të gjithë personat fizikë dhe juridikë, përveç për personat e përcaktuar në alinenë 2 të këtij paragrafi dhe
- Shërbimet kompetente në Ministrinë e Mbrojtjes për të gjithë të punësuarit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 53

Procedura për zbatim të kontrollit të sigurisë zgjat më së shumti deri në:

- Katër muaj për kontroll sigurie të shkallës së parë për personat fizik,
- Gjashtë muaj për kontroll sigurie të shkallës së dytë për personat fizik,
- Gjashtë muaj për kontroll sigurie të shkallës së tretë për personat fizik dhe gjashtë muaj për kontroll sigurie për personat juridik.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, procedura për kontroll sigurie në shkallë të tretë për personat e përcaktuar në trupat mbikqyrës që kryejnë mbikqyrje mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve, si dhe për ekspertët e angazhuar të akredituar nacionalë dhe ndërkombëtarë nga ata trupa në pajtim me Ligjin për ndjekjen e komunikimeve, zgjat një muaj nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, procedura për kontroll sigurie në shkallë të dytë për personat para themelimit të marrëdhënie të punës në Agjencinë teknike-operative, në pajtim me Ligjin për Agjencinë teknike-operative, zgjat një muaj nga dita e parashtrimit të kërkesës.

Neni 57

Drejtori i Drejtorisë mund të miratojë aktvendim për refuzim të kërkesës për lëshim të certifikatës së sigurisë për personat fizikë dhe juridikë nëse nuk janë plotësuar kushtet nga ky ligj.

Në aktvendim nga paragrafi 1 i këtij neni nuk jepet arsyetim për shkaqet për refuzim të kërkesës për lëshim të certifikatës për siguri.

Kundër aktvendimit nga paragrafi 1 i këtij neni personi kërkesa e të cilit është refuzuar mund të parashtrojë ankesë në Komisionin shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies të punës në shkallë të dytë në lidhje me procedurën për lëshim të certifikatës për siguri.

Neni 58

Ankesa nga neni 56 paragrafi 3 dhe neni 57 paragrafi 3 i këtij ligji parashtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, në Komisionin shtetëror për vendimmarrje në

procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies së punës në shkallë të dytë.

Aktvendimi për ankesën nga paragrafi 1 i këtij neni, i miratuar nga Komisioni shtetëror për vendimmarrje në procedurë administrative dhe procedurë të marrëdhënies të punës në shkallë të dytë është përfundimtar.

Article 65

The state and local government bodies established in accordance with the Constitution of the Republic of North Macedonia and by law, legal entities established by the Republic or the municipalities, the City of Skopje and the municipalities in the City of Skopje and other legal entities are obliged to create conditions necessary for the protection of classified information and take measures to eliminate adverse consequences if classified information is disclosed.

For efficient and coordinated execution of the rights and obligations related to the classified information, in the subjects from paragraph 1 of this article, an officer for the security of classified information is appointed.

RREGULLORJA E KUVENDIT TË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË SË VERIUT

III. TË DREJTAT DHE DETYRAT E DEPUTETËVE

5. Interperlanca

Neni 45

(1) Interpelancë mund të paraqesin së paku pesë deputetë për punën e bartësit të funksionit publik, për Qeverinë dhe çdo anëtar të saj veças, si dhe për çështje lidhur me punën e organeve shtetërore.

(2) Interpelanca paraqitet me shkrim, nënshkruhet nga të gjithë deputetët që e paraqesin dhe duhet të përmbajë arsyetim.

(3) Interpelanca i dorëzohet Kryetarit të Kuvendit, i cili menjëherë ia dërgon atij të cilit i është paraqitur dhe deputetëve.

Neni 46

Subjekti, të cilit i është paraqitur interpelanca ka të drejtë që për interpelancën e paraqitur Kryetarit të Kuvendit t'i dërgojë përgjigje me shkrim, më së voni brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të interpelancës.

Neni 47

(1) Interpelanca vihet në rend dite në seancën e parë të rradhës të Kuvendit, pas skadimit të 15 ditëve nga dita e shpërndarjes së përgjigjes deputetëve.

(2) Nëse përgjigja nuk dërgohet brenda afatit të parashikuar me nenin 46 të kësaj Rregulloreje, interpelanca vihet në rend dite në seancën e parë të rradhës të Kuvendit.

Neni 48

(1) Të drejtën për të arsyetuar interpelancën në seancën e Kuvendit e ka njëri nga deputetët që e kanë paraqitur interpelancën, në kohëzgjatje prej 20 minutash.

(2) Subjekti të cilit i është paraqitur interpelanca ftohet në seancë dhe ka të drejtë ta arsyetojë përgjigjen e tij me shkrim ose të jap përgjigje me gojë për interpelancën e paraqitur, në kohëzgjatje prej 20 minutash.

Neni 49

(1) Debat i për interpelancë zgjat një ditë pune deri sa të përfundojë lista e deputetëve të paraqitur për fjalë, kurse vendoset më së voni deri në ora 24.00.

(2) Deputetët për pjesëmarrje në diskutimin e interpelancës, e njoftojnë me shkrim Kryetarin e Kuvendit 24 orë para mbajtjes të seancës.

(3) Rendi i deputetëve sipas grupeve të deputetëve dhe deputetëve të cilët nuk janë organizuar në grup të deputetëve, e të cilët do të marrin pjesë në debat, e përcakton Kryetari i Kuvendit në marrëveshje me koordinatorët e grupeve të deputetëve në mënyrë që do të sigurojë përpjesëtim dy ndaj një në favor të deputetëve të grupeve të deputetëve në opozitë dhe të deputetëve në opozitë të cilët nuk janë të organizuar në grup të deputetëve.

(4) Nëse Kuvendi e aprovon interpelancën, miraton konkluzion në të cilin paraqitet qëndrimi në lidhje me të dhënat në interpelancë.

Neni 50

Deputetët të cilët e kanë paraqitur interpelancën mund ta tërheqin vetëm para fillimit të diskutimit.

Neni 51

Diskutimi për interpelancën ndërpritet, nëse:

- I paraqitet mocion besimi Qeverisë,
- Qeverija jep dorëheqje,
- Kryetari i Qeverisë paraqet propozim për shkarkimin e anëtarit të Qeverisë për punën e të cilit është paraqitur interpelanca, dhe
- Bartësi i funksionit publik paraqet dorëheqje.

XII. MARRËDHËNIET ME QEVERINË

Neni 212

Të besuarit të cilët Qeveria i ka caktuar, marrin pjesë në mbledhjen e trupit punues dhe japin njoftime dhe sqarime për çështjet e rendit të ditës.

Neni 213

Kuvendi ushtron kontroll politik dhe mbikqyrje mbi Qeverinë, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me Kushtetutë dhe me këtë Rregullore.

KOMISIONI PËR MBROJTJE DHE SIGURI

Komisioni ka kryetar, dymbëdhjetë anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

Komisioni i shqyrton pyetjet të cilat i referohen:

- Mbrojtjes të rregullit të përcaktuar me Kushtetutë;
- Realizimit të mbikqyrjes në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;
- Mbrojtjes të Republikës dhe mbrojtjes civile;
- Bashkëpunimit me sistemet kolektive të sigurisë dhe mbrojtjes në të cilat është anëtarësuar Republika;
- Integritetit të Republikës në organizatat euroatlantike dhe marrëdhëniet e Republikës me ato organizata;
- Mbrojtjes të jetës, sigurisë personale dhe pronës të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë;
- Prodhimit, qarkullimit, furnizimit, posedimit dhe mbajtjes të armëve, pjesëve të armëve dhe municionit;
- Sigurimit të personalitetit dhe objekteve;
- Shtetësisë;
- Mbjatjes të rendit publik dhe qetësisë;
- Tubimeve publike dhe ngjarjeve publike;
- Sigurisë të qarkullimit rrugor, ajro, hekurudhor dhe liqenor;
- Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe epidemitë;
- Lajmërimit dhe çlajmërimit të vendbanimit dhe vendqëndrimit;
- Kalimit të kufijve shtetëror dhe lëvizjes dhe qëndrimit në brezin kufitar;
- Lëvizjes dhe qëndrimit të të huajve;
- Përcaktimit dhe zgjidhjes të incidenteve kufitare dhe shkeljes tjetër të kufijve shtetëror,
- Vendosi të bashkëpunimit ndërkombëtarë për çështjet që i referohen mbrojtjes dhe sigurisë dhe
- Pyetjeve tjera që i referohen mbrojtjes dhe sigurisë.

KOMISIONI PËR MBIQYRJE MBI PUNËN E AGJENCISË TË SIGURISË NACIONALE DHE AGJENCISË PËR ZBULIM

Komisioni ka kryetar, tetë anëtarë dhe zëvendës të tyre.

Komisioni i diskuton pyetjet që i referohen:

- Respektimit të të drejtave dhe lirive, të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligjet nga ana e Agjencisë të sigurisë nacionale dhe Agjencisë për zbulim të qytetarëve, ndërmarrjeve dhe personave juridik tjerë;
- Ligjshmërisë në zbatimin e autorizimeve në Agjencinë e sigurisë nacionale dhe Agjencinë për zbulim nga aspekti i tejkalimit të autorizimeve, ndërmarrja e procedurave jo të autorizuara, keqpërdorimi dhe gjërat tjera negative në punë, në kundërshtim me të drejtat e tyre të përcaktuara me ligj;

- Metodave dhe mjeteve që i përdorin Agjencia e sigurisë nacionale dhe Agjencia për zbulim nga aspekti i ligjshmërisë dhe respektimit të të drejtave të qytetarit dhe subjekteve tjera;
- Pajisjeve materiale, kadrovike dhe teknike e Agjencisë të sigurisë nacionale dhe Agjencisë për zbulim,
- Vendosjes të bashkëpunimit ndërkombëtare për pyetjet të cilat i referohen mbikqyrjes të tillë
- Pyetjeve tjera që i referohen Agjencisë të sigurisë nacionale dhe Agjencisë për zbulim.

KOMISIONI PËR MBIKQYRJE MBI ZBATIMIN E MASËS TË POSAÇME HETIMORE NDJEKJE TË KOMUNIKIMEVE NGA ANA E MINISTRISË TË PUNËVE TË BRENDSHME, DREJTORISË TË POLICISË FINANCIARE, DREJTORISË DOGANORE DHE MINISTRISË TË MBROJTJES

The Committee has a Chair, 4 members and 4 Deputy Members.

The Committee reviews issues in regard with:

- Oversight of the implementation of the special investigation measure for interception of the communication by the Ministry of Interior, Financial Police Office, Customs Administration and the Ministry of Defence;
- Legal aspect of the application of the special investigation measure for interception of the communication by the Ministry of Interior, Financial Police Office, Customs Administration and the Ministry of Defence from the aspect of their harmonization with the Law on Communication Interception;
- establishment of international cooperation for affairs in regard with this oversight,
- Other affairs in regard with the Ministry of Interior, Financial Police Office, Customs Administration and the Ministry of Defence in regard with the special investigation measure for interception of the communication.

The Committee shall submit a Report to the Assembly of the Republic of North Macedonia two months after the end of the current year, on the oversight of the legal aspect in the enforcement of the special investigation measure for interception of the communication by the Ministry of Interior, Financial Police Office, Customs Administration and the Ministry of Defence.



6.3. SHTOJCA C: A PLANI VJETOR I AKTIVITETEVE TË KOMISIONIT

Ky është një udhërrëfyes i mundshëm për aktivitetet që do të zbatohen nga komisioni brenda një viti.

Planet vjetore për veprim mund të ndihmojnë komisionin, anëtarët individualë dhe personelin për të organizuar agjendën e tyre, për të komunikuar më mirë me institucionet mbikëqyrëse dhe me publikun dhe për të planifikuar angazhimin e ekspertizës së jashtme dhe burimeve të tjera. Një plan i tillë mund të bëhet çdo vit, duke u bazuar në praktikatat e zakonshme të zhvilluara në vitin e kaluar nga komisioni. Mund të ndahet ose jo me institucionet mbikëqyrëse, kuvendin dhe publikun, sipas vendimit të komisionit.

Periudha	Aktivitete	Aktivitete pasuese
SEANCA E PARË PARLAMENTARE (SHKURT-KORRIK)	Raportet vjetore për veprim janë të debatuar dhe miratuar: 1. ASK 2. Shërbimi për zbulim 3. AOT	Raportet e aktiviteteve dhe debatet në komision me përfaqësues nga shërbimi Rekomandimet janë të formuluar me shkrim dhe i dërgohen shërbimit pas takimit, me afate kohore për implementim Mendimet e Komisionit mbi aktivitetet e zbulimit dorëzohen/diskutohen në seancën plenare
	Komisioni kërkon raporte specifike mbi çështjet e identifikuar si prioritete - kërkesat për raportime specifike janë të hartuara nga personeli i komisionit dhe dërgohen tek institucioni mbikëqyrës.	Raportet speciale pranohen dhe diskutohen në komision Rekomandimet kthehen pas, me afat kohor për zbatim Kumtesa për shtyp duhet të përmbledh çështjen, nëse tema nuk është shumë e ndjeshme.
	Seancat mbikëqyrëse • 2 Proactive – planned in advance, on big policy / reform issues • Reactive- to different issues revealed by media, MPs, independent sources. Public officials invited with 24-48 hours in advance.	Rekomandime Raporti në ueb faqe Kumtesë për shtyp
	Një takim i përbashkët me komisionet tjera që kanë kompetenca në mbikëqyrjen e shërbimeve të zbulimit /ose Këshilli qytetar mbikëqyrës	Mendimi i përbashkët në ueb faqe Plani për veprim të përbashkët
	Aktiviteti legjislativ	Mendim i dorëzuar deri te • komisionet tjera • mbledhja plenare
	Vizita në terren/inspektime • Të planifikuara • Të pa planifikuara	

Periudha	Aktivitetet	Aktivitetet pasuese
SEANCA E DYTË PARLAMENTARE (SHTATOR- DHJETOR)	Debatohet Raporti vjetor i Entit për revizion – Rishikim i realizimit të buxhetit të vitit të kaluar	Mendimi dorëzohet në Seancë plenare Rekomandime
	Takim i përbashkët me Komisionin për buxhet	Rekomandime të përbashkëta
	4 vizita mbikëqyrëse në terren	Konferencë për shtyp/kumtesë për shtyp Mendimi i komisionit i dorëzuar tek institucioni i vizituar (shqyrtohet edhe në mbledhje plenare?)
	4 seanca dëgjimore – për zbatimin e rekomandimeve të komisionit nga fillimi i vitit	Kumtesë për shtyp Rekomandimet e reja janë lëshuar Mendimi i komisionit në ueb faqe (shqyrtohet në mbledhje plenare?)
	Rishikohet propozim buxheti për vitin e ardhshëm Takim i përbashkët me Komisionin për buxhet	Mendimi shqyrtohet në mbledhje plenare
	Aktiviteti legjislativ	Mendimi shqyrtohet në mbledhje plenare

6.4. SHTOJCA D: PASQYRË E ÇËSHTJEVE NË PLANET VJETORE TË AKTIVITETEVE

Çështjet /temat e përfshira Në raportet publikë të aktiviteteve	Frekuenca	Treguesit sasior	Interpretim/pyetje pasuese dhe shembuj nga raportet e shteteve të tjera
Rreziqet dhe kërcënimet për sigurinë kombëtare	Në vit	Vetëm tregues cilësor	-
Prioritetet në punën e shërbimit	Në vit	Vetëm tregues cilësor	-
Ndjekja e komunikimeve për sigurinë kombëtare	Në vit	Nr. i urdhëresave të dhëna Nr. i kërkesave për urdhëresa të refuzuara nga gjykatësi Nr. i padive dhe dënimeve si pasojë e përgjimeve nda vitet e mëhershme Nr. i shkeljeve dhe gabimeve në zbatimin e procedurave të përgjimit	Informata mbi të dhënat mund gjithashtu të ndahet më tutje në numrin e: • rasteve për të cilat është kërkuar përgjimi • njerëzit të cilët janë përgjuar Si janë ndryshuar/ashpërsuar procedurat si pasojë, për të parandaluar shkeljet e mëtutjeshme? <i>Në 2014, Shërbimi Rumun për zbulim (SRI) ka zbatuar 44.759 përgjime të komunikimeve, nga të cilat 2'762 kishin të bënin me sigurinë kombëtare (SRI 2014 Raporti vjetor i aktiviteteve, fq. 31)</i> <i>Në Zelandë të Re gjatë periudhës së raportimit 2016/17 25 urdhëresa nga vendi dhe 12 urdhëresa për zbulim të jashtëm janë dhënë, përderisa 25 urdhëresa nga vendi dhe 10 urdhëresa për zbulim të jashtëm ishin ende në fuqi nga periudha e kaluar e raportimit. Ditët mesatare në të cilat ka qenë në fuqi një urdhëresa për zbulim për urdhëresat vendore është 172 ditë ndërsa për ato të huaja 153 ditë. (Raporti vjetor i shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit i Zelandës së Re 2017, fq. 34).</i>

Çështjet /temat e përfshira Në raportet publikë të aktiviteteve	Frekuenca	Treguesit sasior	Interpretim/pyetje pasuese dhe shembuj nga raportet e shteteve të tjera
Ndjekja e komunikimeve për hetime të krimit (për Prokurorin publik)	Tremujor	Nr. i urdhërësive të ekzekutuara	<i>Në 2014 Shërbimi Rumun për zbulim (SRI) ka realizuar 44'759 përgjime të komunikimeve, nga të cilat 42'263 ishin urdhëresa për përgjim për Prokurorin publik, mbi hetime të krimit (15% rritje nga viti i kaluar) (SRI 2014 Raporti vjetor i aktiviteteve, fq. 31)</i>
Raportet e zbulimit të përgatitura për palë të ndryshme	Në vit	Nr. i raporteve të prodhuara Nr. / lloji i palëve që pranojnë raporte	Çfarë informata kthyesë dërgojnë prapa shfrytëzuesit? A përdoren raportet në vendimmarrjen politike? Si po i adaptojnë shërbimet e zbulimit produktet e tyre pas informatave kthyesë? <i>Agjencia për siguri dhe zbulim e Kroacisë (SOA) ka dorëzuar në 2014 përafërsisht 8700 raporte deri te shfrytëzuesit e tyre, nga të cilat 290 raporte analitike deri te Kryetari dhe Qeveria. (SOA Raporti publik 2015, fq.24) Në 2017, SOA ka dorëzuar 450 raporte analitike deri tek udhëheqësia shtetërore, që është një rritje prej 40% nga viti i kaluar (SOA Raporti publik 2017, fq. 5)</i> <i>Shërbimi Rumun për zbulim (SRI) ka dorëzuar në 2014, 5'373 raporte deri te shfrytëzuesit kryesore (10% më pak se a në vitin e kaluar si rezultat i integritetit të zbulimit) dhe 2'937 raporte deri tek administrata lokale. (SRI 2014 Raporti vjetor i aktiviteteve, fq. 16)</i> <i>Agjencia kombëtare për siguri në komunikime holandeze (AIVD) ka prodhuar në 2016 gjithsej 457 raporte të zbulimit, 152 raporte zyrtare dhe 118 produkte kërcënimi. (AIVD Raport vjetor 2016, fq. 9)</i>

Çështjet /temat e përfshira Në raportet publikë të aktiviteteve	Frekuenca	Treguesit sasior	Interpretim/pyetje pasuese dhe shembuj nga raportet e shteteve të tjera
Hetimi i gjurmëve/ paraqitjeve	Në vit	Nr. i gjurmëve të pranuar dhe hetuara	<i>Organizata për siguri dhe zbulim e Australisë (ASIO) ka pranuar në 2016-17 mbi 12 000 gjurmë dhe ka zgjidhur apo hetuar përafërsisht 15 000 referime nga gjurmët..(ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 48)</i> <i>Në 2016, AIVD e Holandës është marrë me afro 5'400 paraqitje në lidhje me terrorizmin, që kanë iniciuar edhe 238 hetime të mëtutjeshme (AIVD Raporti vjetor 2016, fq. 4)</i>
Organizimi dhe menaxhimi i shërbimit	Në vit		Tabela organizative dhe funksionet e njësive të ndryshme organizative janë zakonisht publike. Numri i saktë i të punësuarve është zakonisht i klasifikuar. Përqindja siç është gjinia, arsimimi apo mosha është e përmendur në disa raste.
Kontrolli i brendshëm dhe mbikëqyrja	Në vit	Nr. i ankesave të pranuar Nr. i procedurave disiplinore të iniciuara	<i>SRI e Rumanisë - 31.397 ankesa të pranuar në 2016, 20'567 të zgjidhura në mënyrë të favorshme. (Relažiile SRI cu cetașenii in anul 2016)</i> <i>SOA e Kroacisë - 9 procedura disiplinore në 2014 për shkelje të detyrave zyrtare (SOA Raporti publik 2015, fq. 39)</i> <i>Në 2016, 24 ankesa për AIVD të Holandës janë bërë te ministri i Punëve të Brendshme, ndërsa 15 deri tek Avokati i Popullit (AIVD Raport vjetor 2016, fq. 12)</i>
Llogaridhënia publike - kërkesa të bazuar në Aktin e lirisë së informimit		Nr. i kërkesave të pranuar/ përgjigjur	<i>SRI e Rumanisë ka pranuar 85 kërkesa në bazë të Aktit për liri të informatave në 2016 (32 janë përgjigjur pozitivisht, 53 janë refuzuar)(Raport vjetor për qasje deri tek informatat me interes publik 2016)</i>


Çështjet /temat e përfshira Në raportet publike të aktiviteteve	Frekuenca	Treguesit sasior	Interpretim/pyetje pasuese dhe shembuj nga raportet e shteteve të tjera
Budget - overall amount. Personnel expenses, current expenditures, development and modernisation.	Në vit	Compare with lump amounts from previous years.	Shumat e mëdha (rrallëherë buxhete më të hollësishme) janë të botuara në raportet publike të aktiviteteve vjetore. Megjithatë, komisioni duhet të ketë qasje deri tek informatat më të hollësishme mbi realizimin e buxhetit.
Verifikim sigurie	Në vit	Nr. i njerëzve të verifikuar	Verifikimi përfshin qasjen deri te të dhënat personale, andaj duhet të realizohet duke përcjellë procedura transparente; të lejojë mekanizma për ankim/ kontestim. <i>Në 2016-17, ASIO e Australisë ka finalizuar 27 182 vlerësime sigurie në lidhje me personelin e qeverisë Australiane dhe të tjerë të cilët kërkojnë qasje tek informatat kombëtare të klasifikuara, ndjeshme dhe privileguara qeveritare dhe fushës, ndërsa 14'358 vlerësime sigurie të vizës. (ASIO Raporti vjetor 2016-17, fq. 54)</i> <i>Në 2016, AIVD e Holandës dhe organizatat me mandat (Shërbimi i policisë kombëtare, Xhandarmeria mbretërore ushtarake) kanë kompletuar mbi 35'000 kontrolle sigurie (8'000 nga vetë AIVD). (AIVD Raporti vjetor 2016, fq. 12)</i> <i>Në 2014 SOA e Kroacisë ka realizuar 5933 procedura të verifikimit të sigurisë, (SOA Raporti publik 2015, fq. 24) dhe ka kompletuar në 2016 kontrolle të sigurisë mbi 73'551 individ (SOA Raport publik 2017, fq. 25)</i>
Bashkëpunim me institucione të tjera kombëtare	Në vit	Nr. i raporteve të ndara midis agjencive kombëtare partnere	<i>Në 2016-17, ASIO Australiane ka prodhuar gjithsej 1433 raporte zbulimi për agjencitë partnere kombëtare. Raportimi është ndarë deri te më shumë se 130 organizata qeveritare federale, shtetërore dhe territoriale. (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 36)</i>

Çështjet /temat e përfshira Në raportet publikë të aktiviteteve	Frekuenca	Treguesit sasior	Interpretim/pyetje pasuese dhe shembuj nga raportet e shteteve të tjera
Trajnim/informim i institucioneve kombëtare	Në vit	Nr. i informimeve të realizuara	<i>ASIO Australiane (2016-17) ka mbajtur 76 informime për Qeverinë Australiane dhe partnerë të industrisë mbi treguesit e mobilizimit për dhunë, për të krijuar një kuptim kolektiv për sjelljen terroriste. (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 51)</i>
Bashkëpunim me partnerë të huaj	Në vit	Nr. i shteteve / shërbimeve me të cilët kanë marrëveshje për bashkëpunim dhe shkëmbim të informatave	<i>ASIO Australiane (2016-17) ka qenë e autorizuar nga Prokurori i përgjithshëm për të bashkëpunuar me mbi 350 agjenci në 130 shtete. ASIO në atë periudhë ka ndarë raportimet me mbi 130 agjenci të huaja partnere për lidhje në 60 shtete, me 643 raporte të zbulimit të dhëna te një apo më shumë agjenci partnere. (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 52)</i> <i>Në mes të viteve 2013 dhe 2016 SOA e Kroacisë ka rritur sasinë e informatave të zbulimit të marra përmes bashkëpunimeve për zbulim nga faktori 5. (SOA Raport publik 2015, fq. 13)</i>
Siguria fizike	Në vit	Nr. i vendeve të inspektuara, raportuara dhe certifikuara	<i>Në 2016-17, ASIO Australiane ka realizuar:</i> <i>Hapësira të zonës 5: 80 inspektime në vend / raporte, 39 certifikime</i> <i>Shërbime shkatërrimi: 9 inspektime në vend / raporte, 8 certifikime</i> <i>Objektet e agjencisë kryesore : 3 inspektime në vend / raporte, 2 certifikime</i> <i>Shërbime korrieri: 3 inspektime në vend dhe raporte</i> <i>(ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 65)</i>
Kundërmasa për mbikëqyrje teknike	Në vit	-	<i>ASIO Australiane: fshehtësi</i>

Çështjet /temat e përfshira Në raportet publikë të aktiviteteve	Frekuenca	Treguesit sasior	Interpretim/pyetje pasuese dhe shembuj nga raportet e shteteve të tjera
Arsim	Në vit	Kurse të realizuara	In 2016-17, ASIO Australiane ka realizuar 50 kurse për ndërgjegjësim i situatës, siguri personale, de-eskalim, ndihmë të parë gjatë traumave dhe ndërgjegjësim për mjedis armiqësor për gjithsej 512 pjesëmarrës. (ASIO Raport vjetor 2016-17, fq. 68)

LIGJI PËR NDJEKJEN E KOMUNIKIMEVE (I/C) LIDHJET ME PALËT E INTERESIT


(Numrat në grafikun e mëposhtëm i referohen neneve në Ligj)




*Organe të autorizuar për ndjekje të komunikimeve janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria Doganore dhe Drejtoria e Policisë Financiare.

*** Komisioni për Mbrojtje të Zbatimit të Masës së Posaçme Hetimore për Ndjekje të Komunikimeve dhe Këshilli për Mbrojtje Qytetare në mënyrë direkte bëjnë mbikëqirje të trupave të autorizuar (43, 51/2).


NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE NË HETIMET E KRIMIT ME NDËRMJETËSIM TË AOT-IT




NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE NË HETIMET E KRIMIT PA NDËRMJETËSIM TË AOT-IT



NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE NË OPERACIONET E ZBULIMIT DHE SIGURISË ME NDËRMJETËSIM TË AOT-IT



NDJEKJA E KOMUNIKIMEVE NË OPERACIONET E ZBULIMIT DHE SIGURISË PA NDËRMJETËSIM TË AOT-IT



Disejni teknik:

Marija Dambova Tutkovska

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

342.536.078.3:355.45(497.7)(035)

UDHËZIME për mbikqyrjen mbi zbulimin : për komisionet parlamentare në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut [Електронски извор] / [Teodora Fuior ... и др.]. - Текст во PDF формат, содежи 139 стр. ; табели. - Shkup : Qendra e Gjenezës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë - Gjenevë, zyra e degës në Shkup, 2021

Начин на пристапување (URL):

<https://dcaf.ch/resources?type=publications>. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 08.03.2021. - Фусноти кон текстот. - Други автори: Magdalena Lembovska, Julijan Riçards, Vuter de Rider, Igor Kuzevski, Ice Ilijevski, Vllado Gjerdovski, Kire Babanovski. - Содржи и:

Shtojca A, Shtojca B, Shtojca B, Shtojca C, Shtojca D

ISBN 978-608-66657-1-5

COBISS.MK-ID 53329925

